

14 Komunikim dhe Ndërgjegjësim - Plani i ndërgjegjëimit dhe edukimit të komunitetit (PNEK)

1.1 HYRJJE

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit është çështja më e rëndësishme e zbatimit me efikasitet të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta (PVMIMN) në Dibër. E gjithë veprimtaria e tij dhe përmirësimi i mëtejshëm janë direkt të lidhura me përkrahjen që do të vijë nga banorët dhe aktorët vendor në bashkinë Dibër. Një program i mirë dhe efikas ndërgjegjësimi dhe edukimi do të mundësojë zbatimin e PVMIMN si dhe një mjedis më të shëndetshëm në të gjithë territorin e bashkisë. Gjithashtu duhet theksuar që një mjedis më i pastër është parakushti i zhvillimit të turizmit në territorin e bashkisë Dibër, të cilës natyra i ka falur bukuri të rralla natyrore.

Plani i Ndërgjegjëimit dhe Edukimit të Komunitetit (PNEK) në kuadër të Projektit “Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër” përfshin një plan pune zbatimi me disa masat afat shkurtër që duhen zbatuar paralelisht me përgatitjen dhe zbatimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkinë Dibër. Gjithashtu në këtë kuadër një sërë masa afatgjata do të propozohen Bashkisë për të ardhmen në mbështetje të mbarëvajtjes së PVMIMN.

Plani i Ndërgjegjëimit dhe Edukimit të Komunitetit (PNEK) përbëhet nga:

1. Përgatitja e produkteve të fushatës së komunikimit;
2. Prodhimi i produkteve informuese dhe ndërgjegjësuere pas miratimit nga Bashkia Dibër;
3. Lehtësimi i efektshëm i organizimit dhe komunikimit midis qeverisë vendore dhe banorëve të bashkisë Dibër;
4. Përshkrimi dhe grumbullimi i opinioneve nga publiku dhe të gjithë aktorët e tjerë të interesuar si input i vazhdueshëm për fushatën e informimit dhe komunikimit;
5. Përcjellja e produkteve të prodhura për informim dhe komunikim nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, takimeve apo kanaleve eksistuese të komunikimit;
6. Plani për zbatimin e aktiviteteve dhe shpërndarjen e informacionit dhe produkteve dhe;
7. Monitorim dhe Vlerësim i zbatimit të fushatës së informimit dhe ndërgjegjëimit

Fushata e informimit dhe ndërgjegjëimit ka qenë pjesë integrale prej fazës së parë të zbatimit të projektit dhe për këtë shpesh objektivat kanë krijuar sinergji pozitive duke i shtuar vlerë njëri tjetrit.

Mjetet e ndërgjegjëimit do të përdoren në takimet publike që do të organizohen me aktorët vendorë gjatë dëgjësive publike për të mundësuar përfshirjen e të gjithë

përfituesve në të gjithë territorin dhe të sigurojë që janë vendosur mekanizmat e duhur afatgjatë.

Fushata do të ndihmojë në ngritjen e kapacitetit të specialistëve të bashkisë Dibër, të cilët do të ftohen për të qenë pjesë e aktiviteteve, takimeve dhe trajnimeve që do të organiozohen në kuadër të PNEK. Grupet e fokusit do të përbëhen nga të gjithë përfituesit dhe një fokus të veçantë do të kenë mësuesit e shkollave 9-vjeçare jo vetëm si një nga grupet përfituese por si grupi kyç në edukimin e brezit të ri dhe si ambasadorët më të mirë të përcjellë informacionin në familjet Dibrane.

Një gërshetim i produkteve të përgjithshme ndërgjegjësuese me programet e tjera të REC Shqipëri, si program i edukimit mjedisore apo dhe ai i mbështetjes së Organizatave të Shoqërisë Civile do të shikohet me prioritet. Megjithatë, për shkak të specifikave të rajonit, largësisë së tij nga kryeqyteti, ifrastrukturën e vështirë rrugore, fushata e edukimit dhe ndërgjegjësimit do të ketë karakter të qartë vendor.

Një nga çështjet kryesore për zbatimin e PVMIMN është grumbullimi i tarifës, e cila është në nivele shumë të ulëta në bashkinë Dibër duke ndikuar në eficiencën e ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Nisur nga kjo situatë që në fazën e parë të zbatimit të proejktit do të punohet shumë me rritjen e ndërgjegjës së banorëve, në mënyrë që kjo të ketë efektin e saj direkt në grumbullimin e tarifës, e cila është dhe një nga objektivat e kësaj fushate.

Më poshtë janë shpjeguar në detaje veprimtaritë përkatëse dhe roli i secilit aktor në këtë proces, për të mundësuar një kuptim më të thjeshtë zbatimit të tij

1.2 QËLLIMI I PNEK

Ky dokument është pjesë e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta (PVMIMN), ai është përgatitur si bazë dhe një mjet operacional për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që **do të informojnë qytetarët e Bashkisë Dibër** për rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve dhe rëndësinë që **ka pagesa e tarifës në përmirësimin e mjedisit ku ata jetojnë**.

Ky dokument ndihmon gjithashtu të gjithë aktorët, në procesin e përcaktimit/përmbushjes së komunikimit, objektivave të ndërgjegjësimit e pjesëmarrjes publike.

1.3 OBJEKTIVAT E PNEK

Objektivat kryesore të PNEK për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve janë:

- Të informohet publiku mbi hartimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkinë Dibër.
- Të informohen komunitetet, shkollat, media, partnerët e biznesit dhe qeverisja vendore mbi përfitimet që lidhen me planin e integruar të menaxhimit të Mbetjeve dhe mënyrën se si secili prej tyre mund të kontribuojë në zbatimin me sukses të këtij plani.
- Të sigurohet mbështetja e të gjitha palëve për zbatimin e suksesshëm të planit dhe praktikrat e manaxhimit të mbetjeve për funksionimin e suksesshëm të Landfillit të Peshkopisë.
- Të arrijë mbështetjen e komunitetit dhe tarifë-paguesit e tjerë mbi masat dhe nismat që përcaktohen në PVMIMN ;

1.4 PRINCIPET KRYESORE TË PNEK:

Menaxhimi i mbetjeve do të jetë një shërbim i ri për pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë Dibër dhe komunitetin e saj dhe kështu do të ketë ndikime të ndryshme në sjelljen dhe ekonominë e familjeve. Ndaj kjo çështje duhet të trajtohet me vëmendje maksimale, në mënyrë që komuniteti të kuptojë se ky shërbim është plotësisht në përmbushje të nevojave të tyre dhe i shërben një cilësie më të mirë jete për ta.

Drejtoria e Shërbimeve në bashkinë Dibër duhet ta drejtojë vetë programin e ndërgjegjësimit dhe edukimit, por megjithatë ky si funksion mund t'i delegohet dhe shoqërisë civile apo shkollave, sipas një marrëveshje të qartë mes palëve.

Adresimi i të gjithë aktorëve përgjatë të gjithë procesit të zbatimit të PVMIMN është një çelës i suksesit dhe qëndrueshmërisë së këtij plani.

Është e rëndësishme të arrihet një pjesëmarrje aktive e komunitetit në të gjitha fazat e zbatimit të planit, në mënyrë që të mundësohet kuptim më i drejtë dhe transparencë në menaxhim, sidomos atij financiar.

Hapat që u ndoqën në përgatitjen e PNEK dhe zhvillimin e fushatës së ndërgjegjësimit (Figura 1) janë paraqitur në skemën më poshtë:

1. Studimi i situatës
2. Analizat para planifikuese
3. Planifikimi i fushatës
4. Prodhimi i materialeve të fushatës
5. Menaxhimi i fushatës (organizimi i aktiviteteve)
6. Monitorimi
7. Vlerësimi i fushatës




Figura 1 Procesi i përgatitjes së PNEK dhe fushata e ndërgjegjësimit

1.5 STUDIMI I SITUATËS

Komunitetet vendore janë gjithmonë shumë të ndërgjegjshëm për problemet që janë prezente dhe me të cilat ndeshën në mjedisin e tyre dhe si rezultat japin një kontribut të vlefshëm gjatë proceseve që lidhen me shërbimet publike. Fusha e ndërgjegjësimit që është synuar në këtë rast kërkon që pjesëmarrësit të kuptojnë përfitimet prej saj prandaj ajo do të mbështetet shumë në eksperiencat e komunitetit. Kjo nënkupton që fushata e REC Shqipëri në lidhje me PVMIMN do të jetë “bashkëvepruese” në kontrast me një fushatë “marrëse” ku komunitetet në mënyrë pasive marrin një program të përcaktuar paraprakisht pa tërhequr mendimin e tyre.

Një fushatë “bashkëvepruese” në të cilën njohuritë janë të ndërtuara në mënyrë sociale ka më shumë gjasa të jetë më e përshtatshme dhe kështu e qëndrueshme në bashkinë Dibër.

Nga vizitat e hershme në terren si dhe takimet e organizuara me aktorët vendore u studiuhan mjetet e mundshme të komunikimit dhe informimit si dhe qasja më e përshtatshme e përcimit të mesazhit kryesor të fushatës. Në rastin e këtij projekti, fushata është organizuar e gjitha në nivel lokal dhe intencionet apo personat e përfshirë janë në Bashki, përfaqësues të njësitve administrative, Drejtoria Arsimore Rajonale Diber, OJF-të, biznese, specialistë të shërbimeve publike, Drejtoria e higjenes, banorë lokalë, mësues dhe nxënës.

1.6 ANALIZAT PARA PLANIFIKUESE

Analizat para planifikuese na vendosi në kontakt të drejtpërdrejtë me dy elementë kyç të fushatës: **problemi i mbetjeve** (tepër i madh) dhe njerëzit (aspak të përgjegjshëm) në lidhje me administrimin e mbetjeve të gjeneruara prej tyre.

Metodat që u përdorën për identifikimin e problemeve:

Studimi: ekipi i REC Shqipëri organizoi disa vizita dhe vëzhgime personale në terrenin e bashkisë Dibër, duke filluar nga qyteti i Peshkopisë, si qendra më e madhe urbane dhe në njësitë e tjera administrative si Maqellarë, Kastriot por dhe në shumë fshatra për identifikimin e problemeve. Qëllimi ishte të identifikoheshin problemet reale, shpesh jo të evidentuara nga statistikat apo të dhënat e tjera të rregjistruara.

Situata paraqitej jo fort e këndshme në lidhje me sjelljen e banorëve ndaj mbetjeve. Pamja që shfaqej më shpesh ishte ajo e kontenierëve bosh dhe mbetjet të hedhura jashtë tyre, apo dhe të grumbulluara pranë hyrjeve të dyqaneve dhe tregjeve të fruta perimeve. Ajo cka u evidentua si dhe më shqetësuese ishte situata në oborret e shkollave, si në qytet dhe nëpër fshatra. Oboret e mbushura me mbetje paketimesh, prej produkteve ushqimore të konsumuara prej fëmijëve, të cilët nuk shqetësoheshin aspak për situatën aspak të këndshme në shkollën e tyre, edhe pse koshat, pavarësisht jo në gjendje fort të mirë ishin të pranishëm nëpër shkolla. Një dukuri tjetër shqetësuese ishte dhe dijegia e kontenierëve të mbetjeve, gjë e cila ndodhte më shpesh gjatë periudhës së dimrit, e sidomos gjatë festive të fundvitit, duke hedhur në to fishekzjarrë. Të gjitha këto ishin çështje të cilat do të duheshin të adresoheshin në PNEK.

Intervista: Intervista të shumta janë organizuar me autoritete vendore, kryepleq, banorë të qytetit dhe fshatit, drejtuesit e shkollave, mësuesit si dhe biznese për të identifikuar problemin. Ekipi i REC Shqipëri shoqëruar dhe nga stafi i Drejtorisë së Shërbimeve të Bashkisë Dibër gjatë vizitave në terren pyeste njerëzit që të na tregonin për problemet e tyre me mbetjet apo gjërat që i shqetësojnë ata më tepër në këtë çështje.

Intervistat nuk u realizuan vetëm nëpërmjet bisedave informale me njerëzit por dhe përmes pyetësorëve më formalë. Pyetësorë u shpërndanë në shumë prej takimeve publike të organizuar, në takimin me përfaqësues të Shoqërisë Civile, me mësues, me përfaqësuesit e qendrave shëndetësore etj. Përgjigjet e dhëna jo vetëm që ndihmuan në identifikimin e problemeve që lidheshin me skemën e menaxhimit të mbetjeve por dhe me qasjen e banorëve të Dibrës në lidhje me hedhjen dhe administrimin e mbetjeve.

Diskutimet në grup: Gjatë përgatitjes së PVMIMN dhe planit të fushatës së ndërgjegjësimit u organizuar dhe u mbledhën ide dhe në diskutime në grupe me specialist nga Agjensia e Konsumatorit dhe Ushqimit, Drejtues të Arsimit në Dibër, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, specilaistë nga Drejtoria e Turizmit në bashki etj. Këto diskutime kanë identifikuar një numër problemesh por gjithashtu na kanë dhënë në disa raste "pista" të mira mbi zgjidhjet e mundshme, këtu mund të përmendim rastin e përzgjedhjes së llojit të kontenerit më të përshtatshëm për qytetin e Peshkopisë, i cili do të ishte më mirë i pajisur me pedal për hapjen e kapakut ku hidheshin mbetjet.

Konsultimi me ekspertët: Konsultuesit ofrojnë burim të drejtpërdrejtë ekspertize që mund të na ndihmojë në identifikimin e problemeve në fushën e tyre të eksperiencës.

Bashkia Dibër aktualisht nuk zotëron mjete ndërveprimi të komunikimit të publikut. Në Bashkinë Dibër ka një zyrë informacioni për publikun dhe ka një staf të përcaktuar për të punuar për informimin, por në të pothuajse mungon informacioni për shërbimet. Në njësitë e tjera administrative kjo zyrë mungon. Gjithashtu nuk zhvillohet një proces konsultimi me banorët në mënyrë të rregullt. Në bashkinë Dibër nuk ka radio lokale apo stacione TV lokale, si dhe nuk ka një gazetë të bashkisë. Gjithashtu, në territorin e bashkisë Dibër ushtrojnë veprimtarinë shumë pak organizata të shoqërisë civile ndër të cilat grupi i punës ka kontaktuar tre OJF mjedisore dhe dy organizata komunitare.

Bazuar në gjetjet e këtij procesi dhe në njohjen e pikave të forta të komunitetit, PNEK do të punojë hap pas hapi në aktivizimin e këtyre burimeve dhe forcimin në shërbimi të zbatimit eficient të PVMIMN.

1.7 PLANIFIKIMI I FUSHATËS

PNEK dhe organizimi i aktiviteteve në kuadër të fushatës së ndërgjegjësimit synojnë së pari të informojë publikun mbi hartimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkinë Dibër të rrisin ndërgjegjësimin mbi mirëadministrimin e mbetjeve, të këshillojnë, të instruktojnë banorët e bashkisë mbi këtë praktikë të re që do të nisi së shpejti dhe të nxis dhe të edukojnë një auditor të gjerë me sjellje pro mjedisore.

Bazuar në analizat para planifikuese dhe mungesa e televizioneve dhe radiove lokale, REC Shqipëri, parashikoi si një nga rrugët më të mira të komunikimit me publikun do të ishin materialet e shtypura dhe aktivitetet në shkolla, të cilat duhet të mendoheshin në mënyrë të tillë që të nxisnin dialogun, diskutimin dhe reflektimin e banorëve më të rinj të bashkisë që ishin fëmijët.

Elementi i fundit dhe më i rëndësishëm i kësaj fushate ka qenë konsultimi i vazhdueshëm me drejtuesit e njësive administrative dhe kryeplqetë të cilët janë një nga aktorët më të rëndësishëm në zbatimin me sukses të PVMIMN dhe transmentuesit më të mirë të mesazheve të fushatës në komunitet.

Si rezultat, organizimi dhe zbatimi i kësaj fushate ishte një proces i cili u zhvillua paralelisht me përgatitjen e PVMIMN dhe si pikë kulmore të tij do të ishin muajt kur shërbimi i ri do të ofrohej në zonë 1 dhe shërbimi do të ofrohej për herë të parë në tre zonat e tjera të bashkisë.

Planifikimi i fushatës u fokusua në pikat e mëposhtme:

- Metodatat më të përshtatshme për të komunikuar dhe arritur banorët dhe në shtëpitë e tyre;
- Rrugëve alternative për ta bërë atë më popullore përmes aktiviteteve në shkolla dhe ofrimit të infrastrukturës së re të riciklimit në shkollë, etj;
- Mesazhit që fushata duhet të transmetojë të jetë sa më pranë qytetarëve të Dibrës dhe filozofisë së tyre bazuar në *alegori*;
- Auditorit të synuar (numri i pjesëmarrësve dhe kategoritë e tyre);
- Kalendari i organizimit të aktiviteteve
- Indikatorët e suksesit (monitorimi në vazhdim).

Hapat e mësipërm kanë qenë të rëndësishëm për zbatimin e kësaj fushate ndërgjegjësimi.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet që në takimet e shumta që janë organizuar paralelisht në përgatitjen e PVMIMN dhe PNEK janë përgatitur me kujdes dhe janë parashikuar disa strategji për të nxitur ndryshimin.

Disa prej këtyre strategjive të zbatuara janë listuar në tabelën vijuese:

Tabela 1

| | |
|--|--|
| <p>Strategjia e fuqisë ligjore</p> | <p>Përdorimi i instrumentave ligjorë është një nga strategjitë më të fuqishme.</p> <p>Ligji Nr.10 463, datë 22/09/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" thekson ndër të tjera që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, sipas nenit 16 të këtij ligji, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq. - Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. |
| <p>Strategjia e mbështetjes financiare</p> | <p>Mbështetja financiare që ofrohej për Bashkinë Dibër nga program i dldp ishte thelbësore për të besuar që një fond i tillë ishte real dhe i qëndrueshëm, dhe që do të mirë menaxhohej në kuadër të projektit.</p> |
| <p>Strategjia e bindjes</p> | <p>Përqasja e bindjes është për të motivuar njerëzit të ndryshojnë disa sjellje jo mjedisore që lidheshin me mesazhin kryesor të fushatës. Të fitosh zemrat dhe mendjet e njerëzve është mënyra më efektive për të sjellë ndryshime të qëndrueshme. Kjo arrihet më së miri përmes shpjegimit të kujdesshëm të arsyeve për ndryshimin</p> |
| <p>Strategjia e riedukimit</p> | <p>Përqasja e riedukimit synoi të riedukojë njerëzit të ndryshojnë sjelljen, veçanërisht, kur mesazhi kryesor iu drejtohet të rriturve është e rëndësishme që ata të shkëmbejnë ide në këtë proces dhe që kontributi i tyre të merret seriozisht.</p> |
| <p>Strategjia e mbështetjes</p> | <p>Kjo strategji synon të ndihmojë njerëzit të bëjnë ndryshimin për të cilin ata janë të ndërgjegjshëm dhe dëshirojnë ta bëjnë atë por nuk mund ta ndërmarin të vetëm.</p> <p>Mbështetja nga ekipi i REC dhe ofrimi i një sistemi të ri menaxhimi, apo përmirësimi i venddepozitimit të mbetjeve ofron mundësinë e një <i>fillimi</i> të ri, pra merret si një pike e re fillimi dhe kthese në sjelljen e banorë e përsa i përket çështjeve të pagesës së tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.</p> |

1.8 PRODHIMI I MATERIALEVE TË FUSHATËS

Mjetet e mundëshme të komunikimit dhe informimit

Zakonisht fushatat për ndërgjegjësimin mjedisor janë bazuar pothuajse tërësisht në *rritjen e ndërgjegjes dhe në transmetimin e informacionit*, duke përdorur postera, broshura dhe fletushka që synojnë të japin një *"mesazh të gjerë"*.

Hapi i parë i rëndësishëm do të konistojë në informimin e komunitetit mbi sistemin e ri në qytetin e Peshkopisë, zgjerimin e shërbimit në Maqellarë dhe Melan, si dhe shtrirjen e tij në Kastriot, Tomin e Kala e Dodës. PVMIMN do të vihet në praktikë dhe se gjendja do të ndryshojë për të mirën e tyre dhe përmirësimin e gjendjes së deritanishme.

Imazhi qendror i fushatës dhe motoja

Imazhi qendror i fushatës u krijua me qëllim promovimin e sistemit të ri të menaxhimit të mbetjeve dhe përbëhet nga kombinimi elementëve të natyrës Dibrane, malet e lartë, me shtëpitë karakteristike dhe ndërtesat e banimit si dhe elementët e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Imazhi qendror i fushatës do të shoqërojë të gjitha materialet që do të prodhohen në kuadër të fushatës dhe aktivitetet që do të zbatohen brenda kuadrit të tyre të zbatimit.



Motoja e fushatës është: **"Dibrën e dua të pastër"**

Dhe mesazhi për aksionin komunitar është **"Bëj një veprim të thjeshtë por qytetar - Hidh mbetjet në kosh"**.

Qëllimi i motos është që të sigurohet që mesazhi i përcjellë vë në lëvizje marrësin për veprim.

1.9 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PNEK

Grupet e Synuara, Mjetet e Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit

Fushata e informimit dhe ndërgjegjësimit (PNEK) do të jetë e shumëllojshme dhe do të marrë parasysh audiencë të ndryshme si grupe të synuara/përfitues dhe do të përshtasë mënyra, aktivitete dhe mjete të ndryshme për të siguruar komunikimin.

Kjo fushatë i drejtohet tre grupeve të veçanta, të cilët janë:

1. **Aktorët kryesorë** – duke u fokusuar më shumë mbi nevojën për rritjen e komunikimit;
2. **Publiku i gjerë** – me qëllim specifik rritjen e ndërgjegjësimit në menaxhimin e mbetjeve dhe **veçanërisht publiku i zonave rurale për menaxhimin e** diferencimin e mbetjeve organike;
3. **Mësuesit dhe nxënësit e shkollave** – duke krijuar baza të mira edukative në të ardhmen.

Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet shpërndarjes demografike të popullsisë nëpër njësitë administrative të bashkisë Dibër si dhe profileve të ndryshme demografike në komunitet, kryesisht përsa i përket aspekteve të edukimit dhe të mbrojtjes së shëndetit, siç janë nxënësit e shkollave; gratë; OJFtë pritet të japë një ndikim të drejtpërdrejtë në imazhin e zonës tek turistët që e vizitojnë atë.

Bazuar mbi shtrirjen e PVMIMN paraqitur më sipër në dokument, e gjitha Bashkia Dibër është e ndarë në dy zona kryesore shërbim dhe dy zona shoqëruese. Kjo skemë do të ndiqet dhe në organizimin e aktiviteteve të fushatës së ndërgjegjësimit.

Tabela 2

| | Zonat e shërbimit | Shtrirja |
|----|---|---|
| 1 | Zona e parë kryesore – e shërbimit | Njësia Peshkopi + Njësia Luzni |
| 2 | Zona e dytë – kryesore – e shërbimit | Njësia Maqellarë + Njësia Melan |
| 2+ | Nën-zona e tretë përbërëse e zonës së dytë | Njësia Muhur + Njësia Arras |
| 2+ | Nën-zona e katërt përbërëse e zonës së parë | Njësia Kastriot + Njësia Fushë Çidhën + Njësia Sllovë + Njësia Kala e Dodës |

Tabela 3 – Prezantimi i audiencave/ grupeve të synuara të ndryshme që REC Shqipëri ka identifikuar gjatë procesit të vlerësimit. Këto interesa do të drejtojnë aktivitetet dhe mesazhet kyçe jo vetëm gjatë zbatimit të aktiviteteve të PNEK, por mund të përdoren më tej nga vetë bashkia përtej kohështirjes së mbulohet nga dldp-ja në të gjitha aktivitetet që lidhen me mirëfunksionimin e PVMIMN dhe procesit të funksionimit dhe menaxhimit të Landfillit të Peshkopisë.

Tabela 3

| Grupet e synuara | Interesi | Roli/Përgjegjësia |
|-------------------------------|--|--|
| Qeveri Vendore (Bashki & NjA) | <ul style="list-style-type: none"> Të përmirësojë gjendjen e mbetjeve në bashki/NjAd dhe të sigurojë mjedis dhe shëndet të mirë për banorët; Të sigurojë që banorët kanë kuptuar drejt qëllimin e këtij shërbimi dhe të arrijë efikasitet financiar të nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm. | <ul style="list-style-type: none"> Shpërndajë informacion për të gjithë aktorët e tjerë; Organizojë, zhvillojë apo bashkëzhvillojë të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në PNEK; Përgatisë materiale informuese dhe ndërgjegjësuese; Të mbajë kontakt të vazhdueshëm me komunitetin mbi menaxhimin e mbetjeve; T'i përgjigjet nevojave dhe të tregojë besueshmëri dhe angazhim; Të zgjidhjë problemet e kordinimit dhe bashkëveprimit; Të mbajë në efikasitet të plotë ndërmarrjen e menaxhimit nga të gjitha aspektet; |
| Qendrat shëndetësore | <ul style="list-style-type: none"> Të sigurojnë shëndet të mirë për banorët; | <ul style="list-style-type: none"> Të marrin pjesë aktive në diskutimet tematike, sidomos lidhur me shëndetin, për të bërë të qarta rrezikun që vjen nga ndotja; Të ndihmojnë bashki/NjAdn në përgatitjen e materialeve informative të sakta dhe të thjeshta për banorët; Të marrin pjesë në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi, si pastrime vullnetare; |
| Kryepleqtë e e | <ul style="list-style-type: none"> Të sigurojnë nivel të lartë të shërbimit dhe | <ul style="list-style-type: none"> Organizojnë takime shtëpi më shtëpi me banorët, për të |

| | | |
|---|---|--|
| <p>fshatrave</p> | <p>të pjesëmarrjes së banorëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet të mirë dhe mjedis të pastër. | <p>përcjellë më afër çështjet e ndryshme që lidhen me tërreheqjen e mbetjeve dhe oraret e shërbimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të marrin pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Nj.Ad, si dhe të sigurojnë që të gjithë banorët e marrin mesazhin nëpërmjet pjesëmarrjes apo përcjelljes nga kryetarët; • Të mundësojnë takime të veçanta në secilin fshat dhe të shpërndarjnë materiale informative dhe pyetesore të kënaqshmërisë; • Informojnë bashki/NjAdn mbi çështje të ndryshme të performancës, përmirësimit të shërbimit dhe skemës. |
| <p>Shkolla (mësues dhe nxënës)</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet dhe mjedis të shëndetshëm për të rinjtë; • Edukojnë drejtë brezin e ri mbi nevojën për zhvillim të qëndrueshëm. • Edukojnë drejtë brezin e ri mbi hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve. | <ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojnë krijimin e grupeve apo oganizatave me bazë rinore dhe fokus në çështjet mjedisore; • Të organizojnë veprimtari të ndryshme edukative, ndërgjegjësuese, si në shkollë ashtu dhe jashtë saj; • Të marrin pjesë në mënyrë aktive në bisedat me banorët dhe të edukojnë sipas mënyrë së tyre; • Të ndihmojnë bashki/NjAdn në ndërtimin e materialeve informuese, apo të faqeve të internetit; • Të organizojnë projekte vjetore në shkolla me fokus riciklimin dhe ripërdorimin, ndërgjegjësimi, përmirësimi mjedisor apo turizmi; • Të informojnë bashki/NjAdn dhe aktorët e tjerë mbi problematika të ndryshme dhe të përcjellin filozofinë e tyre për një territor |

| | | |
|----------------------------------|--|---|
| | | <p>më të shëndetshëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të organizojnë shkëmbime me shkolla të tjera të rajonit; • Të nxjerrin dhe përpilojnë materiale informative si dhe të organizojnë orë të hapura në shkollë dhe komuniteti për të folur mbi risitë e menaxhimit, siç janë refuzimi, reduktimi, ripërdorimi apo riciklimi. |
| Grupet e intersit (grave) | <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet të mirë për banorët. | <ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në të gjitha grupet e diskutimeve, takimet apo qoftë dhe direkt në skemën e menaxhimit; • Të marrin pjesë aktive në diskutime dhe takime me aktorët e tjerë; • Të përcjellin problematikën familjare dhe më gjerë në mbështetje të përmirësimit të gjendjes; • Të mundësojnë zbatimin me sukses së skemës së menaxhimit duke edukuar amvisat e të gjithë bashki/NjAds |
| Biznesi | <ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojë largimin e mbetjeve të prodhuara nga shërbimi; • Të sigurojnë shëndet të mirë për banorët. | <ul style="list-style-type: none"> • Të marrë pjesë aktive në përcjelljen e problematikës së menaxhimit të mbetjeve; • Të mundësojë ide për reduktimin e mbetjeve dhe alternative të grumbullimit të tyre; • Të edukojë qytetarët mbi produktet që blejnë, ambllazhin, zëvendësimin e qeseve plastike, etj; • Të ndihmojë bashki/NjAdn në zbatimin me sukses të planit të menaxhimit dhe të mundësojë nisma për pastrimin e zonave të ndotura; • Të respektojë me rigorozitet të |

| | | |
|---------------------------------|--|---|
| | | gjitha hallkat e sistemit dhe të sigurojë vetë rrugë të tjera për mbetjet e veçanta si vajrat. |
| Banorët | <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet dhe mjedis të pastër për veten e tyre dhe brezat e ardhshëm • Të sigurojnë një jetë më cilësore pa çënuar burimet natyrore | <ul style="list-style-type: none"> • Të hedhin mbetjet në kosh, • Të paguajnë tarifën e shërbimit, • Të mos dëmtojnë kontenierët e mbetjeve • Të marrin pjesë aktive në mbështetje të zbatimit me sukses të PVMIMN ; • Të veprojnë në mënyrë ineraktive, duke lehtësuar edukimin e të gjithë banorëve të bashki/NjAds; • Të marrin pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë e parashikuara si dhe në ato në natyrë; • Të shpërndajnë informacione dhe dije ndërmjet tyre; • Të paraqesin pran ëbashki/NjAd stë gjithë idete, mendimet dhe shqetësimet për zbatimin me sukses të planit. |
| Vizitorët dhe emigrantët | <ul style="list-style-type: none"> • Të gjejnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm | <ul style="list-style-type: none"> • Të respektojnë rregullat e pastërtisë dhe qytetarisë; • Të sjellin përvojë dhe ide nga vendet nga ku ata vijnë; • Të marrin pjesë në diskutime dhe takime si dhe të komunikojnë me bashki/NjAdn mbi ide dhe shqetësime. |

1.10 MËNYRAT E KOMUNIKIMIT

Në lidhje me burimet kryesore të informacionit të përdorura dhe të besuara nga grupet e synuara për të qenë të informuar, janë përdorur si:

- Takime të drejtpërdrejta me banorët;
- Autoritetet vendore apo figura të tjera kompetente nga këshilli bashkiak (që ofrojnë këshilla për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane);
- Puna e OJF-ve që punojnë në territorin e bashkisë Dibër

Pagesa e tarifës është një koncept i vështirë për shumicën e individëve në këtë bashki, përqindja shumë e ulët e grumbullimit të lejon të mendosh që niveli i besimit është shumë i ulët për të paguar shërbimet, shoqëruar kjo dhe me gjendjen e keqe ekonomike të shumë familjeve në këtë bashki. Në raportin e fundit të bankës botërore mbi Varfërinë në Shqipëri, Bashkia Dibër renditet si një nga rajonet më të varfëra ku 46 % e popullsisë së saj trajtohet me ndihmë ekonomike. Për të kapërcyer pengesa të tilla është i nevojshëm që të ndërtohet një sistem i bazuar tek bashkëpunimi i ngushtë si dhe komunikim i drejtpërdrejtë ndërmjet Bashkisë, Administratorëve dhe Kryepleqve të fshatrave.

Për secilin prej audiencave të synuara veprimet e propozuara kanë qenë një ndërthurje e veprimtarive të mëposhtme, në varësi të grupit të synuar të caktuar:

Tabela 4

| | |
|------------|---|
| 1. BOTIMET | <p>Botimet përfshijnë: Fletëpalosjet, postera, etiketa për kontenierët e mbetjeve.</p> <p>Në përgjithësi, botimet janë një mjet i përshtatshëm për shpërndarjen e informacionit, edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.</p> |
| 2 NGJARJET | <p>Ngjarjet janë një mjet efektiv komunikimi përmes të cilave bëhet edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të audiencës së synuar. Ato përfshijnë: Takime pune informuese, Seminare dhe diskutime të përgjithshme publike.</p> <p>Një komunikim dhe bashkëpunim më i mirë mes aktorëve vendor dhe banorëve do të krijojë sinergji dhe do t'i japë forcë përpjekjeve të përbashkëta për zbatimimin e PVMIMN dhe një menaxhim më të mirë të situatës së mbetjeve duke rritur ndërgjegjësimin e dhe besimin e banorëve në shërbimet publike. Një mirëkuptim i përbashkët midis aktorëve do t'i sjellë një shpresë të re dhe mesazhe realiste komunitetit, i cili do të reagojë në një përfaqje më të prekshme.</p> |

3. AKTIVITETE MËSIMORE DHE EDUKATIVE


Aktivitetet edukative të veçanta janë trajnimet e mësuesve, aktivitetet në shkolla në mjediset e shkollës si konkurse ekspozita me punimet e fëmijëve me mbetje të ricikluara.

Një fokus të veçantë në aktivitetet mësimore dhe edukative do të duhet të fokusohet tek ripërdorimi i materialeve si për shembull shishe plastike, shishe qelqi, kavanozë dhe enë, rroba të vjetra, materiale të ndryshme paketimi, dru dhe goma. Bashki Dibër është një bashki e varfër nga ana ekonomike, prandaj ripërdorimi i materialeve është shumë i rëndësishëm për tu zbatuar nga banorët e saj. Promovimi i ripërdorimit të materialeve është një objektivi i arritshëm dhe mësuesit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ndërlëndore dhe jashtë shkollore apo dhe si projekte vjetore në shkollë do të duhet të sigurohen që ky proces të njihet sa më mirë nga nxënësit dhe të zbatohet në nivele sa më të larta të mundshme dhe në familje. Hapi i parë drejt zbatimit të kësaj politike do të duhet të jetë shkolla që ka si mision të saj ndërgjegjësimin qytetar.

Elementet më të rëndësishme që janë marrë në konsideratë gjatë zbatimit të veprimeve të propozuara janë:

- Përdorimi i mesazheve kryesore/temave të komunikimit për secilin grup të synuar;
- Shprehja e mesazheve në një mënyrë që tërheq vëmendjen që të mbahet mend nga audienca e synuar e cila shpreh një realitet të dëshiruar për ta;
- Përsëritja e vazhdueshme e mesazheve për një periudhë kohe të qëndrueshme
- Përdorimi i gjuhës jo teknike;
- Zhvillimi i mesazheve me qëllim jo vetëm informimin, por edhe motivimin e njerëzve për të ndërmarrë veprim;
- Monitorimi i përhershëm e sistematik dhe vlerësimi i informacionit që përcillet

Për të përcjellë mesazhet e fushatës dhe në mungesë të kanaleve mediaticë lokale, ekipi i REC Shqipëri mendoi si më të përshtatshme të ndiqet skemë "Nxit ndryshimin" (*push for change*). Figura 2 paraqet në mënyrë skematike atë cka pritet të realizohet nëpërmjet ngjarjeve dhe organizimit të aktiviteteve të fushatës.



Kjo skemë bazohet në transmetimin e masazhit të fushatës dhe asaj cka po ndodhte së fundmi në bashki me menaxhimin e mbetjeve "nga një person tek tjertri".

Nxitja e fëmijëve duke organizuar aktivitetin "Ambasadori i Gjelbër" në shumë prej shkollave 9-vjeçare të qytetit dhe njësisiv e më të mëdha administrative, dhe pajisja e tyre me certifikatë mirënjohje për të transmentuar mesazhet e fushatës në familje, ishte një garanci për të arritur një audiencë të gjerë. Kurioziteti i fëmijëve për aktivitete jashtëshkollore dhe informacioni i lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe ndikimin negative tek shëndeti, ishte një element me rëndësi, që garatonte që mesazhet e dhëna tek fëmijët në shkollë do të mbërrinin në familje.

Gjithashtu certifikata për nxënësit e përfshirë në aktivitetin "Ambasadorët e Gjelbër" e firmosur nga vetë kryetari i bashkisë Dibër, ishte një mjet i cili i jepte këtij aktiviteti autorësinë e bashkisë, jo vetëm si përfituesja kryesore e gjithë procesit por si ofruesja e shërbimit për banorët e Dibrës, duke kërkuar njëkohësisht bashkëpunimin tyre në mbështetje të zbatimit të PVMIMN dhe pagimin e tarifës së shërbimit.

Tabela 5 – ofron një përshkrim të hollësishëm të të gjitha botimeve dhe materialeve promociionale të përdorura si mjeteve të fushatës

| Nr. | Produkti | Përshkrimi | Hollësi teknike | Grupe të synuara | Procesi i zbatimit |
|-----|-------------------|---|---|--|---|
| 1 | Moto | <p>Motoja përfaqëson thelbin e mesazheve në PVMIMN dhe bazohet në procesin e shqyrtimit të njohurive, qëndrimeve dhe sjelljes së audiencave të përkufizuara gjatë vizitave në terren</p> <p>Motoja e fushatës është “Dibrën e dua të pastër”</p> | <p><i>Motoja do të jetë pjesë e të gjitha materialeve promovuese dhe informuese të ndërgjegjësimit publik.</i></p> | <p>Të gjitha audiencat e synuara të identifikuara për qëllimet e këtij projekti.</p> | <p>Do të përdoren si kryefjalë, shprehjeje në aktivitetet edukuese dhe takimet si dhe në të gjitha produktet e shtypura</p> |
| 2. | Imazhi i fushatës | <p>Imazhi është identiteti pamor i fushatës së ndërgjegjësimit. Ajo përmban elementët ikonë pamore që ilustrjnë objektivat kryesore të fushatës drejt publikut të përgjithshëm dhe grupet e synuara. Malet e lartë dhe banesat si imazhe të qendrave të banuara shoqërojnë një seri ikonash që lidhen me PVMIMN makina teknologjike, kontenierë me ngjyrë të gjelbër për të vizualizuar dhe theksuar marrëdhënien e ngushtë të këtyre elementëve (fjalë, dizenjo dhe ngjyrë) me rëndësinë e menaxhimit si mekanizëm parakusht për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në zonë.</p> | <p><i>Imazhi do të jetë me ngjyra ku mbizotëron ajo e gjelbër. Do të ketë raporte të caktuara me qëllim që të jetë e dukshme në të gjitha materialet promociionale që do të përdoren.</i></p> | <p>Të gjitha audiencat e synuara të identifikuara për qëllimet e këtij projekti.</p> | <p>Imazhi do të jetë pjesë e të gjitha produkteve që shoqërojnë fushatën ndërgjegjësuere dhe informuese</p> |

| | | | | | |
|----|-----------------------|--|--|---|---|
| 3. | Fletëpalosje 1 | <p>Fletëpalosja për zonë e parë e kryesore të shërbimit. Ajo është një material i lehtë për t'u shpërndarë, çka lehtësohet nga formati i saj i vogël. Informacioni ofrohet me tekst dhe foto çka lehtëson përcjelljen e mesazheve përkatëse për mjedisin dhe largimin e mbetjeve.</p> <p>Fletëpalosja ka një seksion të veçantë për secilën prej zonave të shërbimit ku publiku i interesuar mund të t'i drejtohet zyrës së informacionit të bashkisë përkatëse për më shumë informacion mbi menaxhimin e mbetjeve në zonën ku ai/ajo banon.</p> <p>Do të përmbajë moton dhe imazhin e fushatës.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 20 x 42 cm • Numri i faqeve – 2 faqe • 4 ngjyra (CMYK) • Do të botohet në 500 kopje • Palosur katërsh (në formën 10x10 cm) | <ul style="list-style-type: none"> • Administrata publike • Nxënës të shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe atyre profesionale. • Anëtarët e OJQ-ve që punojnë në zonë me fokus tek mjedisi, gratë, probleme të komunitetit; • Media lokale; • biznese të ndryshme në zonë; | <ol style="list-style-type: none"> 1. Takime publike me bashkitë dhe aktorët lokalë; 2. Trajnim i mësuesve dhe OJQ-ve; 3. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla; 4. Fushatë pastrimi |
| 4. | Fletëpalosje 2 | <p>Fletëpalosja 2 do të jetë e fokusuar në zonë e dytë të shërbimit për të ofruar një informacion mbi vecoritë që paraqet këtu shërbimi i mbetjeve. Ajo iu bën ftesë banorëve të fshatrave që të ndajnë mbetjet organike nga ato jo organike. Asyeja e ndarjes së mbetjeve në fshatra lejon që të mos krijohen mbetje të panevojshme për depozitimin në landfill. Një material i lehtë për t'u shpërndarë, çka lehtësohet nga formati i saj i vogël. Do të përmbajë moton dhe</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 10.5 x 29 cm • Numri i faqeve – 2 faqe • 4 ngjyra (CMYK) • Do të botohet në 200 kopje | <ul style="list-style-type: none"> • Administrata publike • Nxënës të shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe atyre profesionale. • Anëtarët e OJQ-ve që punojnë në zonë me fokus tek mjedisi, gratë, probleme të komunitetit; • Media lokale; • biznese të ndryshme në zonën e Maqellarë Melan; | <ol style="list-style-type: none"> 1. Takime publike me bashkitë dhe aktorët lokalë; 2. Trajnim i mësuesve dhe OJQ-ve; 3. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla; 4. Fushatë pastrimi |

imazhin e fushatës.

| | | | | | |
|-----------|-----------------------|--|---|--|--|
| 5. | Fletëpalosje 3 | Fletëpalosja 3 është parashikuar vetëm për zonë pilot të Kalasë së Dodës, e fokusuar në ndarjen e mbetjeve. Zona pilot në PVMIMN i kushton rëndësi vlerave natyrore dhe turistike të zonës dhe pritet të ofrohet një shërbim me thaës mbetjesh dhe tërheqje. Një material i lehtë për t'u shpërndarë, çka lehtësohet nga formati i saj i vogël. Do të përmbajë moton dhe imazhin e fushatës. | <ul style="list-style-type: none">• Formati 10.5 x 29 cm• Numri i faqeve – 2 faqe• 4 ngjyra (CMYK)• Do të botohet në 200 kopje | <ul style="list-style-type: none">• Administrata publike• Nxënës të shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe atyre profesionale.• Anëtarët e OJQ-ve që punojnë në zonë me fokus tek mjedisi, gratë, probleme të komunitetit;• Media lokale;• biznese të ndryshme në zonë; | <ol style="list-style-type: none">1. Takime publike me bashkitë dhe aktorët lokalë;2. Trajnim i mësuesve dhe OJQ-ve;3. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla;4. Fushatë pastrimi |
|-----------|-----------------------|--|---|--|--|

| | | | | | |
|----|--|---|--|---|---|
| 6. | Postera Informativë | <p>Posteri, si pjesë e një fushate ndërgjegjësuere ka pikërisht qëllimin që të komunikojë moton kryesore të fushatës. Për ta bërë këtë ai duhet të tërheqë vëmendjen e një personi, aq gjatë sa të mundësohet kuptimi dhe perceptimi i motos.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 50 x 70 cm • Do të shtypen 300 copë | Popullsia e përgjithshme | Vendet për ekspozim do të përcaktohen me ekipin e projektit dhe drejtorinë e shërbimeve në bashki. |
| 7 | Certifikta Ambasadori i gjelbër | <p>Do të prodhohen 500 certifikta me logo për shpërndarje për nxënësit e shkollave në aktivitetet mjedisore.</p> <p>Fokusi kryesor do të jenë nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme rrotull tri zonave kryesore (peshkopi, Maqellarë dhe Kastriot) Do të përmbajë imazhin e projektit dhe mirënjohjen për përhapjen e këtij imazhi në familje dhe përtej.</p> <p>Firmosur nga kryetari i bashkisë për ti dhënë dhënë një karakter më lokal aktivitetit dhe përcjelljes së mesazhit</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati A4 • Numri i faqeve – 1 faqe • 4 ngjyra (CMYK) • Do të botohet në 500 kopje | <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit e shkollave në zonat e shërbimit I dhe II. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktiviteti “Ambasadori i Gjelbër: në shkolla me fokus shpërndarjen e mesazhit në familjet dibrane. 2. Aktiviteti i ngritjes së këndeve të riciklimit në 6 prej shkollave më të mëdha në Bashkinë Dibër. |
| 8 | Stema (Pins) për ambasadori gjelbër | <p>Do të prodhohen 500 stema me moton e fushatës për shpërndarje për nxënësit e shkollave në aktivitetet mjedisore.</p> <p>Imazhi kryesorë i stemës nënkupton shpërndarjen e informacionit të marrë nëpërmjet aktivitetit të zhvilluar në klasa dhe në shkollë. Do të përmbajë</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 5 cm • 2 ngjyra | <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit e shkollave në zonat e shërbimit I dhe II. | <ol style="list-style-type: none"> 3. Aktiviteti “Ambasadori i Gjelbër: në shkolla me fokus shpërndarjen e mesazhit në familjet dibrane. 4. Aktiviteti i ngritjes së këndeve të riciklimit në 6 prej shkollave më të mëdha në Bashkinë Dibër. |

moton e fushatës.

Fokusi kryesor do të jenë nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme rrotull tri zonave kryesore (Peshkopi, Maqellarë dhe Kastriot)

| | | | | | |
|----|---|---|--|---|---|
| 9 | <p>Thasë plastike mbetjesh me moto</p> | <p>Do të prodhohen 5500 thasë plastike mbetjesh me moton e fushatës për shpërndarje tek banorët e njësisë Administrative Kala e Dodës dhe banorët e lagjes Stajkë në qytetin e Peshkopisë</p> <p>Nj.Ad Kala e Dodës shumica e mbetjeve janë organike për vetë faktin që zona ka në përgjithësi karakter rural. Megjithatë, riciklimi është i mundshëm</p> <p>Të gjithë qytetarët dhe bizneset në këto fshatra do të inkurajohen dhe edukohen të shmangin plotësisht mbetjet organike nga sistemi i menaxhimit.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 80 x 120 cm • gramatura – 2 faqe • kapaciteti 120 litra • ngjyra (e verdhë) • stampimi ngjyrë e zezë • sasia 500kg • Prodhimi 5550 thasë | <ul style="list-style-type: none"> • Banorët e njësisë Administrative Kala e Dodës dhe banorët e lagjes Stajkë në qytetin e Peshkopisë | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla; 2. Fushatë pastrimi 3. Thasët do të përdoren nga këta banorë gjatë vitit të parë të zbatimit të skemës së propozuar për zonën pilot të Kalasë së Dodës dhe Lagjen Stojkë në qytetin e Peshkopisë ku shërbimi do të oftohet demë më derë. |
| 10 | <p>Sistem me 3 kosha për në bulevard</p> | <p>Një sistem i grumbullimit të mbetjes së ricikluar nga banorët që vizitojnë zonën e gjelbër të qytetit të Peshkopisë (në bulevardin kryesor) do të mundohet të grumbullojë sa më shumë mbetje të thatë të mundshme</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Sistem me tre kosha • kapaciteti 120 litra • ngjyra (tre ngjyra, e kuqe , e verdhë, e gjelber) • etiketë për llojin e mbetjes • sasia 6 kosha | <ul style="list-style-type: none"> • Vizitorët e zonës së gjelbër të qytetit të Peshkopisë (në bulevardin kryesor) | <p>Zbatimi i një skeme për diferencimin e mbetjeve në qytetin e Peshkopisë</p> |

| | | | | | |
|----|--|---|--|---|---|
| | | Mbetjet e ndara sipas 3 rrymave do të tërriqen e depozitohen nga bashkia, për të nisur kështu një nismë riciklimi formale. | | | |
| 11 | Kosh i personalizuar për bateri në boulevard | Në zonën e gjelbër të qytetit të Peshkopisë (në bulevardin kryesor) do të vendoset dhe një kosh i veçantë, i personalizuar me formën e baterisë për grumbullimin e kësaj rryme shumë të rrezikshme mbetjeje. Do të mendohet të vendoset afër ndonjë institucioni për të siguruar qëndrueshmërinë e tij në boulevard. | <ul style="list-style-type: none"> • kosh me kapak i personalizuar për bateri • kapaciteti 60 litra • etiketë për llojin e mbetjes • sasia 1 kosha | <ul style="list-style-type: none"> • Vizitorët e zonës së gjelbër të qytetit të Peshkopisë (në bulevardin kryesor) | Aktiviteti pilot që lidhet me riciklimin Zona e Gjelbër (bulevardi kryesor) ku do të vendosen kosha për tre bateritë si një zgjidhje inovative |
| 12 | Etiketa për kontenierët | Lagjet kryesore të qytetit do të kenë skema pilote më dy kosha për grumbullim të diferencuar të mbetjeve, ku në njërin kosh do të jetë mbetja e thatë dhe në tjetrin mbetja organike . | <ul style="list-style-type: none"> • Formati A3 • Numri i faqeve – 1 faqe • 4 ngjyra (CMYK) • Do të prodhohen rreth 130 etiketa të tilla | <ul style="list-style-type: none"> • Popullsia e përgjithshme | Aktiviteti i përditshëm i administrimit të mbetjeve nga bashkia Aktiviteti i përditshëm i banorëve që hedhin mbetjet në kontenierët përkatës |
| 13 | Etiketa për kamionin teknologjik | Etiketimi i Kamionit që do të bëjë grumbullimin e mbetjeve në zonën e parë e kryesore të shërbimit. Transportimi i mbetjeve nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me kamionë të posaçëm dhe të mbuluar, ngarkesa e të cilëve nuk | <ul style="list-style-type: none"> • Formati 150x200 cm • Numri i faqeve – 1 faqe • 4 ngjyra (CMYK) • Do të realizohen 2 kopje për të dy anët e makinës teknologjike | <ul style="list-style-type: none"> • Popullsia e përgjithshme | Aktiviteti i përditshëm i grumbullimit dhe tërheqjes së mbetjeve nga bashkia |

| | | | | | |
|----|--|--|---|---|--|
| | | rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve | | | |
| 14 | Kënde riciklimi në shkolla me sistem 3 koshash | Edhe në shkolla do të futet sistemi i ndarjes së mbetjeve me një sitem me 3 kosha të personalizuar sipas ngjyrave të caktuara dhe etiketimeve sipas rrymës së mbetjeve. Gjithashtu dhe një baner ose poster me moto për të nxitur riciklimin do do të jetë pjesë e këndëve të riciklimit në shkollat me numrin më të madh të nxënësve në këtë bashki | <ul style="list-style-type: none"> • Sistem me tre kosha me kapak dhe pedal • kapaciteti 120 litra • ngjyra (tre ngjyra, e kuqe , e verdhë, e gjelber) • etiketë për llojin e mbetjes • sasia 15 kosha | <ul style="list-style-type: none"> • Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Peshkopisë | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitete riciklimi në shkolla; 2. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla; 3. Fushatë pastrimi |
| 15 | Materiale burimore për mësuesit në ndihmë të orëve mësimore për edukim mjedisor dhe vecanërisht hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve | Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve përcakton rendin e preferuar të praktikave për menaxhimin e mbetjeve, nga më të preferuarat në ato më pak të preferuara. Ky informacion është ende i panjohur plotësisht nga mësuesit dhe sigurisht nxënësit. Megjithatë, në nivel shkollash do të edukohen individët për përdorimin e çantave prej beze gjatë blerjes së produkteve. Rezultatet e kësaj politike do të jenë të vështira për t'u matur por mund të vëzhgohen. | Paketa e Gjelbër – material burimor për shkollat 9-vjeçare | <ul style="list-style-type: none"> • Mësuesit dhe specialistët e DAR Dibër | <ol style="list-style-type: none"> 1. Takime publike me mësues dhe specialist të DAR Dibër; 2. Trajnim i mësuesve dhe OJQ-ve; 3. Aktivitete ndërgjegjësimi në shkolla; 4. Projekte mjedisore në shkolla, orë mësimore ndërlëndore me fokus edukimin mjedisor fokusuar tek mbetjet; |

1.11 MENAXHIMI I FUSHATËS (ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE)

Kalendari i organizimit të veprimtarive komunitare për informim-ndërgjegjësimin për të gjithë territorin gjatë viteve 2016-2017n (Tabela 6)

| Nr | Aktivitete | 2016 | | | | | 2017 | | | | | Statusi dhe Shënime | | |
|----|---|---------|---------|---------|---------|----------|-----------|---------|---------|---------|---------|---------------------|----------|--|
| | | 1- 2 | 3- 4 | 5- 6 | 7- 8 | 9- 10 | 11- 12 | 1- 2 | 3- 4 | 5- 6 | 7- 8 | | 9- 10 | |
| 1 | Anketimi bazë nëpërmjet pyetësorëve | x | x | | | | | | | | | | | Kryer |
| 2 | Inervista me përfaqësues të institucioneve vendore | x | x | | | | | | | | | | | Kryer |
| 3 | Studimi i situatës nëpërmjet Intervistave dhe diskutimet në grup | x | x | | | | | | | | | | | Kryer |
| 4 | Konsultimi me ekspertët | | x | x | | | | x | x | x | | | | Kryer |
| 5 | Trajnim me OJFte | | x | | | | | | | x | | | | Kryer |
| 6 | Takime të hapura | | | x | | | | | | x | x | | | Takim i hapur me aktorët më të rëndësishëm vendor, punonjës të bashkisë, drejtues të njësive administrative, Kryepleqtë, qendrat shëndetore dhe organizatat komunitare në Peshkopi |
| 7 | Draftimi i përfaqësues në lidhje me PNEK | | | | | | x | x | | | | | | Kryer |
| 8 | Organizimi i takimeve të punës me DAR Dibër | | | | | | | | x | x | x | x | x | Kryer |
| 9 | Zhvillimi i shprehjes tërheqëse dhe identitetit pamor | | | | | | | | | x | | | | Kryer |
| 10 | Postera (500 copë me përmasa 50x70 cm) + shpërndarje në Peshkopi, Maaqellarë, Kastriot, Kala e Dodës | | | | | | | | | | x | x | x | Kryer |
| 11 | Spilla Amabsadori Gjelbër 500 copë + shpërndarje | | | | | | | | | | x | x | x | Kryer |
| 12 | Certifikata Ambasadori i gjelbër (A4) + shpërndarje | | | | | | | | | | | | | Kryer |
| 13 | Fletëpalosje1 për Zonë e parë të shërbimit + shpërndarje në Peshkopi | | | | | | | | | | x | x | x | Kryer |
| 14 | Fletëpalosja 2 për Zonë e dytë të shërbimit (10.5 x 29.7 cm) 500 copë + shpërndarje Maqellarë dhe Melan | | | | | | | | | | | x | x | Kryer |

| | | | | |
|----|--|---|-----|--|
| 15 | Fletëpalosja 3 për Zonë e pilot të shërbimit (10.5 x 29.7 cm) 500 copë + shpërndarje Kala e Dodës | X | | Kryer |
| 16 | Etiketa Informuese (A3) 130 copë (pa montim) | | X | Etiketa Informuese (A3) për kontenerët e qytetit të Peshkopisë (130 copë (pa montim) |
| 17 | Trajnim dy ditor për mësuesit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve | X | | <ul style="list-style-type: none"> • Të rriten shprehitë praktike dhe pedagogjike dhe njohuritë mbi mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve; • Të rritet ndërgjegjësi mbi rëndësinë e përfshirjes së edukimit mjedisor në programin shkollor; • Të ndihmohen mësuesit që të integrojnë konceptet e mjedisit në programet shkollore dhe, për pasojë, të maksimalizojnë të nxënëit e nxënësve; • Të mbështeten shkollat për të zhvilluar praktikat më të mira në edukimin mjedisor dhe zgjidhjet inovatore për çështje të mbetjeve; Të prezantohet Shërbimi i Ri i Menaxhimit të Mbetjeve |
| 18 | Takim i hapur për të diskutuar PVMIMN | X | | Kryer |
| 19 | Organizimi i aktivitetit Ambasadori i Gjellbër | X | X | Kryer |
| 20 | Aktivitete në Shkollat 9-vjeçare si dhe inagurimi i kënditë të riciklimit në shkolla | | X | Prezantimi i dokumentarëve apo filmave të ndryshëm në shkollë, siç është "Planeti Plastik", i sjellë në shqipëri nga REC Shqipëri dhe që flet mbi rrezikun e plastikës në jetën tonë; |
| 21 | Stamimi i tashëve së mbetjeve me moton dhe logo | X | | Kryer I janë dorëzuar Bashkisë Dibër me process verbal dhe pritet të shpërndahen prej saj sipas sugjerimeve të PVMIM Do të shpërndahen nga bashkia në momentin e ofrimit të shërbimit |
| 22 | Organizimi i takimeve dhe shpërndarjes së posterave dhe fletëpalosjeve nga OJFtë mjedisore | | X X | Kryer Bashkëpunimi me tre prej OJFve mjedisore që punojnë me komunitetin në këtë bashki ka lehtësuar procesin e shpërndarjes së materialeve të fushatës dhe mesazhet e saj. Sinergji me organizatat komunitare "Agritra" Change the future" dhe Delfini |
| 23 | Anketim pas projektit | | X | |

1.12 **INDIKATORËT E SUKSESIT TË PLANIT TË NDËRGJEGJËSIMIT, EDUKIMIT DHE KOMUNIKIMIT**

Matja e suksesit të PNEK është e vështirë, pasi të masësh njohuritë dhe rritjen e njohurive nuk është kaq e thjeshtë, përveç nëse angazhohet me shumë burime dhe fonde. Megjithatë, për të parë nëse fushatat janë efektive, disa indikatorë, të cilët do t'i shërbenin përmirësimit të punës në ardhmen do të ishin:

- ✓ Numri i aktiviteteve të zbatuara gjatë një viti apo një periudhe të caktuar;
- ✓ Pjesëmarrja nëpër takime;
- ✓ Numri i kërkesave, ankesave apo opinioneve të përcjella nga komuniteti;
- ✓ Cilësia e pastëritisë në Bashki (nuk ka mbetje jashtë kazanëve, nuk ka vende të reja depozitimi të paligjshme, etj);
- ✓ Numri i aktiviteteve mjedisore të organizuara në Shkollë dhe të trajtuara në orët mësimore;
- ✓ Veçanërisht niveli i mbledhjes së tarifës, sidomos në mënyrë vullnetare nga banorët dhe grupet e tjera.

Për të bërë të mundur këto vrojtime dhe vlerësime, do të përdoren forma të ndryshme vlerësimi, të tilla si pyetësi i përdorur gjatë hartimit të këtij plani dhe që gjenden bashkëlidhur këtij plani.

1.13 ANEKSET



Dibrën e dua të pastër!



Bëj një veprim të thjeshtë e qytetar
HIDH MBETJET NË KOSH!



Fushatë ndërgjegjësimi për fuqizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibrë 2017





Bashkia Dibrë



Certifikatë

Ambasadori i Gjelbër

I jepet

për përfshirjen aktive në fushatën e ndërgjegjësimit
"Dibrën e dua të pastër"

me detyrën e veçantë që mesazhet e kësaj fushate
të përcillen në familje e më gjerë

Prill- Maj 2017

organizuar në kuadër të projektit
"Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibrë"

Kryetari i Bashkisë Dibrë
Muharem Rama





Bashkia Dibrë

Dibrën e dua të pastër!




Sistemi i ri i menaxhimit të mbetjeve Zona 2 e shërbimit Njësitë Administrative Maqellarë - Melan



Bëj një veprim të thjeshtë e qytotar

**veço mbetjet e thata
dhe hidhi në kosh**

Fushatë ndërgjegjësimi për thuajtërin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Dibrë 2017



Informacion mbi sistemin e ri të menaxhimit të mbetjeve

Zona 2 e shërbimit shtrihet
në Njësitë Administrative
Maqellarë dhe Melan.
Shërbimi i ri do të mbulojë
të gjithë fshatrat që lidhen
me rrugë të asfaltuar.

mbetje të thata janë:
plastika, letra, qelqi, aluminet.



Zona 2 e mbetjeve Maqellarë - Melan

Në qendrën e çdo fshati
do të gjeni kazanët e mbetjeve.

Në secilin nga fshatrat,
në një orë të caktuar,
do të mbërrijë makina teknologjike
për të marrë mbetjet tuaja.

Banorët që nuk kanë kazanë pranë
shtëpive të tyre, mund t'i mbajnë mbetjet
në qese dhe t'i dorëzojnë punëtorëve
të shërbimit, në orën që kalon kamioni.

SHËRBIMI SHKURTIMISHT

**Informohuni nëpërmjet
administratorit dhe/ose kryeplakut.**

**Ky shërbim
ka nevojë për ty!
Me vetëm 124 lekë
në muaj për familje
pagesë tarife,
siguroni shëndetin
e fëmijëve tuaj
dhe një mjedis
të këndshëm.**

Informacion

Projekti "Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër" ka si qëllim përmirësimin e gjendjes së shërbimit të mbetjeve në Bashkinë e Dibërës.


Për zbatimin e këtij projekti, Bashkia Dibër do të bashkëpunojë në nivel teknik dhe financiar me projektin dldp (projekti për decentralizimin dhe zhvillimin vendor), si dhe me ekspertët, të cilet do të përzgjidhen për të lehtësuar punën e Bashkisë.

Projekti ka si synim:


- Hartimin dhe miratimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për të gjithë territorin e Bashkisë Dibër.
- Mbulimin e të gjithë territorit të njësive administrative Peshkopi me sistemin e ri të menaxhimit të mbetjeve.
- Zgjerimin e territorit që mbulon shërbimi i mbetjeve me 36%, duke shtirë shërbimin në nivel bashkie për 58% të popullsisë.
- Hartimin dhe zbatimin e një fushate informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve.

Në këtë projekt do të angazhohen dhe do të përfitojnë drejtpërdrejt tre grupe kryesore të gjenerimit të mbetjeve:

- Banorët; 2) Biznesi; 3) Institucionet.




Dibrën e dua të pastër!



Sistemi i ri i menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Peshkopisë

Për një vendbanim të shëndetshëm e qytetar HIDH MBETJET NË KOSHI

Fushatë ndërgjegjësimi për fuqizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Dibër 2017



Informacion mbi sistemin e ri të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër

Sistemi i ri i menaxhimit të mbetjeve do të shtrihet në dy zona kryesore shërbimi:

Zona e parë kryesore e shërbimit Peshkopi – Tomini

Kjo zonë shërbimi përfshin pjesën më të populluar të Bashkisë Dibër. Shërbimi do të mbulojë të gjithë qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat e arritshëm të Tominit, Kastriotit dhe Luznisë. Sistemi i ri i shërbimit do të ketë konteniere të rinj dhe një kamion të ri për grumbullimin e mbetjeve. Si rrjedhojë, do të arrihet përmirësimi i ndjeshëm i shërbimit për rreth **29.000 banorë dhe rreth 1.018 njësi biznesi**. Gjithashtu, në kuadër të këtij sistemi të ri, do të përmirësohet fusha e depozitimit të mbetjeve dhe largimi i mbetjeve do të bëhet çdo ditë të javës.

Në këtë zonë (kudo ku do të jetë e mundur) do të vendoset një sistem me dy konteniere, të shënjuar se ku do të hidhen mbetjet e thata dhe ku ato të rjoma.

Zona e dytë kryesore e shërbimit Maqellarë – Metan

Nga shërbimi i ofruar në zonën e dytë, do të përfillojë një popullsi prej **18.037 banorësh**, si dhe shumë njësi biznesi në këto njësi administrative. Sistemi i ri do të ofrojë për herë të parë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve për banorët e njësive administrative Kastriot, Fushë Çidhe, Slllovë, Kala e Dodës dhe Muhur.

Njësia administrative **Kala e Dodës** do të fillojë e para modelin alternativ të grumbullimit të mbetjeve të thata në thasë. Tërheqja e tyre do të bëhet me kamion, dy herë në muaj. Kjo skemë do të zbatohet për herë të parë në një zonë të izoluar, me vlera të rralla natyrore, por dhe e arritshme nga infrastruktura rrugore. Kjo qasje e re në zonë do të ndihmojë në promovimin e vlerave natyrore të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik.

Zonat e reja të shërbimit





Zbatimi i skemave të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Peshkopisë

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane parashikon që qyteti i Peshkopisë, si qendra e aktivitetit njerëzor dhe institucional, do të ketë disa skema pilote për menaxhimin e mbetjeve.

Siç tregohet edhe në hartën e mësipërme, qyteti do të ketë katër zona të reja për menaxhimin e mbetjeve, që gjenerohen brenda kufijve të qytetit.

Sistemi i ri i menaxhimit të mbetjeve kërkon kontributin e të gjithë qytetarëve të Dibërës, përmes rregullimit të traditës së pastërtisë edhe përmjet mureve të shtëpisë.

Çdo ditë mund të ndihmojë për një Dibër sa më të pastër, duke kryer, lehtësisht 4 veprime të thjeshta:

- Ripërdor që të zvogëlosh sasinë e mbetjeve që hedh në kosh.**
- Hidh mbetjet në koshat e caktuar sipas llojit të mbetjes.**
- Hidh gjithmonë mbetjet brenda në kosh.**
- Paguaj tarifën e shërbimit prej veitëm 3 lekë në ditë.**

Zona 1 – Zona e Gjelbër

Si imazhi kryesor i qytetit të Peshkopisë, bulevardi do të ketë sistem për ndarjen e mbetjeve, ku do të përfshihet edhe një kosh i veçantë për batanë, si rrymë mbetjesh tepër e rrezikshme.

Zona 2 - Sistemi me dy kosha për ndarjen e mbetjeve

Në këtë zonë, kudo ku do të jetë e mundur, do të vendoset një sistem me dy konteniere, të shënjuar se ku do të hidhen mbetjet e thata dhe ku ato të rjoma. Një nisim e tillë do të fokusohet në qendër të lagjeve.

Zona 3 - Lagjia "Stojko" me grumbullimin derë më derë

Lagjia Stojko ka akses të kufizuar për të vendosur një strukturë tipike me konteniere për grumbullimin e mbetjeve. Për këtë arsye, është menduar që në këtë lagje shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të jetë derë më derë. Për t'u zbatuar kjo skemë, qytetarët do të informohen për orët kur do të kalojë kamioni dhe se kur punëtorët do të hyjnë në lagje për të marrë mbetjet, në mënyrë që të lenë mbetjet e tyre tek dera.




Fushatë ndërgjegjësimi për fuqizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Dibër



DIBRËN E DUA TË PASTËR!

hidh në këtë thes vetëm mbetje të thata të shtëpisë!
letër, plastikë, qelq, alumin



Në kuadër të fuqizimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Dibër (2017)



Regjistrimet per vitin shkollor 2016-2017, arsimi i detyruar

| Emri i shkolles | Emri i Njesise Lokale | Emri i Qytetit/Fshatit | Mesues gjithsej (perfshire drejtuesit) | |
|-----------------|-----------------------|------------------------|--|-------|
| | | | Gjithsej | Femra |
| Irfan Hajrrulai | Peshkopi | Peshkopi | 28 | 21 |
| Selim Alliu | Peshkopi | Peshkopi | 44 | 35 |
| Demir Gashi | Peshkopi | Peshkopi | 40 | 31 |
| Myslim Shehu | Peshkopi | Peshkopi | 19 | 14 |
| Tomin | Tomin | Tomin | 12 | 8 |
| Dohoshisht | Tomin | Dohoshisht | 11 | 8 |
| Selane | Tomin | Selane | 1 | 1 |
| Çetush | Tomin | Çetush | 2 | 2 |
| Shimçan | Tomin | Shimçan | 5 | 1 |
| Staravec | Tomin | Staravec | 2 | 1 |
| Brezhdan | Tomin | Brezhdan | 20 | 11 |
| Ushтеленxë | Tomin | Ushтеленxë | 4 | 2 |
| Haki Stërmilli | Melan | Melan | 9 | 6 |
| Illicë | Melan | Illicë | 1 | 1 |
| Melan | Melan | Melan | 1 | 1 |
| Pjeçë | Melan | Pjeçë | 2 | 2 |
| Pejkë | Melan | Pejkë | 2 | 2 |
| Trepçë | Melan | Trepçë | 1 | 0 |
| Alush Bunguri | Melan | Alush Bunguri | 9 | 6 |
| Trenë | Melan | Trenë | 1 | 1 |
| Shemsi Haka | Melan | Bellovë | 9 | 4 |
| Rabdisht | Melan | Rabdisht | 1 | 1 |
| Zagrad | Melan | Zagrad | 1 | 1 |
| Cerjan | Melan | Cerjan | 1 | 0 |
| Maqellarë | Maqellarë | Maqellarë | 26 | 18 |
| Vojnikë | Maqellarë | Vojnikë | 3 | 3 |
| Kovashicë | Maqellarë | Kovashicë | 3 | 3 |
| Pocest | Maqellarë | Pocest | 15 | 10 |
| Katund I Vogël | Maqellarë | Katund I Vogël | 2 | 2 |
| Nazmi Rushiti | Maqellarë | Dovolan | 12 | 8 |
| Dovolan | Maqellarë | Dovolan | 2 | 2 |
| Grezhdan | Maqellarë | Grezhdan | 2 | 2 |
| Erebarë | Maqellarë | Erebarë | 3 | 3 |
| Herbel | Maqellarë | Herbel | 1 | 0 |
| Popinare | Maqellarë | Popinare | 1 | 0 |
| Gradec | Maqellarë | Gradec | 1 | 0 |

| | | | | |
|--------------------|-------------|--------------------|----|----|
| Kërçisht | Maqellarë | Kërçisht | 14 | 9 |
| Kërçisht I Poshtëm | Maqellarë | Kërçisht I Poshtëm | 3 | 3 |
| Kërçisht I Epërm | Maqellarë | Kërçisht I Epërm | 0 | 0 |
| Majtarë | Maqellarë | Majtarë | 22 | 18 |
| Burim | Maqellarë | Burim | 2 | 2 |
| Billate | Maqellarë | Billate | 1 | 1 |
| Potgerce | Maqellarë | Potgerce | 1 | 1 |
| Kastriot | Kastriot | Kastriot | 16 | 11 |
| Kandër | Kastriot | Kandër | 3 | 1 |
| Sohodoll | Kastriot | Sohodoll | 16 | 10 |
| Boravjan | Kastriot | Boravjan | 1 | 1 |
| Vranjt | Kastriot | Vranjt | 9 | 2 |
| Limjan | Kastriot | Limjan | 2 | 0 |
| Koben | Kastriot | Koben | 13 | 7 |
| Luzni | Luzni | Luzni | 12 | 3 |
| Lishan I Epërm | Luzni | Lishan I Epërm | 1 | 0 |
| Arap I Epërm | Luzni | Arap I Epërm | 1 | 1 |
| Murate | Luzni | Murate | 1 | 1 |
| Katund I Ri | Katund I Ri | Katund I Ri | 14 | 5 |
| Hotesht | Hotesht | Hotesht | 2 | 1 |
| Muhurr | Muhurr | Muhurr | 13 | 9 |
| Vajmdhej | Muhurr | Vajmdhej | 1 | 0 |
| Rreth -Kale | Muhurr | Rreth -Kale | 2 | 2 |
| Hurdhë Muhurr | Muhurr | Hurdhë Muhurr | 4 | 0 |
| Bulaç | Muhurr | Hurdhë Muhurr | 1 | 0 |
| Shqath | Muhurr | Hurdhë Muhurr | 1 | 1 |
| Sharakan | Muhurr | Hurdhë Muhurr | 1 | 1 |
| Fushë Alie | Fushë Alie | Fushë Alie | 11 | 5 |
| Laçes | Fushë Alie | Laçes | 2 | 2 |
| Rrethes | Fushë Alie | Rrethes | 3 | 0 |
| Blliçe | Fushë Alie | Blliçe | 13 | 8 |
| Rrenx | Fushë Alie | Rrenx | 0 | 0 |
| Selishtë | Selishtë | Selishtë | 9 | 4 |
| Tahir Losha | Selishtë | Lunarë | 9 | 5 |
| Lukan | Selishtë | Lukan | 2 | 2 |
| Kacni | Selishtë | Kacni | 2 | 2 |
| Qafë Murrë | Selishtë | Qafë Murrë | 10 | 4 |
| Katund I Vjetër | Selishtë | Katund I Vjetër | 1 | 1 |
| Arras | Arras | Arras | 9 | 3 |
| Zall Leshe | Arras | Zall Leshe | 1 | 0 |
| Sinë | Arras | Sinë | 7 | 2 |
| Sinë e Eperme | Arras | Sinë | 2 | 0 |

| | | | | |
|----------------|--------------|----------------|----|---|
| Sine e Poshtme | Arras | Sinë | 1 | 1 |
| Grykë Nokë | Arras | Grykë Nokë | 0 | 0 |
| Pashnjar | Arras | Pashnjar | 1 | 1 |
| Karriq | Arras | Karriq | 1 | 0 |
| Cidhen | Arras | Cidhen | 2 | 2 |
| Mustafe | Arras | Mustafe | 10 | 2 |
| Guri I Zi | Arras | Guri I Zi | 1 | 0 |
| Zall Dardhë | Zall Dardhë | Zall Dardhë | 13 | 1 |
| Lashkizë | Zall Dardhë | Lashkizë | 1 | 1 |
| Tartaj | Zall Dardhë | Tartaj | 1 | 1 |
| Zall Reç | Reç | Zall Reç | 5 | 1 |
| Draj Reç | Reç | Draj Reç | 2 | 1 |
| Gjurr Reç | Reç | Gjurr Reç | 2 | 2 |
| Kraj Reç | Reç | Kraj Reç | 2 | 0 |
| Hurdh Reç | Reç | Hurdh Reç | 2 | 0 |
| Arat E Poshtme | Reç | Arat E Poshtme | 1 | 0 |
| Lurë | Lurë | Lurë | 8 | 4 |
| Borie Lure | Lurë | Borie Lure | 1 | 1 |
| Gure Lure | Lurë | Gure Lure | 2 | 0 |
| Krej Lure | Lurë | Krej Lure | 2 | 2 |
| Pregj Lure | Lurë | Pregj Lure | 2 | 2 |
| Arren Nolle | Lurë | Arren Nolle | 2 | 1 |
| Vlashe | Lurë | Vlashe | 1 | 0 |
| Sumej | Lurë | Sumej | 1 | 1 |
| Sllovë | Sllovë | Sllovë | 13 | 7 |
| Kallë | Sllovë | Kallë | 2 | 2 |
| Sllatinë | Sllovë | Sllatinë | 1 | 0 |
| Palama | Sllovë | Palama | 2 | 2 |
| Zall Kalis | Sllovë | Zall Kalis | 1 | 1 |
| Shumbat | Sllovë | Shumbat | 11 | 5 |
| Fushë Shumbat | Sllovë | Fushë Shumbat | 2 | 1 |
| Ploshtan | Kala E Dodës | Ploshtan | 7 | 3 |
| Vasie | Kala E Dodës | Vasie | 1 | 1 |
| Shulla | Kala E Dodës | Shulla | 1 | 0 |
| Radomirë | Kala E Dodës | Radomirë | 12 | 7 |
| Tejes | Kala E Dodës | Tejes | 0 | 0 |
| Ceren | Kala E Dodës | Ceren | 0 | 0 |
| Amerikane | Peshkopi | Peshkopi | 12 | 9 |

Regjistrimet per vitin shkollor 2016-2017, Arsimi i mesem

| | Shkolla | Qarku | Emri i Njesise Lokale | Nga klasa X-XIII |
|-----------|----------------|--------------|------------------------------|-------------------------|
| | | | | Gjithsej |
| 1 | Said Najdeni | Dibër | Peshkopi | 1152 |
| 2 | Said Najdeni | Dibër | Peshkopi | 170 |
| 3 | Nazmi Rushiti | Dibër | Peshkopi | 365 |
| 4 | Maqellarë | Dibër | Maqellarë | 403 |
| 5 | Kastriot | Dibër | Kastriot | 253 |
| 6 | Muhurr | Dibër | Muhurr | 94 |
| 7 | Silovë | Dibër | Silovë | 74 |
| 8 | Arras | Dibër | Arras | 78 |
| 9 | Zall Dardhë | Dibër | Zall Dardhë | 53 |
| 10 | Lurë | Dibër | Lurë | 50 |

Lista e shkurtimeve

| | |
|--------|--|
| PVMIMN | Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta |
| OJF | Organizata JoFitimprurëse |
| REC | Qendra Rajonale e Mjedisit |
| PNEK | Plani i Ndërgjegjësimit, Edukimit dhe Komunikimit |

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Kala e Dodës

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Njësia administrative e Kalasë së Dodës përfshihet në Bashkinë Dibër. Ajo shtrihet në pjesën veriore të kësaj Bashkie dhe ka një sipërfaqe rreth 77 km². **Terreni është kryesisht malor**, ku vetë kjo njësi shtrihet rrëzë malit më të lartë në Shqipëri, Korabit 2,751 m. Për shkak dhe të pozitës së saj gjeografike, klima në këtë njësi është kontinentale malore, me dimër të gjatë dhe të ashpër, me reshje dëbore përgjatë gjysmës së vitit dhe me verë të freskët e të thatë.

Temperaturat shkojnë më e ulta -17°C në dimër dhe më e larta në verë deri në 25°C. Reshjet e dëbores arrijnë deri 2 m **duke e bllokuar shpesh zonën**.

Karakter i malor i zonës, pjesa infrastrukturës dhe vetë pozita gjeografike e bëjnë këtë njësi të arrihet me vështirësi. **Largësia nga qendra e Bashkisë (njësia Peshkopi) është rreth 35 km**. Për këtë arsye edhe zhvillimi në këtë zonë ka ecur me ritme shumë të ngadalta.

Përsa i përket bizneseve, kjo njësi ka një numër tejet të kufizuar, vetëm **pesë biznese** të rregjistruara. Dhe ndër këto biznese dy janë bujqësore, dy transporti dhe një tregti.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara – fshatrat) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.




Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Kala e Dodës



Foto 2: Rruga kombëtare Peshkopi – Kukës pranë njësië Kala e Dodës

POPULLSIA

Njësia Kala e Dodës ka në përbërje 8 fshatrat me një numër të vogël banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njësisë) Vasie 293; Shullan 252; Ploshtan 640; Ceren 478; Kullas 232; Ujmirë 324; Tejes 354; dhe Radomirë 546.


Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|--------|-----------|-----------|------------|---------|-------|
| Kala e | Census | 2252 | ~500 | 1171 | 1081 |
| Dodës | Gj.C 2014 | 3025 | 837 | 1588 | 1437 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Kalasë së Dodës për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me 50% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Kalasë së Dodës, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031, me mbi 40%.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Kalaja e Dodës shfaq një tendencë për uljen e popullsisë (-43,7%) njëlloj si vendet e izoluara dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë dhe Lurë.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsie ndikon drejtpërdrejt në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populssia aktuale do të konsiderohet stabil për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë që mund të kenë akses të drejtpërdrejt në sistemin e shërbimit. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,2 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përlllogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 0.28 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 4 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përlllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Kala e Dodës

| Kala e Dodës | Popullsia | Norma gjenerimit (kg/b/ditë) | Vol. Kontenierit Kg | Nr. Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (ton) |
|--------------|-------------|------------------------------|---------------------|------------------|-----------------------|
| Vasie | 293 | 0.2 | 60 | 1 | 0.06 |
| Ploshtan | 640 | 0.2 | 60 | 2 | 0.13 |
| Ceren | 478 | 0.2 | 60 | 1 | 0.09 |
| Total | 1411 | | | 4 | 0.28 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.11 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 0.77 ton ose 3 ton në muaj.

Terreni i egër malor e bën më të vështirë shërbimin e mbetjeve në këtë zonë, ku kamionit të grumbullimit të mbetjeve i duhet të kalojë nga Sllova (një pjesë terreni fushore) në fshatrat e Kalasë së Dodës, me një relief tejet malor. Rruga nga Sllova në Ceren, nëpër të cilën duhet të kalojë kamioni e kalon lartësinë 900 metra mbi nivelin e detit.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Kalasë së Dodës, do të përfshinte edhe fshatra si Radomira, e cila është 1,200 m mbi nivelin e detit. Kjo do të rriste më shumë koston e shërbimit.

Përsa i përket rrugëve të brendshme në këtë njësi nuk janë të asfaltuara, përveç rrugës kryesore e cila arrin deri në Vasie.

Fshatrat si Plotshani apo Vasie janë fshatra të cilët nëpërmjet rrugëve janë të aksesueshëm, por koha e shërbimit dhe kilometrat e përshkruar deri atje janë tepër të mëdha.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Njësia Administrative Kala e Dodës do të konsiderohet si njësi pilote për menaxhimin alternative të mbetjeve në zonat e izoluar dhe për këtë një sistem me dy forma shërbimi do të zbatohet dhe kordinohet si pjesë e shërbimit tërësor të Bashkisë. Ky system konsiston në:

1. Shërbimin e brendshëm të grumbullimit

Ky shërbim do të kryhet me një punëtor të punësuar nga Bashkia me orë pune dhe me një mjet të tijin do të grumbullojë mbetjet nga banorët e fshatrave të palidhura me rrugë të asfaltuar si p.sh. Radomira, të cilëve do t'u shpërndahen qese të zeza për të mbajtur mbetjet e thata në shtëpi dhe dorëzuar tek grumbulluesi sipas grafikut të rënë dakort.

2. Tërheqje me makinë teknologjike

Ky sistem do të konsistojë në vendosjen e kazanëve 1.1m³ pranë sheshit të ish-komunës, shkollat gjatë rrugës dhe zonën e restoranteve dhe shërbimit në Vasie. Banorët e fshatrave që kanë akses në rrugë të asfaltuar, të përmendura më lart, do të përdorin këtë sistem në mënyrë direkte për të hedhur mbetjet e tyre të thata. Në ditën që mbërrin kamioni (e cila do të jetë ose një herë në muaj ose një herë në dy javë sipas dakortësisë me Administratorin e njësisë) do të sillen në Ceren dhe thasët që grumbullohen në fshatrat pa akses, të cilët marrin shërbimin e përmendur në pikën 1.

| Afati | Afat shkurtër i mundshëm (1 - 3 vite) | Afat mesëm i mundshëm (1 - 5 vite) | Afat gjatë shumë ambicioz (>5 vite) |
|-----------|---|---|--|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në fshatin Ceren dhe Vasie (3 - 4 kazanë). | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në fshatin Ceren (3 - 4 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të Bashkisë |

| | | njësinë me mjete alternative | |
|--|--|---|---|
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë përgjatë një kohështrirje dy javë ose një muaj në varësi të stinës mbetjet në pikën e grumbullimit në Ceren | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosja e kazanëve në Ceren; 2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati; 3. Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata; 4. Tërheqja e mbetjeve të thata me makinë teknologjike si pjesë e nënzonës 3 të shërbimit (1 herë në muaj); 5. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administrator mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj; 2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin; 3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kazan; 4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | <ol style="list-style-type: none"> 1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse; 2. Vendosja e kazanëve në çdo qendër fshati (8); 3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin; 4. Rillogaritet fatura për kostot shtesë |
| Kostot e lidhura | Investime kapitale (4 kazënë + qese viti parë) + shpenzime operacionale + amortizim = 286.000 viti i parë dhe 140.000 çdo vit. a. Kosto për familje në vit = 180 lek | Investime kapitale (4 kazënë) + shpenzime operacionale + brendshme + amortizim = 286.000 viti i parë dhe 140.000 çdo vit + 120.000 punonjës shtesë çdo vit. | Investime kapitale (8 kazënë) + shpenzime operacionale + amortizim = 440.000 viti i parë dhe 200.000 çdo vit Amortizimi i mjetit është shumë i madh dhe kostot lidhur me |

b. Kosto për ton (36 ton e thatë) në vit = 3.800 lek

a. Kosto për familje në vit = 180 lek

b. Kosto për ton (36 ton e thatë) në vit = 3.800 lek

të paparashikuara në analizë.

a. Kosto për familje në vit = 250 lek

b. Kosto për ton (36 ton e thatë) në vit = 5.500 lek




Foto 3: Fshati Ceren (Qendra e njësisë), vendi ku propozohet vendosja e kazanëve

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Kalasë së Dodës me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në Ceren, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.

Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.



| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|---|---|------------|-----------------|----------------|
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Vasia | Ceren | 13 | 4.8 |
| | Shullan (Beshej) | Ceren | 12 | 4.2 |
| | Ploshtan | Ceren | 9 | 2.7 |
| | Ploshtan (Dodaj) | Ceren | 10 | 2.9 |
| | Ceren (Sufaj) | Ceren | 8 | 1.8 |
| | Shullan | Ceren | 12 | 4.1 |
| | Radomira (qendër) | Ceren | 12 | 3.9 |
| | Radomira (Derbac) | Ceren | 9 | 2.5 |
| | Radomira | Ceren | 11 | 3.6 |
| | Radomira (Stordok) | Ceren | 13 | 4.6 |
| Total | | | ~ 2 orë | 35.1 km |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshtrave me një makinë | | 2:15 orë | 42,5 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit

Administratori i njësisë + 8 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Arras

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M

Njësia administrative e Arrasit ndodhet në pjesën veriperëndimore të Bashkisë së Dibrës. Ajo ka një sipërfaqe rreth 70 km² dhe përbëhet nga 9 fshatra me një popullsi rreth 3775 banorë. Arrasi shtrihet në pjesën perëndimore të lumit Drin i Zi nga kuota 380 m mbi nivelin e detit deri në kuotën 1800 m, në malet e Pllajës dhe të Rujës.

Pozicioni gjeostrategjik, klima e përshtatshme, toka pjellore, ekzistenca e ujërave natyrore dhe gjelbërimi natyral ka bërë që historikisht kjo zonë ta bazojë ekonominë e saj në produktet bujqësore dhe blegtorale. Larmia e mikroklimave dhe pozicionimit të tokave në lartësi dhe në shtrirje ka lejuar dhe lejon kultivimin e gati të gjitha llojeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Përsa i përket bizneseve, kjo njësi numëron rreth 16 biznese, ku mund të përmenden: 1 Bujqësi, 2 Restorant&Hoteleri, 2 Minierë, 1 Shërbim, 6 Transport dhe 4 Tregti.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara – fshatrat) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.




Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Arras



Foto 2: Pamje nga njësia Arras

POPULLSIA

Njësia Arras ka në përbërje 9 fshatra me një numër të kufizuar banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njesisë) Arras 497, Sinë e Epërme 614, Sinë e Poshtme 349, Çidhën 710, Grykë – Noke 510, Lazrej 410, Mustafe 215, Gur i Zi 195 dhe Kodër leshe 310.


Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|--------|-----------|-----------|------------|---------|-------|
| Arras | Census | 3055 | ~600 | 1576 | 1479 |
| | Gj.C 2014 | 3775 | 1145 | 1924 | 1851 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Arrasit për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me rreth 40% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Arrasit, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Arrasi shfaq një tendencë për uljen e popullsisë **(-40.90%)** një shifër pak më e mirë krahasuar me vendet e izoluar dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë dhe Kala e Dodës.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabil për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Arrasit. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,3 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përllogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 1.14 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 19 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Arras

| Fshatrat | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol.Kontenieri t (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerim i Ditor (Ton) |
|----------------|--------------|-----------------------------------|-----------------------|-----------------|------------------------|
| Arras | 497 | 0.3 | 60 | 2 | 0.15 |
| Sinë e Epërme | 614 | 0.3 | 60 | 3 | 0.18 |
| Sinë e Poshtme | 349 | 0.3 | 60 | 2 | 0.10 |
| Çidhën | 710 | 0.3 | 60 | 4 | 0.21 |
| Grykë - Noke | 510 | 0.3 | 60 | 3 | 0.15 |

| | | | | | |
|-------------|-----|-----|--------------|-----------|-------------|
| Lazrej | 410 | 0.3 | 60 | 2 | 0.12 |
| Mustafe | 215 | 0.3 | 60 | 1 | 0.06 |
| Gur i Zi | 195 | 0.3 | 60 | 1 | 0.06 |
| Kodër leshe | 310 | 0.3 | 60 | 2 | 0.09 |
| | | | Total | 19 | 1.14 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.46 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 3.22 ton ose 12.9 ton në muaj.

Terreni i egër malor në zonat periferike të njësisë e bën të vështirë shërbimin e mbetjeve në këtë zonë. Por ajo e cila kufizon shërbimin e mbetjeve në këtë njësi është infrastruktura e dobër rrugore. Megjithatë do të propozohet që mbetjet e gjeneruara në këtë zonë nëpërmjet një karroce të transportohen një herë në muaj në pikën e grumbullimit që do të jetë e para në fshatin Arras (pika më e afërt e aksesueshme nqs do të asfaltohen rrugët lidhëse me njësinë) dhe që andej të transportohen në venddepozitim.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Arrasit, do të ishte i pamundur ky shërbim, për shkak të infrastrukturës shumë të keqe të rrugëve, pothuajse të paasfaltuara. Ky plan mund të jetë për një periudhë më të vonshme, kur disa prej nyjeve lidhëse kryesore me njësinë do të asfaltohen.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Më tepër sesa largësia nga qyteti i Peshkopisë apo terreni i egër malor në periferi të njësisë, është infrastruktura e dobët rrugore, ajo që e bën Arrasin një zonë vështirë të aksesueshme, duke përfshirë shumicën e fshatrave përbërës të kësaj njësie. Për këtë arsye propozohet vendosja e një konteneri 5 ton në fshatin Arras. Ky kontener do të shërbejë shërbejë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këtë depo për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësisë do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatra do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetar ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më të largët, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Arrasi mund të bëhet pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenerëve në qendër të fshatrave. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine mbetjet e thata të grumbulluara në këto kontenerë do të transportohen drejt venddepozitimit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|------------------|---|---|--|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me rrotacion brenda muajit me kontener 5 ton në qendër të njësisë administrative, fshati Arras Qendër. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në shkollën e vjetër Arras (4 - 5 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të Bashkisë |


| | | | |
|--|---|--|---|
| Organizimi | Të gjithë banorët (me një sistem të brendshëm grumbullimi) dërgojnë në këtë kontenier mbetjet e thata të grumbulluara. Sipas nevojës administratori i njësisë me anë të një kamioni dërgon mbetjet në venddepozitim. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <ol style="list-style-type: none"> Vendosja e një kontenieri në fshatin Arras. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata Tërheqja e mbetjeve të thata me zetar dhe dërgimi në kontenierin 5 ton Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administratori mund të bëjë kërkesë shitesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve. | <ol style="list-style-type: none"> Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kazan Futet sistemi i tarifës së reduktuar | <ol style="list-style-type: none"> Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (9) Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron për grumbullimin Rillogaritet fatura për kostot shitesë |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> | | |



Foto 3: Shkolla e Vjetër, Arras (pika e grumbullimit), vendi ku do propozohet vendosja e kazanëve

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Arrasit me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në fshatin Arras Qendër dhe nga aty drejt venddepozitimit, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.



Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.

| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|---|---|------------|-----------------|----------------|
| | Sinë e Epërme | | 27 | 11.7 |
| | Sinë e Poshtme | | 21 | 8.7 |
| | Çidhën | | 16 | 6.2 |
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Grykë - Noke | Arras | 19 | 7.7 |
| | Lazrej | Qendër | 21 | 8.5 |
| | Mustafe | | 28 | 11.8 |
| | Gur i Zi | | 27 | 11.4 |
| | Kodër leshe | | 10 | 2.9 |
| | Total | | | 2:49 |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshatrave me një makinë deri tek shkolla e vjetër, Arras | | 3:32 orë | 74.1 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit Administratori i njësisë + 9 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Kastriot

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M

Njësia administrative e Kastriotit ka një sipërfaqe rreth 57 km² dhe përbëhet nga 15 fshatra me një popullsi rreth 7348 banorë.

Përsa i përket bizneseve, kjo njësi renditet si një nga njësitë më të zhvilluara dhe me më shumë biznese të rregjistruara, me një total prej 34 biznesesh. Ku mund të përmenden: 3 Bujqësi, 2 Restorant & Hoteleri, 2 Industri & Përpunim, 19 Transport dhe 8 Tregti.



Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Kastriot




Foto 2: Rrugë të paasfaltuara, Kastriot

POPULLSIA


Njësia Kastriot ka në përbërje 15 fshatra me një numër të konsiderueshëm banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njesisë) Limjan 600, Vranjt 520, Sohodoll i Madh 1225, Sohodoll i Vogël 508, Deshat 208, Borovjan 308, Kander 874, Kishavec 901, Vakuf 649, Brest i Epërm 457, Brest i Poshtëm 542, Kastriot 280, Fushë – Kastriot 105, Kukaj 250 dhe Përgjegje 100.

Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|----------|-----------|-----------|------------|---------|-------|
| Kastriot | Census | 6200 | ~1200 | 3295 | 2905 |
| | Gj.C 2014 | 7348 | 2046 | 3817 | 3531 |

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Kastriotit për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me rreth 27% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm).

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Kastrioti shfaq një tendencë jo shumë të lartë për uljen e popullsisë (-27.20%) një shifër shumë më e mirë krahasuar me vendet e izoluara dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë dhe Kala e Dodës.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabil për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Kastriotit. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,4 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përllogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 3.01 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 50 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Kastriot

| Fshatrat | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol.Kontenierit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (Ton) |
|------------------|--------------|-----------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------------|
| Limjan | 600 | 0.4 | 60 | 4 | 0.24 |
| Vranjt | 520 | 0.4 | 60 | 3 | 0.21 |
| Sohodoll i Madh | 1225 | 0.4 | 60 | 8 | 0.49 |
| Sohodoll i Vogël | 508 | 0.4 | 60 | 3 | 0.20 |

| | | | | | |
|-----------------|-----|-----|--------------|-----------|-------------|
| Deshat | 208 | 0.4 | 60 | 1 | 0.08 |
| Borovjan | 308 | 0.4 | 60 | 2 | 0.12 |
| Kander | 874 | 0.4 | 60 | 6 | 0.35 |
| Kishavec | 901 | 0.4 | 60 | 6 | 0.36 |
| Vakuf | 649 | 0.4 | 60 | 4 | 0.26 |
| Brest i Epërm | 457 | 0.4 | 60 | 3 | 0.18 |
| Brest i Poshtëm | 542 | 0.4 | 60 | 4 | 0.22 |
| Kastriot | 280 | 0.4 | 60 | 2 | 0.11 |
| Fushë-Kastriot | 105 | 0.4 | 60 | 1 | 0.04 |
| Kukaj | 250 | 0.4 | 60 | 2 | 0.10 |
| Përgjegje | 100 | 0.4 | 60 | 1 | 0.04 |
| | | | Total | 50 | 3.01 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 1.2 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 8.4 ton ose 33.6 ton në muaj.

Faktori kryesor që kufizon shërbimin e mbetjeve në këtë njësi është infrastruktura e dobët rrugore. Megjithatë do të propozohet që mbetjet e gjeneruara në këtë zonë nëpërmjet një karroce apo zetori të transportohen një herë në muaj në pikën e grumbullimit që do të jetë në fshatin Kastriot (pika më e afërt e aksesueshme) dhe që andej të transportohen në venddepozitim.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihej në të gjithë njësinë e Kastriotit, do të ishte thuajse i pamundur ky shërbim, për shkak të infrastrukturës shumë të keqe të rrugëve, pothuajse të paasfaltuara. Ky plan mund të jetë për një periudhë më të vonshme, kur disa prej nyjeve lidhëse kryesore me njësinë do të asfaltohen.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Më tepër sesa largësia nga qyteti i Peshkopisë apo terreni i vështirë, është infrastruktura e dobët rrugore, ajo që e bën Kastriotin një zonë vështirë të aksesueshme, duke përfshirë shumicën e fshatrave përbërës të kësaj njësie. Fshatrat e vetëm të aksesueshëm në këtë fazë janë Kastrioti, Kandri dhe Vakufi.

Për këtë arsye propozohet vendosja e një konteneri 5 ton në fshatin Kastriot. Ky kontener do të shërbejë shërbejë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këtë depo për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësisë do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatrat jo të aksesueshëm do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetor ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më të largët, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Kastrioti mund të bëhet i gjithi pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenerëve në qendër të fshatrave. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine, zetori apo karroce dore, mbetjet e thata të grumbulluara në kontenerë do të transportohen drejt venddepozimitit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|--|--|--|--|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me rrotacion brenda muajit me kontenier 5 ton në qendër të njësisë administrative në fshatin Kastriot | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në fshatin Kastriot (4 - 5 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të Bashkisë |
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë në këtë kontenier nëpërmjet zëtorit mbetjet e thata të grumbulluara. Sipas nevojës administratori i njësisë me anë të një kamioni dërgon mbetjet në venddepozitim. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | 1. Vendosja e një kontenieri në fshatin Kastriot. 2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati 3. Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata 4. Tërheqja e mbetjeve të thata me zëtor dhe dërgimi në kontenierin 5 ton 5. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administratori mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për | 1. Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj 2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin 3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kazan 4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | 1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse 2. Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (14) 3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron për grumbullimin 4. Rillogaritjet fatura për kostot shtesë |

tërheqjen e
mbetjeve.

**Kostot e
lidhura** *Për t'u llogaritur
gjatë miratimit të
skemës*





Foto 3: Fshati Kastriot (pika e grumbullimit), vendi ku do propozohet vendosja e kontenierit

**Distanca dhe
kohët e
shërbimit**

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Kastriotit me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në fshatin Kastriot dhe nga aty drejt venddepozitimit, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.



Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.

| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|--|--|------------|-----------------|----------------|
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Limjan | Kastriot | 23 | 9.6 |
| | Vranjt | | 23 | 9.3 |
| | Sohodoll i Madh | | 14 | 4.9 |
| | Sohodoll i Vogël | | 12 | 4.2 |
| | Deshat | | 15 | 5.7 |
| | Borovjan | | 14 | 4.8 |
| | Kander | | 10 | 3.1 |
| | Kishavec | | 13 | 4.9 |
| | Vakuf | | 15 | 5.5 |
| | Brest i Epërm | | 7 | 1.6 |
| | Brest i Poshtëm | | 7 | 1.9 |
| | Fushë-Kastriot | | 8 | 2.5 |
| | Kukaj | | 8 | 2.7 |
| | Përgjegje | | 10 | 3.7 |
| Total | | | ~ 3 orë | 64.4 km |
| Rrugëtimi total | Duke përfshirë të gjithë fshatrat në një rrugëtim | | 2:50 orë | 49.2 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit Administratori i njësisë + 15 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Lurë

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M

Njësia administrative e Lurës përfshihet në Bashkinë Dibër. Ajo shtrihet në pjesën veri perëndimore të kësaj Bashkie dhe ka një sipërfaqe rreth 136 km². Terreni është kryesisht malor, me një dimër të ashpër dhe të ftohtë dhe një verë të freskët.

Kjo njësi njihet për Parkun Kombëtar të Lurës që shtrihet përrreth malit Kurona e Lurës (2121 m). Bukuri e kësaj zone janë dhe liqenet e saj. Gjithsej në këtë zone ndodhen 12 Liqene akullnajore që në gjithë Shqipërinë njihen si, Liqenet e Lurës. Ndër to përmendim Liqenin e Madh, Liqenin e Zi, Liqenin e Lopëve, Liqenin e Luleve etj.

Karakterit malor i zonës, pjesa infrastrukturës dhe vetë pozita gjeografike e bëjnë këtë njësi të arrihet me vështirësi. Vargjet e Lurës përbehen prej dy vargësh paralele midis tyre, që në pjesën veriore kthehen drejt verilindjes. Lartësitë më të mëdha arrihen në pjesën qendrore me malin e Dejës 2,246 m dhe Kurorën e Lurës 2,121 m. Nga kjo lartësi ato ulen në drejtim të veriut dhe jugut nën 2,000 m. **Largësia nga qendra e Bashkisë (njësia Peshkopi) është rreth 47 km.** Për këtë arsye edhe zhvillimi në këtë zonë ka ecur me ritme shumë të ngadalta.

Përsa i përket bizneseve, kjo njësi ka një numër të kufizuar, vetëm **katër biznese** të rregjistruara. Dhe ndër këto biznese dy miniera, një bujqësi dhe një transporti.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara – fshatrat) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.




Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Lurë



Foto 2: Rrugë të paasfaltuara. Lurë

POPULLSIA

Njësia Lurë ka në përbërje 10 fshatra me një numër të kufizuar banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njesisë) Gurë Lurë 144; Arth 43; Borie Lurë 215; Fushë Lurë 367; Lurë e Vjetër 181; Krej Lurë 110; Pregj Lurë 103; Arrmolle 131; Sumej 57 dhe Vlashej 47.


Në tabelën e mëposhtëme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|--------|-------------|-----------|------------|---------|-------|
| Lurë | Census 2011 | 1096 | ~220 | 557 | 539 |
| | Gj.C 2014 | 1463 | 493 | 725 | 738 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Lurës për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me rreth 50% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Lurës, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031, me mbi 45%.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Lura shfaq një tendencë për uljen e popullsisë **(-46.40%)** njëlloj si vendet e izoluara dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë dhe Kala e Dodës.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabil për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Lurës. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,2 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përllogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 0.28 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 5 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Lurë

| Lurë | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol. Kontenierit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (Ton) |
|---------------|--------------|-----------------------------------|-----------------------|-----------------|-----------------------|
| Gurë- lurë | 144 | 0.2 | 60 | 0 | 0.03 |
| Arth | 43 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| Borie Lurë | 215 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| Fushë Lurë | 367 | 0.2 | 60 | 1 | 0.07 |
| Lurë e vjetër | 181 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| Krej Lurë | 110 | 0.2 | 60 | 0 | 0.02 |

| | | | | | |
|------------|-----|-----|--------------|----------|-------------|
| Pregj Lurë | 103 | 0.2 | 60 | 0 | 0.02 |
| Arrmolle | 131 | 0.2 | 60 | 0 | 0.03 |
| Sumej | 57 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| Vlashej | 47 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| | | | Total | 5 | 0.28 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.11 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 0.77 ton ose 3 ton në muaj.

Terreni i egër malor e bën më të vështirë shërbimin e mbetjeve në këtë zonë. Megjithatë do të propozohet që mbetjet e gjeneruara në këtë zonë nëpërmjet një karroce të transportohen një herë në muaj në pikën e grumbullimit që do të jetë e para në Fushë Lurë dhe që andej të transportohen në afërsi të urës lidhëse midis njësive Arras dhe Fushë Çidhën.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Lurës, do të ishte thuajse i pamundur ky shërbim, për shkak të terrenit malor dhe infrastrukturës shumë të keqe të rrugëve, pothuajse të paasfaltuara.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Largësia nga qyteti i Peshkopisë, terreni i egër malor si dhe infrastruktura e dobët rrugore, e bëjnë Lurën një zonë vështirë të aksesueshme. Për këtë arsye propozohet vendosja e një depoje në qendër të njësive administrative Lurë. Kjo depo do të shërbejë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këtë depo për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësive do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatra do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetar ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më të largët, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Lura mund të bëhet pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenierëve në qendër të fshatrave. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine mbetjet e thata të grumbulluara në këto kontenierë do të transportohen drejt venddepozitimit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|------------------|--|---|--|
| Objektivi | Vendosja e një depoje grumbullimi për mbetjet e thata në qendër të njësive administrative Lurë. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në shkollën e vjetër Arras (4 - 5 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të bashkisë |

| | | | |
|--|--|--|--|
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë në këtë depo nëpërmjet zëtorit mbetjet e thata të grumbulluara. Sipas nevojës administratori i njësisë me anë të një kamioni dërgon mbetjet në venddepozitim. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | 1. Ngritja e një depoje në qendër të njësisë administrative Lurë. 2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati 3. Tërheqja e mbetjeve të thata me zëtor dhe dërgimi në depo 4. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administratori mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve. | 1. Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj 2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin 3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kazan 4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | 1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse 2. Futja e skemë derë më derë dhe sistemit të grumbullimit me mjet bashkiak sipas një skeme të miratuar në nivel njësie. 3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron për grumbullimin 4. Rillogaritjet fatura për kostot shtesë |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> | | |





Foto 3: Qendra e njësisë – Fshati Fushë Lurë, ku mund të caktohet depoja.

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Lurës me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në Fushë Lurë dhe nga aty drejt urës lidhëse Arras – Fushë Çidhën, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.



Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.

| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|--|------------------|------------|------------|---------------|
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Gurë Lurë | Fushë Lurë | 34 | 9.5 |
| | Gurë Lurë (Hoti) | | 21 | 5.4 |
| | Borie Lura | | 12 | 2.7 |
| | Kumbulla | | 36 | 12.5 |
| | Merkurthi | | 32 | 11.3 |

| | | | |
|---|---|-----------------|-----------------|
| | Krej Lura) | 20 | 6.7 |
| | Pregj Lura | 38 | 11.9 |
| | Vlashaj | 36 | 11.8 |
| | Arre Molla | 41 | 14.6 |
| | Arre Molla (Sumaj) | 46 | 15 |
| | Total | ~ 5 orë | 101.4 km |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshatrave me një makinë deri tek shkolla e vjetër, Arras | 1:10 orë | 8.5 km |
| Grupi i punës për zbatimin e shërbimit | Administratori i njësisë + 11 kryetarët e fshatrave | | |

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Luzni

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M Njësia administrative e Luznisë përfshihet në Bashkinë Dibër. Luznia shtrihet në jug-perëndim të qytetit të Peshkopisë dhe ka një sipërfaqe rreth 45 km², me një terren kodrinor – malor.

Luznia ka një shtrirje diverse. Ajo shtrihet nga lugina e lumit Drin i Zi me 386 m mbi nivelin e detit deri në lartësinë e malit të Pratit në nivelin 2,000 m mbi nivelin e detit. Ky reliev i thyer ndikon dhe në ekonominë dhe jetesën e banorëve të kësaj komune. Kështu fshatrat që janë në malësi merren kryesisht me pyjet dhe blegtori, ndërsa banorët rreth Drinit me bujqësi, pemëtari dhe perime. Klima është mesdhetare kontinentale, ku dallohet qartë 4 stinët, me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë e të lagësht, kryesisht në dimër me reshje dëbore.

Largësia nga qendra e Bashkisë (njësia Peshkopi) është rreth 9 km.

Kjo njësi është një ndër më të varftrat përsa i përket numrit të bizneseve, me vetëm 3 biznese të rregjistruara: vetëm transport.

Ekonomia lokale kryesisht mbështet në bujqësinë, blegtorinë dhe në menaxhimin e burimeve natyrore, të cilat duhet thënë që shfrytëzohen pak.




Foto 1: Pamje e relievit të njësive Luzni



Foto 2: Drini në afërsi të fshatit Hotesh, Njësia Luzni

POPULLSIA

Njësia Luzni ka në përbërje 6 fshatra me një numër të kufizuar banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njësisë) Katund i Ri 1079, Hotesh 635, Lishan i Poshtëm 420, Lishan i Epërm 469, Arap i Epërm 355 dhe Arap i Poshtëm 339.


Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|--------|-------------|-----------|------------|---------|-------|
| Luzni | Census 2011 | 2433 | ~487 | 1225 | 539 |
| | Gj.C 2014 | 3171 | 935 | 1618 | 1208 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Luznisë për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me më pak se 50% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Luznisë, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031, me mbi 40%.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Luznia shfaq një tendencë për uljen e popullsisë (-36%) shifër kjo pak më e mirë se ajo e vendeve të izoluar dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë, Kala e Dodës dhe Lurë.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejt në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabil për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Luznisë. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,3 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përlogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 1 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 16 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përlogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Luzni

| Luzni | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol.Kontenierit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (Ton) |
|------------------|--------------|-----------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------------|
| Hotesh | 635 | 0.3 | 60 | 3 | 0.19 |
| Katund i Ri | 1079 | 0.3 | 60 | 5 | 0.32 |
| Lishan i Poshtëm | 420 | 0.3 | 60 | 2 | 0.13 |
| Lishan i Epërm | 469 | 0.3 | 60 | 2 | 0.14 |

| | | | | | |
|----------------|-----|-----|-----------|------------|------|
| Arap i Epërm | 355 | 0.3 | 60 | 2 | 0.11 |
| Arap i Poshtëm | 339 | 0.3 | 60 | 2 | 0.10 |
| Total | | | 16 | 1.0 | |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.4 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 2.8 ton ose 11.2 ton në muaj.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Luznisë, do të ishte thuajse i pamundur ky shërbim, për shkak të infrastrukturës tejte të dobët, gjë e cila do të rriste më shumë koston e shërbimit në zonë.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Terreni jo i favorshëm si dhe infrastruktura e dobët rrugore, e bëjnë Luzninë një zonë e cila nuk mund të përfshihet në skemën e planit afatshkurtër, si pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Për këtë arsye propozohet vendosja e kontenierëve 5 ton në qendër të njësisë administrative Luzni. Këta kontenierë do të shërbejnë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këta kontenierë për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësisë do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatra do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetar ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më afatgjatë, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Luznia mund të bëhet pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenierëve në qendër të fshatrave. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine mbetjet e thata të grumbulluara në këto kontenierë do të transportohen drejt venddepozitimit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|-------------------|--|---|---|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me rrotacion brenda muajit me kontenier 5 ton në qendër të njësisë administrative Luzni. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në fshatin Katund i Ri (4 - 5 kontenierë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të bashkisë me vendosjen e kontenierëve në qendër të çdo fshati |
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë përgjatë një kohështrirje dy javë ose një muaj në varësi të stinës mbetjet e thata në kontenier sipas ditës | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të |

| | së caktuar në bashkëpunim me administratorin. | mundësisë financiare | rrugëtimit të paraqitur në hartë |
|--|--|---|--|
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <p>1. Vendosja e kontenierëve 5 ton</p> <p>2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati</p> <p>3. Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata</p> <p>4. Grumbullimi i mbetjeve të thata në kontenierë dhe dërgimi i tyre në venddepozitim sipas nevojës.</p> <p>5. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administratori mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve.</p> | <p>1. Kontraktimi i një mjetei alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj</p> <p>2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin</p> <p>3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kontenier.</p> <p>4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar</p> | <p>1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse</p> <p>2. Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (10)</p> <p>3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin</p> <p>4. Rillogaritet fatura për kostot shtesë</p> |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> | | |




Foto 3: Fshati Katund i Ri (pika e grumbullimit)

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Luznisë me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në fshatin Katund i Ri dhe më pas drejt venddepozitimit, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.

Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.



| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|---|---|-------------------|-------------------|----------------------|
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Hotesh | Katund i Ri | 37 | 16.3 |
| | Lishan i Poshtëm | | 23 | 9.7 |
| | Lishan i Epërm | | 30 | 13 |
| | Arap i Epërm | | 22 | 9.1 |
| | Arap i Poshtëm | | 18 | 7.2 |
| Total | | | ~ 2:20 orë | 55.3 km |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshtrave me një makinë | | 1:31 orë | 29.3 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit Administratori i njësisë + 6 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Muhurr

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M

Njësia Administrative e Muhurrit shtrihet në dy anët e lumit Drin, kryqëzim me njësitë Selishtë, Luzni, Arras, Lurë, Zall Dardhë e Reç, me një distancë rreth 9 km nga qyteti i Peshkopisë me rrugë të asfaltuar, ka bërë që popullsia vendase të ndjehet e favorizuar dhe me një mërgim jo dhe kaq të lartë sa njësitë përreth.

Territori i saj shtrihet nga një lartësi 300 m mbi nivelin e detit deri në 2100 m, fushat pjellore dhe bollëku i ujit për vaditje e bën këtë zonë shumë produktive për të gjitha llojet e produkteve.

Përsa i përket bizneseve, kjo njësi numëron rreth 15 biznese, ku mund të përmenden: 1 Bujqësi, 1 Minierë, 2 Industri & Përpunim, 4 Përpunim, 1 Qera, 4 Transport dhe 2 Tregti.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara – fshatrat) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.



Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Muhurr



Foto 2: Rrugë të paasfaltuara. Muhurr

POPULLSIA

Njësia Muhurr ka në përbërje 7 fshatra me një numër jo shumë të madh banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njesisë) Muhurr 1014, Fushë-Muhurr 817, Rreth Kale 488, Vajmdhej 455, Bulaq 188, Shqath 256 dhe Hurdh Muhurr 227.


Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.

| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|--------|-------------|-----------|------------|---------|-------|
| Muhurr | Census 2011 | 2780 | ~550 | 1458 | 1322 |
| | Gj.C 2014 | 3466 | 1028 | 1814 | 1652 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Muhurrit për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me rreth 30% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Muhurrit, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Muhurri shfaq një tendencë për uljen e popullsisë **(-31.40%)** një shifër pak më e mirë krahasuar me vendet e izoluara dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Selishtë dhe Kala e Dodës.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabël për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Muhurrit. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,3 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përllogaritje rezulton që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 1.03 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 17 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Muhurr

| Muhurr | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol.Kontenierit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (Ton) |
|--------------|--------------|-----------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------------|
| Muhurr | 1014 | 0.3 | 60 | 5 | 0.30 |
| Fushë Muhurr | 817 | 0.3 | 60 | 4 | 0.25 |
| Rreth Kale | 488 | 0.3 | 60 | 2 | 0.15 |
| Vajmdhej | 455 | 0.3 | 60 | 2 | 0.14 |
| Bulaq | 188 | 0.3 | 60 | 1 | 0.06 |

| | | | | | |
|------------------------|-----|-----|--------------|-----------|-------------|
| Shqath | 256 | 0.3 | 60 | 1 | 0.08 |
| Hurdh Muhur | 227 | 0.3 | 60 | 1 | 0.07 |
| | | | Total | 17 | 1.03 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.41 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 2.87 ton ose 11.48 ton në muaj.

Terreni i egër malor në zonat periferike të njësisë e bën të vështirë shërbimin e mbetjeve në këtë zonë. Por ajo e cila kufizon shërbimin e mbetjeve në këtë njësi është infrastruktura e dobër rrugore. Megjithatë do të propozohet që mbetjet e gjeneruara në këtë zonë nëpërmjet një karroce të transportohen një herë në muaj në pikën e grumbullimit që do të jetë e para në Fushë Muhurr (pika më e afërt e aksesueshme nëq do të asfaltohen rrugët lidhëse me njësinë) dhe që andej të transportohen në venddepozitim.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Muhurrit, do të ishte thuajse i pamundur ky shërbim, për shkak të infrastrukturës shumë të keqe të rrugëve, pothuajse të paasfaltuara. Ky plan mund të jetë për një periudhë më të vonshme, kur disa prej nyjeve lidhëse kryesore me njësinë do të asfaltohen.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Më tepër sesa largësia nga qyteti i Peshkopisë apo terreni i egër malor në periferi të njësisë, është infrastruktura e dobët rrugore, ajo që e bën Muhurrit një zonë vështirë të aksesueshme, duke përfshirë shumicën e fshatrave përbërës të kësaj njësie. Për këtë arsye propozohet vendosja e një kontenieri 5 ton në fshatin Fushë Muhurr. Ky kontenier do të shërbejë shërbejë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këtë kontenier për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësisë do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatra do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetar ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më të largët, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Muhurri mund të bëhet pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenierëve në qendër të fshatrave. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine mbetjet e thata të grumbulluara në këto kontenierë do të transportohen drejt venddepozitimit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|------------------|---|--|--|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me rrotacion brenda muajit me kontenier 5 ton në qendër të njësisë administrative, fshatin Fushë Muhurr. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në shkollën e vjetër Arras (4 - 5 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të Bashkisë |

| | | | |
|--|---|--|---|
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë në këtë kontenier nëpërmjet zëtorit mbetjet e thata të grumbulluara. Sipas nevojës administratori i njësisë me anë të një kamioni dërgon mbetjet në venddepozitim. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosja e një kontenieri në fshatin Fushë Muhurr. 2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati 3. Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata 4. Tërheqja e mbetjeve të thata me zëtor dhe dërgimi në kontenierin 5 ton 5. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administratori mund të bëjë kërkesë shitesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj 2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin 3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kazan 4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | <ol style="list-style-type: none"> 1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse 2. Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (7) 3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron për grumbullimin 4. Rillogaritet fatura për kostot shitesë |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> | | |





Foto 3: Pika e grumbullimit ndërmjet fshatit Fushë Muhurr dhe Vajmdhej, vendi ku do propozohet vendosja e kontenierit.

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Muhurrit me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në afëri të Fushë Muhurrit dhe nga aty drejt venddepozitimit, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.



Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.

| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|--|---|-------------------|-----------------|----------------|
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Muhurr | | 19 | 7.6 |
| | Rreth Kale | | Pa rrugë | - |
| | Fushë Muhurr | Fushë | 7 | 1.4 |
| | Vajmdhej | Muhurr - Vajmdhej | 7 | 1.4 |
| | Bulaq | | 11 | 3.6 |
| | Shqath | | 16 | 6.1 |
| | Hurdh Muhurr | | 15 | 5.3 |
| Total | | | 1:15 orë | 25.4 km |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshatrave me një makinë deri tek pika grumbullimit | | 1:42 orë | 34.8 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit

Administratori i njësisë + 7 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësia Administrative

Selishtë

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHË M

Njësia administrative e Selishtës përfshihet në Bashkinë Dibër dhe shtrihet në perëndim të kësaj Bashkie. Ka një sipërfaqe rreth 91 km² me një terren pothuajse tërësisht malor.

E gjithë kjo sipërfaqe vendoset në katër gryka (ku në histori njihet me emrin “Katër Grykët”) dhe ku përfundon në rrjedhën e lumit të vetëm që përshkon grykën.

Njësia Selishtë shtrihet në një pozicion strategjik të lëvizjeve të ndryshme mes zonës së Dibrës e asaj të Matit, parë kjo në shumë drejtime si ekonomike, strategjike, historike, demografike.

Largësia nga qendra e Bashkisë (njësia Peshkopi) është rreth 25 km.

Kjo njësi ka numër të kufizuar biznesesh, me vetëm 7 biznese të rregjistruara: 1 Miniera, 1 Ndërtim, 1 Tregti dhe 4 Transport.




Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Selishtë



Foto 2: Foto nga Njësia Administrative Selishtë

POPULLSIA

Njësia Selishtë ka në përbërje 6 fshatra me një numër të kufizuar banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njesisë) Selishtë 517, Selishtë e Epërme 212, Lukan 250, Kacnia 357, Murra 320 dhe Qafë Murrë 285.

Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.


| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|----------|-------------|-----------|------------|---------|-------|
| Selishtë | Census 2011 | 1605 | ~320 | 843 | 762 |
| | Gj.C 2014 | 1974 | 569 | 1024 | 950 |

Lëvizjet demografike për vetë terrenin malor, dimrin e acartë dhe infrastrukturën e dobët kanë qenë një fenomen i shpejtë dhe karakteristik në fillimet e demokracisë, duke synuar lëvizjen drejt qendrave metropolitane si Tiranë e Durrës, por tani sa vjen dhe po shkon drejtë stabilizimit.

Pavarësisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që vetëm për njësinë e Selishtës për vitet 2001 – 2011 popullsia është reduktuar me rreth 50% (shkak migrimi i brendshëm dhe i jashtëm). Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësinë e Selishtës, parashikohet që popullsia e kësaj njësie do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031, me mbi 40%.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Selishtja shfaq një tendencë për uljen e popullsisë **(-48.50%)** shifër kjo pak a shumë e njëjtë me atë të vendeve të izoluar dhe pa shumë zhvillim si Zall Reç – Zall Dardhë, Kala e Dodës dhe Lurë.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabël për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenierëve për fshatrat e njësisë së Selishtës. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,2 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përlllogaritje rezulton që gjenerimi total ditor në këto fshatra të jetë 0.39 ton, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej 6 kontenierësh 1.1 m³.

Tabela 2: Gjenerimi i përlllogaritur i mbetjeve në njësinë administrative Selishtë

| Selishtë | Nr. Banorëve | Norma gjenerimit (Kg/banorë/ditë) | Vol.Kontenierit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (Ton) |
|-------------------|--------------|-----------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------------|
| Selishtë | 517 | 0.2 | 60 | 2 | 0.10 |
| Selishtë e Epërme | 212 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| Lukan | 250 | 0.2 | 60 | 1 | 0.05 |
| Kacnia | 357 | 0.2 | 60 | 1 | 0.07 |
| Murra | 320 | 0.2 | 60 | 1 | 0.06 |

| | | | | | |
|------------|-----|-----|--------------|----------|-------------|
| Qafë Murrë | 285 | 0.2 | 60 | 1 | 0.06 |
| | | | Total | 6 | 0.39 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të zonës e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.16 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 1.12 ton ose 4.5 ton në muaj.

Nëse rrugëtimi i kamionit do të shtrihet në të gjithë njësinë e Selishtës, do të ishte thuajse i pamundur ky shërbim, për shkak të infrastrukturës tejet të dobët dhe terrenit të vështirë malor, gjë e cila do të rriste më shumë koston e shërbimit në zonë.

PËRQASJA E PROPOZUAR

Largësia nga qyteti i Peshkopisë, terreni i egër malor si dhe infrastruktura e dobët rrugore, e bëjnë Lurën një zonë vështirë të aksesueshme. Për këtë arsye propozohet vendosja e një depoje në qendër të njësisë administrative Selishtë. Kjo depo do të shërbejë si një pikë grumbullimi për mbetjet e thata. Këto mbetje të thata (si psh plastikë, letër, alumin, qelq, bateri) do të grumbullohen fillimisht në këtë depo për tu transferuar më pas sipas nevojës në venddepozitim (Peshkopi). Administratori i njësisë do të jetë përgjegjës për transportimin e këtyre mbetjeve deri në venddepozitim. Grumbullimi nëpër fshatra do të vazhdojë me metodën e përdorur deri tani, atë me zetar ose me karrocë derë më derë.

Në një plan më të largët, atëherë kur infrastruktura rrugore do të jetë përmirësuar dhe lidhja me këtë zonë do të jetë më e thjeshtë, Selishta mund të bëhet pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Bazuar në këtë plan afatgjatë do të propozohet vendosja e kontenierëve në qendër të njësisë. Sa herë të jetë e nevojshme nëpërmjet një kamionçine mbetjet e thata të grumbulluara në këto kontenierë do të transportohen drejt venddepozitimit.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|-------------------|--|--|---|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me vendosjen e një depoje në qendër të njësisë administrative Selishtë. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në fshatin Fushë Muhurr (4 - 5 kontenierë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të bashkisë me vendosjen e kontenierëve në qendër të çdo fshati |
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë përgjatë një kohështrirje dy javë ose një muaj në varësi të stinës mbetjet e thata në depo. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshatrat duke përshkruar sipas sistemit të rrugëtimin të paraqitur në hartë |

| | | | |
|--|---|---|--|
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosja e një depoje 2. Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati 3. Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata 4. Grumbullimi i mbetjeve të thata në depo dhe dërgimi i tyre në venddepozitim sipas nevojës 5. Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administrator mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për tërheqjen e mbetjeve. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontraktimi i një mjetei alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj 2. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin 3. Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kontenier 4. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | <ol style="list-style-type: none"> 1. Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse 2. Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (6) 3. Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin 4. Rillogaritet fatura për kostot shtesë |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> | | |





Foto 3: Qendër Selishtë (pika e grumbullimit), vendi ku propozohet vendosja e depos

Distanca dhe kohët e shërbimit

Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Selishtës me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në pikën e grumbullimit fillimisht në fshatin Fushë Muhurr (fshati më i afërt dhe i aksesueshëm me njësinë Selishtë) dhe më pas drejt venddepozitimit, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njësisë.



Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes e nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.

| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|--|--|--------------|-----------------|----------------|
| | Selishtë | | 29 | 12.7 |
| Nga fshati drejt qendrës së grumbullimit | Selishtë e Epërme | Fushë Muhurr | 23 | 9.3 |
| | Lukan | | 42 | 18.8 |
| | Kacnia | | 40 | 17.8 |
| | Qafë Murra | | 42 | 18.9 |
| | Murra | | 43 | 19.4 |
| | Total | | ~ 4 orë | 96.9 km |
| Rrugëtimi total | Përshkrim i të gjithë fshatrave me një makinë | | 3:10 orë | 71.2 km |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit

Administratori i njësisë + 6 kryetarët e fshatrave

Ofrimi i shërbimit në zonat e largëta ose të izoluara

Njësitë Administrative

Zall Dardhë – Zall Reç

PËRSHKRIM I PËRGJITHS HËM Njësitë administrative të Zall Dardhës dhe Zall Reç përfshihen në Bashkinë Dibër. Ato shtrihen në pjesën veriore të kësaj Bashkie dhe kanë një sipërfaqe rreth 35 km² Zall Dardha dhe 51 km² Zall Reçi.

Njësia administrative Zall Dardhë ndodhet në lartësinë rreth 390 metra mbi nivelin e detit pranë Lumit Drin i Zi. Relievi mund të përshkruhet si një shpatore e mbushur me kodra e fshatra në një sfond të gjelbëruar. Kjo zonë është e pasur me burime natyrore ujore.

Njësia administrative Zall Reç ndodhet në lartësinë mbi 1,000 metra mbi nivelin e detit.

Terreni është kryesisht malor. Për shkak dhe të pozitës gjeografike, klima në këto njësi është kontinentale malore, me dimër të gjatë dhe të ashpër, me reshje dëbore përgjatë gjysmës së vitit dhe me verë të freskët e të thatë. Reshjet e dëbores janë të dendura në periudhën e dimrit, **duke e bllokuar shpesh zonën.**

Karakter i malor i zonës, pjesa infrastrukturës dhe vetë pozita gjeografike bëjnë që këto dy njësi të arrihen me vështirësi. **Largësia nga qendra e Bashkisë (njësia Peshkopi) për Zall Reçin (Qendra e Njesisë) është rreth 34 km, ndërsa për Zall Dardhën (Qendra e Njesisë) është rreth 22 km.** Për këtë arsye edhe zhvillimi në këto zona ka ecur me ritme shumë të ngadalta.

Përsa i përket bizneseve, këto njësi kanë një numër tejet të kufizuar, vetëm **pesë biznese** të rregjistruara në Zall Reç dhe **asnjë biznes** në Zall Dardhë. Bizneset kryesore në Zall Reç përfshijnë: 1 Ndërtim, 3 Transport, 1 Tregti. Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara – fshatrat) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative.



Foto 1: Pamje e relievit të njësisë Zall Reç



Foto 2: Pamje e relievit të njësisë Zall Dardhë

POPULLSIA Njësia Zall Reç ka në përbërje 9 fshatrat me një numër të vogël banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njësisë) Zall Reç 279; Kraj – Reç 136; Draj – Reç 191, Qaf – Draj 112; Gjurre – Reç 184; Hurdhe -Reç 94; Bardhej – Reç 81; Ndershen 24; Thark Reç 47.

Njësia Zall Dardhë ka në përbërje 9 fshatrat me një numër të vogël banorësh (shifra mundësuar nga Administratori i Njësisë) Zall Dardhë 346; Lugiej 273; Nezhej 163; Tartaj 176; Lashkizë 168; Soricë 59; Shenlleshen 47; Menesh 37; QA 22

Në tabelën e mëposhtme jepet numri i popullsisë totale sipas Census 2011 dhe Gjendjes Civile 2014, si dhe numri i familjeve, meshkujve dhe femrave.


| Njësia | Burimi | Popullsia | Nr.familje | Meshkuj | Femra |
|-------------|-----------|-----------|------------|---------|-------|
| Zall Dardhë | Census | 1732 | ~350 | 911 | 821 |
| – Zall Reç | Gj.C 2014 | 2401 | 714 | 1254 | 1147 |

Pavërisht pasaktësisë në numrin e popullsisë (situatë e ngjashme kudo në vend), për efekt të gjenerimit të mbetjeve, ajo mbetet shumë e ulët dhe me një shkallë të lartë rënie.

Nga Analiza e Territorit e bërë nga Ministria e Zhvillimit Urban, shihet që në këto dy njësi reduktimi i popullsisë është më i lartë se në çdo njësi tjetër, me mbi 50% (shkak migrimi i brendshëm, i jashtëm dhe kushtet e vështira socio - ekonomike).

Në bazë të projeksionit të popullsisë për të gjithë Bashkinë Dibër, përfshirë edhe njësitë e Zall Dardhës dhe Zall Reçit, parashikohet që popullsia e këtyre njësive do vazhdojë të zvogëlohet deri në vitin 2031, me mbi 50%.

Bazuar në analizën e popullsisë për vitin 2001-2011, Zall Dardha shfaq një tendencë për uljen e popullsisë (-51.20%), ndërsa Zall Reçi shfaq një tendencë më të lartë për zvogëlimin e popullsisë (-65.00%). Janë dy nga të vetmet njësi të Bashkisë Dibër që shfaqin një tendencë kaq të lartë të largimit të popullsisë nga zona.



Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë (Bashkia Dibër) 2001-2011 - marrë nga Analiza e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kjo tendencë rënie populsië ndikon drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve që pritet të gjenerohen në 5 vitet e ardhshme. Megjithatë, pavarësisht tendencës populsië aktuale do të konsiderohet stabilë për 5 vite.

ANALIZA E GJENERIMIT T TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme jepet gjenerimi ditor i mbetjeve si dhe numri i nevojshëm i kontenerëve për fshatrat e njësjive nëse ato do të mund të kishin akses në shërbim. Duke marrë në konsideratë një normë gjenerimi prej 0,2 kg/banor/ditë – normë e supozuar - me përllogaritje rezultojnë që gjenerimi total ditor në këto fshatra të të dy njësjive të jetë **0.49 ton**, me një nevojë për investim në sistem grumbullimi prej **8 kontenerësh 1.1 m³**.

Tabela 2: Gjenerimi i përllogaritur i mbetjeve në njësitë administrative Zall Dardhë dhe Zall Reç

| Zall Dardhë | Fshatrat | Nr.Banorëve | Norma gjenerimit (kg/b/ditë) | Vol.Kontenerit (kg) | Nr.Kontenierëve | Gjenerimi Ditor (ton) |
|-------------|----------|-------------|------------------------------|---------------------|-----------------|-----------------------|
| Zall-Dardhë | | 346 | 0.2 | 60 | 1 | 0.07 |
| Lugjej | | 273 | 0.2 | 60 | 1 | 0.05 |
| Nezhej | | 163 | 0.2 | 60 | 1 | 0.03 |
| Tartaj | | 176 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| Lashkizë | | 168 | 0.2 | 60 | 1 | 0.03 |

| | | | | | | |
|-----------------|--------------------------|-----|-----|----|----------|-------------|
| | Soricë | 59 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| | Shenlleshen | 47 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| | Menesh | 37 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| | QA | 22 | 0.2 | 60 | 0 | 0.00 |
| | Total Zall Dardhë | | | | 5 | 0.25 |
| Zall Reç | Zall-Reç | 279 | 0.2 | 60 | 1 | 0.06 |
| | Kraj-Reç | 136 | 0.2 | 60 | 0 | 0.03 |
| | Draj-Reç | 191 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| | Qaf Draj | 112 | 0.2 | 60 | 0 | 0.02 |
| | Gjurre Reç | 184 | 0.2 | 60 | 1 | 0.04 |
| | Hurdhe Reç | 94 | 0.2 | 60 | 0 | 0.02 |
| | Bardhej Reç | 81 | 0.2 | 60 | 0 | 0.02 |
| | Ndershen | 24 | 0.2 | 60 | 0 | 0.00 |
| | Thark Reç | 47 | 0.2 | 60 | 0 | 0.01 |
| | Total Zall Reç | | | | 3 | 0.24 |
| Njësitë | Total | | | | 8 | 0.49 |

Bazuar në faktin që përqindjen më të lartë për shkak edhe të karakterit rural të këtyre zonave e kanë mbetjet organike (~60%), do të konsiderojmë si mbetje për t'u tërhequr vetëm mbetjen e thatë (40%). Do të thotë që brenda një dite të gjenerohen 0.2 ton mbetje e thatë, llogaritur për një javë 1.4 ton ose 5.6 ton në muaj.

PËRQASJA E PROPOZU AR

Terreni jo i favorshëm dhe i egër malor si dhe infrastruktura e dobët rrugore, bëjnë që njësitë administrative Zall Dardhë dhe Zall Reç të mos përfshihen në skemën e planit afatshkurtër, si pjesë e zonës së madhe të shërbimit të mbetjeve. Për këtë arsye propozohet përfshirja e tyre në sistemin me rrotacion mujor të kontenierit 5 tonësh, i cili do të vendoset në pritje të mbetjeve që grumbullohen brenda njësisë nja një mjet apo mënyrë tjetër. Vendosja e tij do të përcaktohet në bashkëpunim të ngushtë me administratorët e njësive. Sipas nevojës do të bëhet grumbullimi i mbetjeve dhe transportimi i tyre në venddepozitim.

Në një plan të mëvonshëm shërbimi do të shtrihet edhe më gjerë, kjo në varësi të përmirësimit të infrastrukturës rrugore. Gjendja e përmirësuar e rrugëve do të bëjë të mundur vendosjen e kontenierëve në qendër të çdo fshati, duke i bërë fshatrat të aksesueshëm dhe lehtësisht të arritshëm.

| Afati | Afat shkurtër – i mundshëm (1-3 vite) | Afat mesëm – i mundshëm (1 – 5 vite) | Afat gjatë – shumë ambicioz (>5 vite) |
|-------|---------------------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------|
|-------|---------------------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------|

| | | | |
|--|--|---|---|
| Objektivi | Pjesë e sistemit të grumbullimit me rrotacion brenda muajit me kontenier 5 ton në qendër të njësisë administrative, Zall dardhë dhe Zall Reç. | Pjesë e sistemit të grumbullimit të bashkisë së madhe me vendosjen e pikës së grumbullimit në afërsi të urës lidhëse Arras – Fushë Çidhën (4 - 5 kazanë) + Grumbullim derë më derë në të gjithë njësinë me mjete alternative | Pjesë integrale e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të Bashkisë |
| Organizimi | Të gjithë banorët dërgojnë përgjatë një kohështrirje dy javë ose një muaj në varësi të stinës mbetjet e thata në kontenier. | Veprimtaria afatshkurtër vijon si më parë, por grumbullimi fshat më fshat bëhet me karrocë me kalë ose kamionçinë sipas mundësisë financiare | Shërbim i rregullt grumbullimi me makinë teknologjike e cila futet në të gjithë fshtrat duke përkrahur sipas sistemit të rrugëtimit të paraqitur në hartë |
| Veprimtaritë për përmbushjen e objektivit | <ol style="list-style-type: none"> Vendosja e kontenierëve 5 ton të grumbullimit në qendër të njësisë administrative Njoftim i banorëve nëpërmjet grupit të komunikimit Administrator; kreytarë fshati Shpërndarje e qeseve për vitin e parë për grumbullimin e mbetjeve të thata Grumbullimi i mbetjeve të thata në depo dhe dërgimi i tyre në venddepozitim sipas nevojës Në rastet e organizimit të festave lokale me rëndësi të veçantë për grumbullimin e vizitorëve, administrator mund të bëjë kërkesë shtesë për mbërritjen e makinës për | <ol style="list-style-type: none"> Kontraktimi i një mjeti alternativ (karrocë me kalë dhe një person) të grumbullimit derë më derë një herë në muaj Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin Koha e mbërritjes së makinës teknologjike ripërcaktohet në varësi të sasisë që grumbullohet ose mund të shtohet një kontenier. Futet sistemi i tarifës së reduktuar | <ol style="list-style-type: none"> Shtrimi i të gjithë rrugëve lidhëse Vendosja e kontenierëve në çdo qendër fshati (18) Grupi i komunikimit njofton banorët dhe administron grumbullimin Rillogaritet fatura për kostot shtesë |

| | |
|---------------------------------------|---|
| | tërheqjen e mbetjeve. |
| Kostot e lidhura | <i>Për t'u llogaritur gjatë miratimit të skemës</i> |
| Distanca dhe kohët e shërbimit | Për të llogaritur të gjithë kohën e nevojshme për shërbim brenda njësisë së Zall Dardhës dhe Zall Reçit me një makinë, si dhe rrugëtimin individual fshat më fshat me mbërritje në qendër të njësisë, është marrë një kohë mesatare lëvizjeje 30 km/orë. Koha mesatare e lëvizjes nuk merr parasysh vështirësitë gjatë lëvizjes për shkak të infrastrukturës së keqe të rrugëve, kushteve atmosferike, etj. Kjo shpejtësi shërben për të skematizuar rrugëtimin brenda njërive. |





Foto 3: Ura lidhëse në fshatin Lugje që lidh njësinë Fushë-Cidhën me Zall-Dardhën dhe Zall-Reçin

Harta e rrugëtimit dhe llogaritjes së nevojshme për përmbushjen e secilit objektiv.



| Rrugëtimi | Nga fshati | Tek fshati | Koha (min) | Gjatësia (km) |
|-------------|--------------------------------------|--------------------|------------|---------------|
| Zall Reç | Të gjithë fshatrat | Qendër Zall Reç | 3:13 orë | 64.4 |
| Zall Dardhë | Të gjithë fshatrat | Qendër Zall Dardhë | 3:19 orë | 63.7 |
| Njësitë | Qendër Zall Dardhë - Qendër Zall Reç | Ura lidhëse | 39 | 15.6 |

Grupi i punës për zbatimin e shërbimit

Administratorët e njëjësive (Zall Dardhë – Zall Reç) + kryetarët e fshatrave të dy njëjësive

Zhvilluar nga




Plani i Përmirësimit/ Rehabilitimit

Vendgrumbullimi i mbetjeve urbane, Bashkia Dibër

Qershor 2016

Me mbështetjen e



1. Në lidhje me planin

Ky plan është hartuar në bazë të dispozitave të përcaktuara nga VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Landfilli i mbetjeve”, Kapitulli XI “Venddepozimet ekzistuese”, e cila kërkon që Bashkia të zhvillojë dhe të përmirësojë planin për të reduktuar ndikimin në mjedis dhe shëndet të një pikë ekzistuese me leje ose jo.

Venddepozitimi i Dibrës është autorizuar për përdorim me një vendim nga Këshilli për Rregullimin e Territorit të Shqipërisë Nr. 1, datë 21.05.2001. Kjo pikë grumbullimi zotërohet nga Bashkia dhe mbulon një sipërfaqe prej 8000 m². Leja e ndërtimit është lëshuar nga Këshilli për Rregullimin e Territorit për Bashkinë e Peshkopisë Nr. 1, datë 10.03.2003.

Shiko dokumentit zyrtar të bashkangjitur dhe skicat e venddepozitimit.

2. Qëllimi i planit

Ky plan ka si qëllim përmirësimin e situatës ekzistuese të infrastrukturës dhe veprimeve në venddepozitim duke provuar ti jepet zonës statusi i venddepozitimit të kontrolluar.

Përkufizimi i venddepozitimeve të kontrolluara¹

Një venddepozitim i kontrolluar është një zonë asgjësimi jo inxhinierike në të cilin përmirësimi është zbatuar në aspektet funksionale dhe menaxhuese në vend të kërkesave strukturore dhe të objektit, të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme. Venddepozitimet e kontrolluara janë evoluar për shkak të nevojës për të mbyllur venddepozitimet e hapura dhe zëvendësimin e tyre me objekte të përmirësuara depozitimi, dhe duke patur parasysh kufizimet financiare të NJQV – ve. Largimi i kontrolluar i mbetjeve mund të zbatohet mbi mbeturinat ekzistuese (nga venddepozitimi i hapur i mëparshëm) ose nga zona të reja.

3. Funksionimi aktual i zonës

Venddepozitimi i Peshkopisë është projektuar për të marrë mbetjet urbane nga qyteti dhe fshatrat përreth për pothuajse 25 vjet bazuar në llogaritjet e bëra në 2003 kur u ndërtua kjo zonë.

Zona është drejtuar nga Bashkia e Peshkopisë dhe përdoret nga dy Komuna të tjera (Melan dhe Tomin) bazuar në një marrëveshje të përbashkët ndërmjet këtyre NJQV-ve. Pas reformës administrative territoriale, zona drejtohet nga Bashkia e Dibrës e cila

¹ Sipas UNEP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin

përbëhet nga 15 ish njësi. Kjo është e vetmja zonë me një leje përdorimi. Megjithatë, zona nuk përmbush standartet e duhura inxhinierike dhe është drejtuar keq.

Tashmë mbetjet që vijnë në zonë nuk rregjistrohen dhe asnjë operator vendas nuk është punësuar në këtë vend. Bazuar në llogaritjet e përafërta sasia e mbetjeve që vjen nga qyteti i Peshkopisë është 6 – 8 t/ditë, ndërkohë që për njësitë e tjera nuk mund të llogariten pasi rruga dhe mjetet me të cilat ato transportohen nuk janë pronë e Bashkisë.

Një traktor punon në zonë duke shtyrë mbetjet dhe duke i miksuar ato me tokën. Megjithatë, traktori nuk punon në zonë me një plan funksionimi real. Prandaj, brenda zonës formohet një kodër ndërkohë që gjysma e zonës është bosh. Në këtë situatë nuk mund të implementohet menaxhimi i duhur në zonë. Zona kërkon shumë punë përmirësuese përpara se ky menaxhim i duhur të implementohet.

Për shkak të masave të pakontrolluata zona është e hapur për kafshët, edhe ka patur raste që të ndodhin edhe zjarre gjatë dimrit.

Parashikimi i mbetjeve që do vijnë në zonë për 10 vitet e ardhshme

Bashkia e Dibrës po planifikon të ofrojë shërbimin në një zonë më të gjerë duke pritur t'i shërbejë rreth 40 000 – 50 000 banorëve në një zonë me të ardhura shumë të ulta.

Në këtë kuadër nqs shërbimi do të ofrohet çdo ditë për të gjithë zonën e shërbimit sasia e mbetjeve të depozituara në venddepozitim të kontrolluar pritet të arrijë 12 ton mbetje/ditë (norma e gjenerimit për frymë ekuivalente me 0.3 kg). Por duke marrë në konsideratë se shumica e territorit është zonë rurale me konsum të ulët shërbimi në 50% të territorit mund të ofrohet një herë në dy ditë. Prandaj, sasia e mbetjeve të depozituara në ditë në këtë venddepozitim konsiderohet të jetë 10 ton/ditë.

Venddepozitimi ka një sipërfaqe 8000 m² dhe një lartësi 10 m e cila mund të mbajë rreth 60.000 m³ material. Në këtë drejtim, venddepozitimi mund të zgjasë për 5 vite me shtresëzimin e duhur dhe përdorimin e të gjithë zonës.

Llogaritja e vëllimit të venddepozimit

Vëllimi i kërkuar është llogaritur duke përdorur formulën e cila përfshin normën e veçantë të prodhimit të mbetjeve të ngurta, peshën vëllimore dhe raportin e ngjeshjes.

$$V1 = d[R/w + Cv]$$

Ku V1 : vëllimi i kërkuar i landfillit për person në vit (m³/frymë,vit)

R : shkalla specifike e prodhimit të mbetjeve të ngurta (=0.4 kg/frymë, ditë)

w: pesha vëllimore e mbetjeve të ngurta pas ngjeshjes (=800kg/m³)

Cv : vëllimi specific i kërkuar për shtresat e izolimit në fund, shtresat mbuluese ndërmjet pjesës së mbeturinave të ngurta dhe shtresës së fundit që mbulon pjesën e sipërme (=0.0004 m³/frymë.ditë)

d : numri i ditëve në një vit (=365 ditë/vit)

ec : efiçenca e grumbullimit të mbetjeve të ngurta (=0.85)

Llogaritja alternative 1:

$$V_1 = 365[0.4/800 + 0.0004] = 0.33 \text{ m}^3/\text{frymë.vit}$$

Vëllimi i kërkuar i landfillit për vitin 0

$$V_0 = V_0.N_{2003} = 0.33 \text{ m}^3/\text{frymë.vit} \times 20.000 \text{ frymë}$$

$$V_{2003} = 6.750 \text{ m}^3/\text{year}$$

Pas zgjidhjes dhe dekompozimit:

$$V_{2003} = (6.750) \times 0.8 = 5.226 \text{ m}^3/\text{vit}$$

Llogaritja alternative 2:

$$V_2 = 365*(0.4/800)0.85 + 0.0004) = 0.30 \text{ m}^3/\text{frymë.vit}$$

Vëllimi i kërkuar i landfillit për vitin 2003,

$$V_{2003} = V_2.N_{2003} = 0.30 \text{ m}^3/\text{frymë.vit} \times 20.000 \text{ frymë}$$

$$V_{2003} = 6.022 \text{ m}^3/\text{year}$$

Pas zgjidhjes dhe dekompozimit:

$$V_{2003} = (6.022) \times 0.8 = 4.818 \text{ m}^3/\text{year}$$

Llogaritja e jetëgjatësisë së venddepozitimit

a. Planifikimi për zonën

Sipas llogaritjeve të mësipërme, duke marrë parasysh vëllimin e përafërt të zonës rreth 60.000 m³ dhe nevojat për depozitim 4.818 m³/vit, jetëgjatësia totale e zonës shkon rreth 13 vjet.

Nqs ky venddepozitim do të funksiononte rregullisht dhe do bëhej ngjeshja e mbetjeve jetëgjatësia e zonës do të zgjatej (duke konsideruar si fillim vitin 2003) deri në 2015.

Aktualisht zona është pothuajse e mbushur me mbetje, e cila tregon se parashikimi për gjenerimin e mbetjeve nuk është matur siç duhet ose mbetja nuk ka arritur në zonë në sasinë e plotë të krijuar.

b. Llogaritja e kapacitetit të zonës pas bashkimit të NJQV - ve

Sipas planit për Bashkinë e re të zgjeruar zona pritet t'i shërbejë rreth 50 000 banorëve.

Duke përdorur formulën e mësipërme, nevoja për vëllimin vjetor në venddepozitim është:

$$V_{2017} = 365 * (0.3/800)^{0.85} + 0.0004 = 0.30 \text{ m}^3/\text{frymë.vit}$$

Vëllimi i nevojshëm i landfillit për vitin 2017:

$$V_2 = V_2.N_{2017} = 0.30 \text{ m}^3/\text{frymë.vit} \times 40.000 \text{ frymë}$$

$$V_{2017} = 12.000 \text{ m}^3/\text{vit}$$

4. Analiza e situatës aktuale të venddepozitimit

Sipas vlerësimit, situatë e venddepozitimit mund të përshkruhet si më poshtë:

Pikat pozitive

+ Zona është 1 km nga lagjia më e afërt e qytetit të Peshkopisë dhe rreth 2 km nga qendra e qytetit.

Gjithashtu, zona është mjaftueshëm larg dhe e fshehur nga vendbanimet (zona më e afërt është rreth 700 m larg).

+ Zona përdoret vetëm për mbetjet urbane dhe nuk ka ndonjë material inert apo ndërtimi të hedhur në këtë zonë. Inertet asgjësohen 50 m poshtë kësaj zonë, e cila lehtëson përdorimin e saj si material mbulues.

+ Zona ka funksionuar rregullisht, megjithëse në një nivel të limituar. Një ekskavator, punon në orë jo të rregullta gjatë ditës, për të larguar mbetjet. Një ose dy herë në javë, ekskavatori për të mbuluar mbetjet me dhé.

Pikat negative

- Venddepozitimi është i pozicionuar direkte në shtratin e përroit. Një digë mbyll luginën, pas së cilës depozitohen mbetjet. Përroi rrjedh nën mbetje nëpërmjet një tubi betoni, i ndërtuar për këtë qëllim. Kjo krijon problem madhore:

- Ndotje direkte të ujërave.

- Qëndrueshmëria e digës nuk është e garantuar dhe mund të shembet (janë shfaqur tashmë shenja erozioni).

- Ka një rrezik të lartë për pengimin e tubacionit:

- mbetjet mund të bllokojnë tubacionin.
- tubacioni mund të shembet nga pesha e mbetjeve.

Nqs kjo ndodh, uji mund të akumulohet në venddepozitim, duke krijuar paqëndrueshmëri. Diga mund të shembet, duke krijuar një rrëshqitje dherash dhe do të transportonte të gjitha mbetjet në lumë, në një distancë të madhe. Pastrimi i zonës pas një aksidenti të tillë do të nënkuptonte gërmime të shumta të rëndësishme.

- Zona nuk është e rrethuar, hyrja nuk është e kontrolluar, ka edhe kafshë brenda saj.
- Vrojtimi tregon se mbetjet nuk mbulohen në mënyrë sistematike.
- Ka disa raste të raportuara për zjarre gjatë verës.

- Mbetjet ngjeshen pak.


Vrojtime të përgjithshme

Nuk ka një landfill sanitar në rajon. Derisa të ndërtohet një i tillë, bashkia do të vazhdojë të përdorë këtë venddepozitim të autorizuar. Prandaj, janë propozuar masa që duhen marrë për një kontroll dhe siguri më të mirë, në fazën kalimtare.


Masat teknike dhe operacionale të mëposhtme janë propozuar për t'u marrë parasysh:

1. Ndarja e një buxheti të duhur për menaxhimin e venddepozitimit. Të sigurohemi që ky buxhet është në dispozicion çdo muaj kështu që menaxheri i venddepozitimit të veprojë në zonë.
2. Masat duhet të ndërmerren për të shmangur rrëshqitjen e dheut.
 - a. Shpati i venddepozitimit të mbetjeve mund të stabilizohet me prita të ndërmjetme të ndërtuara me mbetje inerte, siç paraqitet në figurën më poshtë.

Seksioni kryq gjatësor (vizatime konceptuale, jo në shkallë)







1. Ekzistuesja




2. Rikonstrkturimi i rekomanduar

Legjenda

-  Tubacioni
-  Maja e venddepozitimit
-  Bazamenti (fundi venddepozitimit)
-  Diga
-  Prita (materiale inerte)

Në mënyrë ideale, përroi duhet të shmanget që të anashkalojë depozitimin. Në bazë të konfiguracionit të zonës, ky opsion kërkon punë të madhe civile dhe nuk duket shumë i mundshëm nga ana ekonomike.

Ndërkohë që tubacioni vazhdon të ekzistojë i vetmi opsion mbetet garantimi i mirëmbajtjes së tij. Kolapsi duhet të shmanget dhe garantohet aksesimi në tubacion, për të bërë pastrimin e tij. Venddepozitimi duhet të rimodelohet dhe shfrytëzohet në një mënyrë që të reduktohet sa më shumë presioni në tubacion dhe të lejohet aksesimi i mëvonshëm në të, në mënyrë që të riparohet kur të jetë e nevojshme.



- Tubacioni duhet të kontrollohet rregullisht, duke kaluar një kamera nëpër të, nqs teknologjia është në dispozicion.
- Largimi i mbetjeve duhet të bëhet i kontrolluar nga operatori i venddepozitimit, i cili kontrollon dhe rregjistron cilësinë e mbetjeve dhe largimin ditor të tyre (nr. i kamionit, vlerësimi i ngarkesës, sipërfaqja e mbledhjes, komente mbi kualitetin e mbetjeve).
- Hapësira e punës duhet të reduktohet sa më shumë të jetë e mundur dhe të operohet “qelizë pas qelize”, çdo qelizë do të ketë një zgjerim me 5x5x2.5 metër. Hapësirat e mbetura do të mbulohen me dhé.
- Për të shmangur zjarrin, kafshët dhe “fluturimet” e plastikës, mbetjet duhet të mbulohen rregullisht me dhé ose edhe me mbetje inerte.
- Zona duhet të rrethohet.
- Për të shmangur infiltrimin e ujërave, duhet të ndërtohet një hendek periferik.
- Kullimet rrjedhin përmes digës. Ato duhet të mblidhen në një basen në rrjedhën e poshtme. Të paktën në sezonin e thatë, kur ka më pak ujë në lumë dhe nuk ka doçsim, likuidi nga baseni duhet të pompohet dhe të rifutet në qarkullim në venddepozitim.

5. Vlerësimi gjeologo - inxhinierik dhe hidrogjeologjik i venddepozitimit të mbetjeve

Proçesi i vlerësimit (Maj 2016) është drejtuar nga një inxhinier i certifikuar, bazuar në kërkesën e Bashkisë për të propozuar masat për zvogëlimin e rrezikut të dëmit dhe shkatërrimit të fushës dhe përmirësimin e gjendjes për të kontrolluar venddepozitimin si në planin e propozuar.

Vëzhgimet e përgjithshme të vlerësimit

Gjeografia

Zona është e vendosur 1 km nga qyteti, përreth një lugine të vogël të krijuar nga një lumë i vogël 600 – 650 m mbi nivelin e detit. Koordinatat janë 41°40'28.95"N dhe 20°25'43.71"E.



Klima

Zona bën pjesë në klimën mesdhetare e cila karakterizohet nga dimër i ashpër dhe i lagët dhe verë e thatë. Sasia mesatare e rreshjeve është 1300 – 1500 mm dhe konsiderohet si një zonë me intesitet të lartë të rreshjeve. Lartësia e borës në dimër e kalon 1 m. temperaturat variojnë nga -7° C në dimër në mbi 35°C në verë.

Gjeologjia

Zona është e pozicionuar në një pjesë gjysmë kodrinore. Në pjesën veriore është e rrethuar nga toka bujqësore të cilat shtrihen në një fushë të sheshtë. Në pjesën jugore terreni ngrihet duke krijuar një shpat të lehtë me një kënd 10 – 200° të cilat njihen si kodrat Llasen. Në pjesën perëndimore terreni ulet deri në afërsi të lumit Doshisht i cili rrjedh rreth 200-250 m në drejtim të rrymës dhe më pas derdhet në lumin Drin.

Kushtet gjeologjike dhe inxhinierike

sipas studimeve të bëra në zonë materiali i shtresave të tokës ka përbërjen granulometrike si më poshtë:

| | |
|---------|----------|
| Zhavorr | 3 - 5 % |
| Rërë | 35 - 45% |
| Pluhur | 27 - 34% |
| Argjilë | 15 - 25% |

Parametrat fizikë dhe mekanikë

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------------|
| Kufiri i sipërm i plasticitetit | WL 34 - 36% |
| Kufiri i poshtëm i plasticitetit | Wp 16 - 18% |
| Plasticiteti mesatar | I _p 15 - 20 % |
| Moduli i deformimit | E 50 - 70 kg/ cm ² |
| Koeficienti i tërheqjes së brendshme | φ 15 - 17 0 |
| Kohezinoi | C 0.10 - 0.20 kg/ cm ² |

Hidrologjia

Zona nuk ka ujëra nëntokësorë kështu që efekti është shumë i ulët në këtë aspekt. Gjithsesi, zona është e ndërtuar në shtratin e përroit i cili ka një rrjedhje shumë të ulët të ujërave rreth 10 – 12 l/s e cila varion nga e ulët në periudha të thata në shumë e lartë në periudha me rreshje. Për rrjedhje normale të ujërave të përroit është ndërtuar një tubacion (me diametër 800mm) dhe mbi të është ndërtuar venddepozitimi.

Konkluzione

Analiza nxjerr përfundimet e mëposhtme:

1. Zona është zgjedhur siç duhet përse i përket pjesës së gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe inxhinierisë gjeologjike por masat e nevojshme duhet të ndërmerren gjatë investimeve në aspektin e infiltrimit të ujërave dhe drenazhimit.

2. Venddepozitimi i mbetjeve nuk ka funksionuar si duhet dhe materiali ka formuar një kodër në zonë. Materiali tashmë është 3 – 4 herë më i lartë se lartësia e argjinaturës së ndërtuar për të izoluar materialin dhe prej tyre është kërcënuar kapaciteti i saj për të mbajtur mbetjet. Argjinatura është në rrezik të lartë dëmtimi ose shpërthimi.
3. Mbetjet nuk trajtohen si duhet në zonë në aspektin e mbulimit me dhé ose punës me qeliza.
4. Rrjedhja nga zona shkon e patrajtuar direkte në përrua dhe më pas në lumin Doshisht për të përfunduar në lumin Drin.
5. Argjinaturës i duhen bërë kërkime të mëtejshme për qëndrueshmërinë.

6. Plani i rehabilitimit

Plani i rehabilitimit u propozua sipas matriksit të mëposhtëm në mënyrë që të adresohen rreziqet që shkakton zona dhe rreziku në zona dështon nga faktorë të brendshëm apo të jashtëm. Janë propozuar masa afatshkurtra të cilat do të hyjnë në veprim menjëherë pas aprovimit të planit dhe masa afatmesme deri afatgjata të cilat do të aprovohen në bazë të kapaciteteve financiare.

| Rreziku i mundshëm | Përshkrimi | Masat e propozuara | Dokumentacioni Teknik | Kostot | Afati i Zbatimit |
|--|--|---|--|---|--------------------|
| Masat Afatshkurtra | | | | | |
| 1. Zonë që nuk është më në gjendje të mbajë më shumë mbetje | Për shkak të funksionimit të papërshtatshëm të zonës së mbetjeve nuk ka ndodhur shpërndarja siç duhet në vend dhe jeta e venddepozitimit është shkurtuar duke rrezikuar të mos jetë në gjendje për të mbajtur më shumë mbetje. | 1. Nivelimi i zonës a. Punime në zonë për të shtyrë mbetjet në anën tjetër të zonës dhe krijimi i një baze të sheshtë. Ky veprim do të ulë kodrën e krijuar dhe do mund të krijohet më shumë hapësirë për shtresa të reja. Aktualisht | E bashkangjitur skica e masave të propozuara | Masa 1 Mjete për zbatimin e masave të propozuara: 1. Buldozer 2. Karburant për buldozerin Masa 2 Masa 3 | Afat shkurtër 2016 |

| | | | | | |
|--|--|---|--|--|--|
| | | <p>(viti 2015) mbetjet janë të vendosura në një sipërfaqe me rreth 5000 m² (në lartësi të ndryshme), krahasuar me 2000 m² të viti 2000. Shtrirja totale e zonës është 8000 m².</p> <p>b. Ngjeshja e mbetjeve që vijnë në qeliza 5x5x2.5m bazuar në standartet në standartet e metodologjis ë.</p> <p>Maksimumi i qelizave për shtresën do të jetë 300 (8000m²)</p> | | | |
|--|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | <p>dhe minimumi do të jetë 100m² (për rreth 3000m²). Numri total i qelizave do të llogaritet në bazë të modelit final vëllimor.</p> <p>2. Mbulimi i shtresës së parë me dhé Do të plotësohet një shtresë komplet me material solid me një sipërfaqe 8000 m².</p> <p>3. Ndërtimi i një dige të sipërme për të krijuar formën e një "vaske" Vëllimi i zonës nuk është i</p> | | | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--------------------------------|---|---|--|------------------------------------|-------------------------|
| | | <p>rregulluar dhe po kështu është edhe potenciali për të marrë sasinë maksimale të materialit për m³. Pjesa e sipërme nuk ka barrierë për të mbajtur shtresat e materialit dhe futja e shtresave të shkallëzuara do të reduktojë ndjeshëm kapacitetin vëllimor të zonës.</p> | | | |
| 2. Zona mund të shembet | Diga e rrjedhjes së poshtme të zonës është ndërtuar për të mbajtur materialin dhe mos | 4. Përforcimi i një dige më të ulët | E bashkangjitur skica e masave të propozuara | Masa 4 Masa 5 | Afat shkurtër 2016-2017 |

| | | | | | |
|--|---|--|--|----------------------|--|
| | <p>lejuar që të derdhet në lumë. Për shkak të veprimeve të pakontrolluara në zonë, sasia e materialit që ushtron presion në digë është tej kapaciteteve të saj dhe diga po çahet dhe vjetërohet.</p> <p>Tubacioni poshtë venddepozitimit nuk do të jetë në gjendje të mbajë sasinë e materialit të planifikuar për zonën.</p> <p>Tubacioni është bllokuar nga rrjedhja e mbetjeve brenda tij.</p> <p>Punëtorët e pastrojnë atë rregullisht pasi në mënyrë të përsëritur bllokohet nga grumbullimi i mbetjeve.</p> | <p>5. Përforcimi i tubacionit</p> <p>6. Mbulimi i tubacionit me një rrjetë</p> <p>Një rrjetë me madhësi të përshtatshme do të zbatohet në anën e sipërme të tubit duke lejuar rrjedhën normale të ujërave dhe reduktimin e rrezikut për lagjen e zonës nga ujërat.</p> | | <p>Masa 6</p> | |
|--|---|--|--|----------------------|--|

| | | | | | |
|---|---|---|--|---|-----------------------------|
| <p>3. Rrjedhja e liksivateve ndot ujërat</p> | <p>Zona nuk ka asnjë sistemi trajtimi të ujrave që rrjedhin nga fusha (liksivateve). Ujërat e tubacionit që kalon në zonë transportojnë edhe rrjedhjet e mbetjeve të zonës. Këto ujëra vazhdojnë rrugëtimin duke u bashkuar me degë të tjera duke ndotur ujëra dhe toka të tjera.</p> | <p>7. Ndërtimi i ligatinave në shkallë të vogël nën digën e zonës</p> <p>Ligatina do të ndërtohet duke përdorur metoda të njohura për ndërtimin e ligatinave në shkallë të vogël, si ato të ndërtuara në Impiantet e Trajtimit të Ujërave që nuk kërkojnë shumë kosto mirëmbajtjeje e. Megjithatë, heqja e llumit do të ndodhë gjatë kohës dhe ai do të depozitohet përsëri në zonë.</p> | <p>E bashkangjitur skica e masave të propozuara</p> <p><i>Modeli i propozuar do të përbëhet nga një ekran i trashë dhe një dhomë zhavorri për trajtimin paraprak, një reaktor anaerobik 42 m³ për trajtim paraprak, kallamishtet e rrjedhjes horizontale e ndjekur nga rrjedhja vertikale për trajtimin sekondar dhe dy shtretër për tharjen e llumit për trajtimin e tij. Impianti merr nje sasi rrjedhje mesatare ditore 10 m³ të ujërave të zeza.</i></p> | <p>Masa 7</p> <p>Kostoja totale e ndërtimit të ligatinës mund të jetë rreth 35 Euro për m². Kostoja mesatare O&M për ligatinën është 260 Euro në vit.</p> | <p>Afat mesëm 2017-2019</p> |
|---|---|---|--|---|-----------------------------|


| | | | | | |
|---|---|---|---|-----------------------------|-----------------------------|
| <p>4. Zona është e hapur për kafshët dhe zjarret</p> | <p>Zona frekuentohet nga kafshët dhe shpesh ndodhin zjarre nga ata që mbledhin mbetjet. Për më tepër, zona nuk është e kontrolluar dhe nuk ka një portë hyrëse dhe kamionë të paautorizuar e mjete të tjera depozitojnë mbetje në zonë.</p> | <p>8. Rrethimi i venddepozitimit Zona do të rrethohet në të gjithë perimetrin e saj nga pjesa e kodrës dhe e rrugës, ndërsa dy pjesët e tjera do të rregullohen nga pritat.</p> | <p>E bashkangjitur skica e masave të propozuara</p> | <p>Masa 8</p> | <p>Afat shkurtër 2016</p> |
| <p>4. Krijimi i gazit në zonë</p> | <p>Dekompozimi i materialit është natyral në zonë në dy situatat aerobike dhe anaerobike. Zona nuk është e planifikuar që të ketë ndonjë tubacion për kontrollin dhe shkarkimin e gazit.</p> | <p>9. Ndërtimi i një impianti për kapjen e gazeve që formohen në brendësi të fushës Kjo masë do të kërkojë llogaritje shtesë dhe do të zhvillohet në një fazë të mëvonshme bazuar në</p> | <p>NA</p> | <p>Masa 9 NA</p> | <p>Afat gjatë 2017-2020</p> |

| | | | | | |
|--|--|--|----|--|---------------------------|
| | | funksionimin e duhur të zonës, pas investimeve të propozuara nga ky plan. | | | |
| 5. Zona nuk po funksionon siç duhet | Aktualisht zona nuk po funksion në bazë të një plani apo rregulloreje. Ardhja e mbetjeve në zonë nuk është e kontrolluar dhe sasia e tyre nuk është e raportuar. Koha e punës dhe fondet për operim nuk janë llogaritur mirë dhe nuk janë ruajtur. | 10. Hartimi i një plan veprimi të zonës Një plan i thjeshtë por konkret veprimi do të zhvillohet dhe menaxhohet nga sektori për menaxhimin e mbetjeve të Bashkisë. Plani do të sigurojë udhëzime për veprimet në zonë në mënyrë që të ndiqen masat | NA | Masa 10 Jo kosto shtesë (do të zhvillohet nga specialistët e Bashkisë) | Afat shkurtër 2016 - 2017 |


| | | | | | |
|--|--|---|--|--|--|
| | | e hartuara nga ky plan i përgjithshëm . | | | |
|--|--|---|--|--|--|

Aneks- Skicat e hulumtimit të zonës

Dibre dumpsite situation - rough drawing (not to scale)




Dibre dumsite longitudinal coupe - rough drawing (not to scale)




Et. Bashkia e Dibrës - 1927. M.H. Qyari - 1927. 00000118

Aneks- Planimetria e venddepozimit (siç është propozuar për ndërtim)

PLANIMETRIA E SHESHIT TË NDËRTIMIT
PËR FUSHËN E DEPOZITIMIT DHE PËRPUNIMIT TË
MBETURINAVE URBANE PËR QYTETIN E *Peshkopitë*
SI PËRFAQJA S = 8000M²
SH 1" 1000



POZICIONI KADASTRAL
I FUSHËS SË MBETURINAVE
URBANE PËR QYTETIN E PESHKOPISE
SH. 1#2500




"MIRATOHET"
KRYETARI I K.R.R.T TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
/ ILIR META /

MINISTRI I BUJQËSISË DHE USHQIM
/ LUFTER XHUVELI /

PREFEKTI I QARKUT DIBËR
/ HAJREDIN TAHIRI /

SKEMA RAJONALE E VENDOSJES SË
FUSHËS SË DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE
NË LIDHJE ME PLANIN RREGULLUES TË QYTETIT
SH 1#25000



SHSHI I DEPOZITIMIT TË MBETJEVE
URBANE Peshkopi S= 5000M²

Analiza e detajuar me profile e sasisë së mbetjeve në fushë (Korrik 2016) – prerjet sipas profileve






Tabela e volumeve ne perspektive te landfill-it - Peshkopi

| Profili | Siperfaqja (m2) | Sip. Mes. (m2) | Distanca midis profileve | Volumi (m3) |
|---------|-----------------|----------------|--------------------------|-------------|
| 1 | 0 | | | |
| | | 210 | 10 | 2,095 |
| 2 | 419 | | | |
| | | 385 | 10 | 3,845 |
| 3 | 350 | | | |
| | | 353 | 10 | 3,530 |
| 4 | 356 | | | |
| | | 361 | 10 | 3,605 |
| 5 | 365 | | | |
| | | 474 | 10 | 4,740 |
| 6 | 583 | | | |
| | | 582 | 10 | 5,820 |
| 7 | 581 | | | |
| | | 681 | 10 | 6,805 |
| 8 | 780 | | | |
| | | 810 | 10 | 8,100 |
| 9 | 840 | | | |
| | | 777 | 10 | 7,765 |
| 10 | 713 | | | |
| | | 668 | 10 | 6,680 |
| 11 | 623 | | | |
| | | 492 | 10 | 4,915 |
| 12 | 360 | | | |
| SHUMA | | | | 57,900 |

Profilet sipas indeksit me lart




Profili 4




| | |
|---------------------|--------|
| MARKETI | 0 |
| DISTANCA PËRSHI | 0 |
| DISTANCA PROGRESIVE | 0.00 |
| SHKURTË TËNDRË | 0.00 m |
| SHKURTË E PËRSHI | 0.00 |
| MARKETI E TËNDRË | 0 |

Profili 5



| | |
|---------------------|--------|
| MARKETI | 0 |
| DISTANCA PËRSHI | 0 |
| DISTANCA PROGRESIVE | 0.00 |
| SHKURTË TËNDRË | 0.00 m |
| SHKURTË E PËRSHI | 0.00 |
| MARKETI E TËNDRË | 0 |

Profili 6




| | | | | | | | |
|---------------------|--------|--------|--------|---------|--------|--------|--------|
| MARKETI | 0 | 2 | 3 | 17 | 0 | 0 | 0 |
| DISTANCA PËRSHI | 0.00 | 2.00 | 3.00 | 17.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| DISTANCA PROGRESIVE | 0.00 | 2.00 | 3.00 | 17.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| SHKURTË TËNDRË | 0.00 m | 2.00 m | 3.00 m | 17.00 m | 0.00 m | 0.00 m | 0.00 m |
| SHKURTË E PËRSHI | 0.00 | 2.00 | 3.00 | 17.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| MARKETI E TËNDRË | 0 | 2 | 3 | 17 | 0 | 0 | 0 |

Spjeguesi


| | |
|--|--|
| | Vija aktuale e terrenit (toka + mbushja me mbotim) |
| | Vija kulturore e parcelave se landfillit (vija e pronës) |
| | Zona e mbushjes se landfillit ne perspektive |

Profili 7




| | |
|---------------------|------|
| SH. PROFILIT | 0 |
| DESTAFIDA FIZIKE | |
| DESTAFIDA PROJEKTIV | 0.00 |
| KURTA E TËNES | 0.00 |
| KURTA E MBUSHES | 0.00 |
| KATODURA E TËNES | |

Profili 8






| | |
|---------------------|------|
| SH. PROFILIT | 0 |
| DESTAFIDA FIZIKE | |
| DESTAFIDA PROJEKTIV | 0.00 |
| KURTA E TËNES | 0.00 |
| KURTA E MBUSHES | 0.00 |
| KATODURA E TËNES | |

Profili 9




| | |
|---------------------|------|
| SH. PROFILIT | 0 |
| DESTAFIDA FIZIKE | |
| DESTAFIDA PROJEKTIV | 0.00 |
| KURTA E TËNES | 0.00 |
| KURTA E MBUSHES | 0.00 |
| KATODURA E TËNES | |


| Spjeguesi | |
|---|---|
|  | Vija aktuale e terrenit (toka + mbushja me mbotimnat) |
|  | Vija kultivuese e parcelës së landfilit (vija e pronës) |
|  | Zona e mbushjes së landfilit në perspektivë |



Profili 13



Profili 14 (Tubacioni kryesor b/a me d=800mm)




Spjeguesi

| | |
|--|--|
| | Vija aktuale e terrenit (loka + mbushja me mbotimim) |
| | Vija kultivuese e parrcales se kandillit (vija e prones) |
| | Zona e mbushjes se kandillit ne perspektive |

Aneks - Skica për masën 7


Modeli i propozuar për trajtimin e rrjedhës horizontale




Shembull i modelit të propozuar të trajtimit



Skica operative e mirëmbajtjes







Dibrë
Preliminary design of the landfill
Situation

DRAFT

CSD ENGINEERS SA
 ÇIKURIM I INGENIERËSHI
 SHËRBIM I INGENIERËSHI
 SHËRBIM I INGENIERËSHI

CSD ENGINEERS SA
 ÇIKURIM I INGENIERËSHI
 SHËRBIM I INGENIERËSHI
 SHËRBIM I INGENIERËSHI

08.08.2017 SHR EGE 1:500 EX0014.600

| | |
|---|--|
|  <p>REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER Albania</p>  | <p>"Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë e Dibrës" Referenca e Projektit REC: A3745-A138</p> <p>Fillimi i takimit</p> |
| <p>TITULLI:</p> | <p>Fillimi i takimit në lidhje me projektin dhe procesin e zbatimit</p> |
| <p>DATA E NGJARJES:</p> | <p>01 Prill 2016</p> |
| <p>VENDI</p> | <p>Peshkopi</p> |
| <p>OBJEKTIVAT</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i takimit me palët e interesuara; - Dhënia e informacionit në lidhje me projektin dhe procesin; - Angazhimi në proces; - Diskutimi në lidhje me pengesat dhe rreziqet e procesit. |
| <p>PËRSHKRIMI:</p> | <p>Aktiviteti u organizua me qëllim përfshirjen dhe mobilizimin e të gjitha palëve të interesuara që operojnë në Bashkinë e Dibrës si për shembull Drejtoritë Rajonale ose Agjensitë për Mjedisin, Bujqësinë, Sigurinë Ushqimore, Arsimin dhe Shëndetin gjithashtu dhe Prefektura, Këshilli Rajonal, OJF-të, Administratorët Lokalë dhe stafi i Bashkisë. Më shumë se 50 persona morën pjesë në takim (Aneksi Nr.2: Lista e pjesëmarrësve) dhe u përfshinë në mënyrë aktive duke shprehur opinionet e tyre, pikëpamjet dhe mbështetjen për iniciativën.</p>  |
| | <p>Aktiviteti u organizua dhe u drejtua nga Kryetari i Bashkisë së Dibrës, Z. Shukri Xhelili, i cili bëri një përmbledhje të përgjithshme përsa i përket zhvillimeve të Bashkisë së re të madhe, mbuluar pjesërisht nga ky projekt. Ai theksoi zhvillimet e tjera si për shembull plani i zhvillimit urban dhe plani</p> |

rregullator si dhe investimet e planifikuara në zonë, të cilat kanë krijuar sinergji dhe mbështetje për përmirësimin e projektit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Ai ftoi të gjithë të ishin pjesë e procesit për ta bërë atë të suksesshëm dhe të pranuar nga qytetarët.

Kryetari i dha fjalën Z. Eduart Cani, ekspertit kryesor për zhvillimin e planit dhe komponentëve të tjerë të projektit, për të prezantuar një përmbledhje të projektit dhe procesit të zbatimit.

Z. Cani, i ndihmuar edhe nga Znj. Antike Torba, Shefe e Shërbimeve Publike në Bashkinë e Dibrës, prezantoi elementët kyç të projektit. Në të u përmendën gjithashtu nevoja për planifikim dhe shërbim të përmirësuar, objektivat dhe veprimet, sfidat dhe pengesat, rreziqet dhe mangësitë si dhe historitë kryesore të suksesit të projektit lidhur me venddepozitimin, qasjen pro të varfërve dhe aspektet administrative (Aneksi Nr.3: Prezantimi).



Ai theksoi zbatimin e procesit dhe mënyrën se si do të përfshihen palët e interesuara në zbatimin e tij. Z. Cani ftoi palët e interesuara të jenë pjesë e projektit duke patur një rol aktiv në marrjen e vendimeve, në mënyrë që të lehtësohen dhe kapërcehen sfidat dhe rreziqet gjatë projektit.

Disa nga rreziqet e zgjerimit të shërbimit në zona të reja dhe përmirësimi i venddepozitimit dhe lejeve. (Aneksi Nr.4: Prezantimi).

Sesioni i diskutimit

Pjesëmarrësit shprehën pikëpamjet e tyre për projektin dhe procesin si më poshtë:

- **Përfaqësuesi i policisë së shtetit:** ne jemi të angazhuar me shkollat me policimin në komunitet. Mund të krijojmë një sistem dhe të përdorim iniciativën tonë që të shpërndajmë informacionin dhe rrisim ndërgjegjësimin për projektin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet.
- **Shkëlzen Qoka, Këshilli Bashkiak (PD):** Këshilli mbështet iniciativën dhe mënyrën se si projekti është projektuar dhe paraqitur sot. Do të

| | |
|----------------------|--|
| | <p>reflektoj me kujdes në lidhje me çështjet për qëndrueshmërinë dhe rreziqet dhe mënyrën sesi ju keni planifikuar për ti përballuar ato. Mbështes plotësisht këtë qasje. Ne jemi të gatshëm të dyfishojmë fondet, kështu që Bashkia të mundet që këtë vit ta kthejë në vitin e mjedisit. Propozimi është që të fokusohemi në tre aspekte: 1) ji i vogël dhe krijo shembuj të mirë; 2) plan për të ndaluar mbetjet në burim; 3) fokusimi në zona ku ekziston vetëdija duke marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të ulët të ndërgjegjësimit. Me rëndësi është shtrirja në një shkallë të vogël, pasi do të jetë e sigurtë rritja e shanseve për rezultate më të mira. Për këtë arsye, zonat e tjera do të tërhiqen më shumë nga kjo iniciativë dhe do të jenë të gatshëm të marrin pjesë në projekt. Me rëndësi është të mos humbasim kohë dhe të zgjatet jetëgjatësia e venddepozitimit dhe investimeve të tjera të nevojshme. Është gjithashtu e rëndësishme të fokusohemi në një shkallë të vogël për ndërgjegjësimin. Treguesit janë shumë ambiciozë dhe mund të rishikohen.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administratori i NJA Kastriot: Problemi i menaxhimit të mbetjeve është shumë kritik. Fshatrat janë të tejmbushur me vende ku janë hedhur mbetje. Ne jemi të gatshëm të fillojmë me shërbimin e ri në zonën tonë. Ne jemi të gatshëm për të marrë udhëzime se si mund të kontribuojnë për të lehtësuar procesin. - Përfaqësues nga Shkolla e Mesme e Peshkopisë: Aktivitetet ndërgjegjësuese në nivel shkolle duhet të jenë fokusi kryesor i projektit. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe nëpërmjet të rinjve të shpërndajmë informacion tek i gjithë komuniteti. Vlerësojmë futjen e sistemit të llogaritjes së tarifës. Ftojmë sektorin e biznesit që të jetë më bashkëpunues pasi shumicën e kohës janë ata përgjegjës për këtë problem. - Bekim Qosja, AdZM Dibër: Projekti do të mbulojë zonat e mbrojtura si Korab – Koritnik. Situatata e mbetjeve në fshatra brenda ZM është dramatike. Mbetjet janë të hedhura kudo. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e natyrës dhe turizmit, projekti duhet të mundësojë zgjidhje për fshatrat dhe të shmangë hedhjen e mbetjeve në burimet natyrore. - Administratori i NJA Fushë-Çidhën: kemi nisur komunikimin me qytetarët për menaxhimin e mbetjeve. Disa fshatra janë të gatshëm të nisin shërbimin privatisht por kërkojnë mbështetje nga aktivitetet e pastrimit. |
| PËRFUNDIME | <ul style="list-style-type: none"> - Projekti është përkrahur dhe vlerësuar shumë nga palët e interesuara; - Pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur zbatimin e projektit; - ARM-ja është gati të fillojë negociatat për përmirësimin e venddepozitimit; |
| BARAZIA GJINORE | <ul style="list-style-type: none"> - 15 femra në 43 pjesëmarrës gjithsej – 65% meshkuj - 35% femra |
| PLANIFIKIMI (TJETËR) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e grupeve të punës 2. Fillimi i zhvillimit të planit |
| ANEKSET | <ol style="list-style-type: none"> 1. Foto nga aktiviteti 2. Lista e pjesëmarrësve 3. Prezantimet |

Aneksi 1 – Fotot



Aneksi 2 – Lista e pjesëmarrësve



Lista e pjesëmarrjes

Projekti “Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër”
 Takimi prezantues i projektit
 Peshkopi, 1 prill 2016

| Emri | Institucioni | Pozicioni | Kontakte (email, tel) | Firma |
|--------------------|----------------|----------------|---------------------------|-------|
| 1 Shkelzen Doka | K/Banisi | Keshilltar | malishekze@ymail.com | |
| 2 Dron Shehu | K/Banise | çështjeve | dr.ino.ohetme@i.com | |
| 3 Jonida Hajrullay | K/Bashkise | Keshilltare | jonidahajrullay@gmail.com | |
| 4 Shurksi Mekki | Bashkia | Kryetar | shurksi.mekki@hotnet.com | |
| 5 Sali Tenshala | Bashkia | Men Kryetar | sali.tenshala@yaho.com | |
| 6 Haxhem Fida | Bashkia | | haxhem.fida | |
| 7 Antile Tala | Bashkia Riberi | Krye. shkelmer | | |





| | | | | | |
|----|------------------|-------------------|--------------|---------------------------|-------------|
| 8 | Albeto Samolli | - | Residence | alberto.samolli@yahoo.com | [Signature] |
| 9 | Erzicaqer Ajdili | Refelet Q. D. | PLC. Kourp | refelet1384@tutanota.com | [Signature] |
| 10 | Tarant Erroi | Pa Shehsonesi | M.H. B. | Tarant110@gmail.com | [Signature] |
| 11 | ANILA DACI | KI BASHKIAK | KESHILLITAKE | 0684432160 | [Signature] |
| 12 | Juliana Bani | Banka TKBanqatke | Thygeshane | 0674799270 | [Signature] |
| 13 | LAVDIE GJONI | Gjimon G. Hajdari | M. Shuterizi | 0692823980 0694552271 | [Signature] |
| 14 | Asmir Çenaku | Administrativ | AKESFOR | 0686276599 | [Signature] |
| 15 | AGRON ÇEKU | ADM OKRU D/132 | AKESFOR | 0686197243 | [Signature] |
| 16 | Bregu Bogu | D. S. D. Dibe | Kv. Dardhan | 0694112357 | [Signature] |
| 17 | Melkacet Topa | Shek Bajmir Basha | Bejggegjes | melkacetopa@yahoo.com | [Signature] |
| 18 | Benim Zhuka | Admiri Nji Hoxha | Admiri Nji | 0682936798 | [Signature] |







REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA DIBËR



| | | | | | | |
|----|------------------|-----------------------------------|----------------------------|---|--|--|
| 19 | Prezhan Shkëlzi | Bashkia e Dibrës | Specialist | - | | |
| 20 | Dilaver DRIZI | Bashkia DIBËR | Specialist | - | | |
| 21 | Isqak KERRI | Bashkia e Dibrës | Specialist | - | | |
| 22 | Sugrana Lebler | Bashkia e Dibrës | Regj. Vet - Higj. | - | | |
| 23 | Bekim Doga | ADZM - DIBËR | Drejtor | betungës @yqho.com | | |
| 24 | Dicem KASA | Inf. Gjesh | - | dirim@yqho.com | | |
| 25 | Verdi SHEHLLI | DISEKUAORI DIBËR | koordinator RANONDI | dirim@yqho.com verdi_shehll@yqho.com | | |
| 26 | Nevila Mangaj | Partner për Fëmijë | Koordinatorë projektesa | koordinat@yqho.com | | |
| 27 | Majlinda Etocola | MV Dibrë | Team leader | majlinda_kocola@willing.com | | |
| 28 | Imca Tringaj | shk. këmbullit Bosh | | imca@yqho.com | | |
| 29 | Somila Shkëteri | Shërbimi Social Shërbimi Dibrë | Drejtorë | Somila.shketeri@gmail.com | | |



DLPP
DIPLOMA I PËRMBLEDHËS
DIPLOMA I PËRMBLEDHËS



Swiss Consulate in Albania
Embassy of Switzerland in Albania



HELVETAS
Swiss Implementation
ALBANIA

| | | | | |
|----|------------------|----------------------------------|---------------------------------|---------------------------|
| 30 | Prishtinë | Bashkia Diber | Shefe e bashkisë | ujepasburti@gmail.com |
| 31 | Taçlant Dajç | AKU Diber | Sp. Administrate | taclant.dajca@aku.gov.al |
| 32 | Geonard Mura | Bashkia Diber | (P/2, Programim - Zhvillim) | mubamari@gmail.com |
| 33 | BRIGJIDA | SH-SHT Diber | Specialiste (Juriste) | brigidavrishtko@gmail.com |
| 34 | Valbona Kaloci | Bashkia Diber | (P/Sektori i Ndihmës Ekonomike) | valbona.kaloci@qshoo.com |
| 35 | Tauf Hysa | | | |
| 36 | Miriam Jimenezja | | | |
| 37 | Andrian Xhaka | A. M. Shorë | | |
| 38 | VELI SHESHU | Bashkia Diber | Urban-Analitik | |
| 39 | Ramazan Koca | Keshilli | | |
| 40 | Edi Spata | Administrator | | |
| 41 | Hedian Doku | Bashkia Diber (sektori shërbime) | Njft Fushë Gëdhen | |
| 42 | Spartok Koltrake | Drejtorja e Lixhave | (Drejtori) | |
| 43 | Edmund Guri | REC Diber | SR | |

| | |
|---|--|
|  <p>REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER Albania</p>  | <p>"Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë e Dibrës" Referenca e Projektit REC: A3745-A138</p> <p>Takim me forumin e OJF-ve në Njësinë Kastrioti dhe Vizita në venddepozitim</p> |
| <p>TITULLI:</p> | <p>Aktivitetet në zonë</p> |
| <p>DATA E NGJARJES:</p> | <p>14-15 Prill 2016</p> |
| <p>VENDI</p> | <p>Peshkopi</p> |
| <p>OBJEKTIVAT</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i forumeve me OJF-të nga rajoni - Organizimi i takimeve konsultative me përfaqësues lokalë në NJA Kastriot - Vizitë në venddepozitim të Peshkopisë - Prezantimi dhe mbledhja e të dhënave mbi planin për rritjen e ndërgjegjësimit. |
| <p>PËRSHKRIMI:</p> | <p>Vizita dy ditore është planifikuar si një shumëllojshmëri aktivitetesh të cilat do të ndihmojnë sondazhin bazë për projektin në të gjitha aspektet e planifikimit dhe çështjeve teknike. Ekipi i REC, së bashku me stafin e Bashkisë dhe me ndihmën e administratorit të NJA Kastriot, organizuan disa aktivitete në mënyrë që të arrinin qëllimin e vizitës. Kjo gjë ndihmoi në vizualizimin e situatës dhe nevojave lokale për projektin.</p> <p>1. Forumi me OJF-të</p> <p>Komuniteti i OJF-ve në Peshkopi është i vogël me vetëm 3 OJF jo shumë aktive në zbatimin e projekteve. Aktivitetet e tyre janë pak të kufizuara me jo shumë ndikim në zonë. Mqç plani për menaxhimin e mbetjeve përfaqëson një proces me karakteristika të përbashkëta për Bashkitë e tjera, gjithashtu duke marrë në konsideratë ndikimin rajonal të hedhjes së mbetjeve pa kriter, REC ftoi OJF-të nga Bashkitë e tjera afër me zonën për të marrë pjesë në këtë ngjarje dhe për të ndarë pikëpamjet e tyre bazuar në eksperiencat e tyre lokale dhe rajonale. Për këtë arsye, OJF-të nga Dibra, Kukësi dhe Bulqiza u takuan së bashku në këtë ngjarje për përgatitjen e planit të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë e Dibrës, për të mësuar se si të adresojnë në mënyrën e duhur nevojat dhe se si të reduktojnë barrën e Bashkisë për të mundësuar këtë shërbim tejet problematik.</p> <p>Aktiviteti u mbajt në qytetin e Peshkopisë më 14 Prill 2016, me 17 pjesëmarrës (Aneksi - lista pjesëmarrësve) duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Bashkisë.</p> |



Ekipi teknik i projektit, Z. Eduart Cani, Znj. Daniela Ruçi dhe Znj. Antike Torba prezantuan në detaje planin, procesin dhe aspekte të tjera të problemeve si dhe zgjidhjet e propozuara. OJF-të janë ftuar të ndajnë pikëpamjet e tyre bazuar në ushtrime. Për këtë arsye, dy ushtrime u zhvilluan nga dy grupe pune:

1. Si të mundësohet një shërbim për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në NJA Kastriot, duke llogaritur kostot dhe duke futur mënyra të reja për një shërbim të përballeshëm;
2. Si të adresohet problemi i venddepozitimit të Peshkopisë duke investuar në masat për një mbrojtje më të mirë mjedisore dhe shëndetësore.

OJF-të punuan për këto tema dhe duke u praktikuar e biseduar arritën të kuptonin se si mund të adresohen çështje të tilla nga Bashkia.

Në mënyrë të përmbledhur: ata janë shumë mbështetës për projektin dhe janë plotësisht dakort me zgjidhjet e propozuara. Për më tepër, ata janë të vetëdijshëm që problemi është shumë serioz dhe që ka një nevojë urgjente për ndërgjegjësimin e publikut, lidhur me cilësinë e shërbimit të Bashkisë. Aktiviteti është i organizuar në bashkëpunim me OJF-në Agritra, e cila po zbaton një projekt për reduktimin e mbetjeve organike në një fshat në Kastriot. Kjo zgjidhje është mesazhi kyç i cili i adresohet të gjithë OJF-ve në takim, i cili është propozuar të përfshihet në plan "mbetjet organike nuk duhet të hidhen në kontenerë." Mundësia për të arritur këtë objektiv është shumë e lartë, duke marrë parasysh që shumica e zonës është rurale.

2. Takime konsultative në Kastriot



Ngjarja në Kastriot u organizua për të diskutuar planin dhe pritshmëritë për zgjerimin e shërbimit në këtë Njësi. Ngjarja u organizua në bashkëpunim me

Administratorin e NJA Kastriot, Z. Astrit Çanaku.

Kryetarët e fshatrave të Njësive (14) dhe infermierët nga të gjitha qendrat shëndetësore dhe përfaqësues të tjerë (rreth 50 pjesëmarrës) ishin prezent në ngjarje. Ekipi teknik prezantoi projektin, pritshmëritë dhe kufizimet për të gjithë operacionet dhe veçanërisht futjen e një shërbimi të tillë në zonat e largëta.

Kryetarët e fshatrave e mbështetën procesin dhe ishin të gatshëm të ndihmonin për të lehtësuar zbatimin e shërbimit në fshatrat e tyre. Të gjithë diskutuan problemet e tyre në lidhje me hedhjen pa kriter të mbetjeve, situatë prezente në fshatrat e tyre. Ata preferojnë qasjen e ofrimit të shërbimit duke sjellë fillimisht kontenierë në fshatra dhe më pas futjen e sistemit të grumbullimit të mbetjeve. Të gjithë kryetarët e fshatrave konfirmuan se familjet janë gati të paguajnë për tarifën, e cila pritet të futet në faturën e ujit.

Në mënyrë të përmbledhur:

- NJA Kastriot është rreth 7 km nga qyteti i Peshkopisë përgjatë rrugës kombëtare drejt Kukësit, e cila është e asfaltuar dhe në gjendje të mirë për një kamion të vogël (5 ton). Njësia përbëhet nga 14 fshatra në një zonë shumë të gjerë rrethuar nga male, ku kalon dhe lumi Drin. Fshatrat janë të aksesueshëm, por jo nga një kamion teknologjik.
- Gatishmëria për të marrë pjesë në shërbim është shumë e lartë dhe sjellja përkundrejt tarifës është shumë pozitive.
- Administratori u pyet nëse mund të mundësonte informacion nëpërmjet një sërë pyetjesh të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e të dhënave bazë për situatën. Një vizitë tjetër në terren është planifikuar për të vlerësuar infrastrukturën mbështetëse.

3. Vizitë në venddepozitim



Venddepozitimi është i pozicionuar rreth 2 km nga qyteti i Peshkopisë, vendosur mbi një përrua që rrjedh drejt lumit Dohoshisht, me një sipërfaqe rreth 8 000 m². Hedhja e mbetjeve në këtë venddepozitim ka filluar në vitin 2010. Që nga ajo kohë kjo zonë është zgjeruar shumë shpejt. Sasia e mbetjeve në zonë nuk është llogaritur, sepse Bashkia depoziton mbetjet që vijnë nga qyteti pa i peshuar ato fillimisht. Sasi shumë të mëdha mbetjesh vijnë në

mënyrë informale nga njësitë e tjera në mënyrë të organizuar privatisht.

- Aktualisht venddepozitimi nuk po funksionon siç duhet duke ngjeshur mbetjet që vijnë në mënyrë jo të rregullt dhe duke i miksuar me tokën.
- Venddepozitimi nuk ka masat e duhura për operim, shumë larg nga standartet e çdo landfilli.
- Nuk ka rrethim, kështu që kafshët mund të hyjnë në zonë, ose mund të ndodhë rregullisht edhe djegia e mbetjeve.
- Venddepozitimi, i ndërtuar përgjatë përroit, ka tendencë për të mbajtur mbetjet larg përroit. Por e ka humbur funksionin e tij pasi mbetjet e kanë kaluar digën më lart se 5 metër.
- Venddepozitimi ka një tub që lejon përroin të rrjedhë.
- Në pjesën e sipërme, venddepozitimi nuk është i mbrojtur nga ndonjë ngjarje përmytjesh dhe tubacioni nuk është i mbrojtur nga mbetjet që mund të hyjnë në të.
- Zona është thuajse e mbushur dhe nuk mund të jetë më aktive për 5-6 vite nqs nuk bëhet ndonjë ndërhyrje për rritjen e kapacitetit nëpërmjet digave dhe ngjeshjes së duhur.
- Aktualisht zona drejtohet nga Bashkia me kufizime në staf dhe burime.

Në përfundim:

- Bashkia është kërkuar të zhvillojë projektin teknik duke përfshirë hartimin e vëllimit të zonës për të bërë llogaritjen e sasisë së mbetjeve dhe për të gjetur kapacitetin mbajtës të zonës.
- Një propozim teknik për përmirësimin e ndikimit që ka zona në mjedis dhe shëndet do të zhvillohet bazuar në VKM-në për landfillet.
- Rekomandimet e propozuara nga vizita e Emilie Gex do të merren në konsideratë për ndërhyrjet potenciale në zonë.
- Teorikisht zona do të marrë leje për operim nga Drejtoria rajonale Mjedisore. Për këtë arsye, kushtet e zonës janë shumë problematike dhe nuk mund të parandalojnë rrjedhjen e ndotjes me kapacitetet e dhëna financiare të projektit.

4. Konsultimet ndërgjegjësuere



Plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta është i shoqëruar me planin e ndërgjegjësimit dhe edukimit të popullsisë për shërbimin e ri dhe të përmirësuar. Ekipi teknik i drejtuar nga Znj. Daniela Ruçi, diskutuan qasjen me

OJF-të dhe përfaqësuesit lokalë në Kastriot.

U propozuan disa masa paraprake. Fokusi është tek mesazhi lokal, duke adresuar atë që njerëzit dëgjojnë dhe vlerësojnë më shumë.

Drejtori i shkollës në Kastriot premtoi të mbështesë duke angazhuar nxënësit në aktivitete ndërgjegjësimi. Ekipi i projektit propozoi të fillohet me ndarjen e mbetjeve në të gjithë shkollat e mesme duke ndërtuar zona kompostimi dhe duke zbatuar në shkallë të vogël ndarjen e mbetjes së thatë. Një pyetësor lidhur me njohjen e nevojave, pritshmërive dhe hartimin e metodave më të mira për tu përdorur në fushatë iu shpërnda OJF-ve. (Aneksi: Bashkëlidhur gjendet pyetësori).

Aspekte të tjera:

1. Mqs plani do të zhvillohet bazuar në performancë, pyetësorët në lidhje me perceptimin dhe gatishmërinë e publikut u shpërndanë (bashkangjitur) tek pjesëmarrësit dhe iu dhanë Bashkisë për t'i shpërndarë në zonat që do të mbulohen me shërbim.
2. Përgjigjet do të plotësojnë vështrimin e parë për situatën aktuale, bazuar në tabelën e treguesve për të cilët është rënë dakort në projekt. Profili i situatës aktuale të Peshkopisë gjendet bashkëlidhur me këtë raport dhe do të shërbejë për vendosjen e targeteve të planit.
3. Ekipi teknik do të nisë zhvillimin e llogaritjes së kostos për zonat, të cilat do të mbulohen me shërbimin e duhur (Peshkopi, Melan, Maqellarë dhe Tomin). Një optimizim i treguesve do të kryhet gjatë vizitës në zonë me operatorët e kamionit, duke llogaritur km, orët, karburantin dhe aspekte të tjera për llogaritjet e duhura.
4. Një raport për situatën e secilës NJA do të zhvillohet brenda Prillit bazuar në një listë pyetjesh për administratorët zhvilluar më herët këtë muaj (bashkëngjitur). Kjo do të mundësojë një vështrim të përgjithshëm të situatës dhe do të shoqërohet nga vizitat në zonë për investigime të mëtejshme.
5. Është ngritur komiteti drejtues i projektit. Takimi i parë do të organizohet duke patur si qëllim prezantimin e profilit teknik dhe financiar të shërbimit.
6. Ekipi teknik ka filluar mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e sistemit të tarifës. Është duke u diskutuar mundësia e prezantimit të tarifës tek këshilli, duke e futur atë në faturën e ujit.
7. Departamenti i financës është pyetur për të zhvilluar një profil për Bashkinë, ose të paktën për Njësitë që kanë të dhëna historike. Kjo do të shërbejë për vlerësimin e kapacitetit financiar të Bashkisë dhe nivelin e përballueshmërisë së shërbimit.
8. Planin i ndërgjegjësimit është duke u zhvilluar, mesazhet, sloganet dhe mjetet e tjera janë duke u përgatitur. Shkollat konsiderohen si aktorët më të mirë dhe efektivë. Për këtë arsye, fokusi do të përqëndrohet tek ata. Planifikimi i aktiviteteve me zero mbetje dhe ndërhyrjet në shkallë të vogël do të planifikohen të zhvillohen muajt e ardhshëm.

Sfidat kryesore:


1. Të dhënat për aspektet financiare dhe ekonomike për NJA mungojnë dhe nqs ekzistojnë nuk janë të përshtatshme.
2. Aktualisht Bashkia ka aprovuar buxhetin me tarifën e re, e cila do të jetë 30% më e ulët se e mëparshmeja. Kjo do të ndikojë në shërbim.

| | |
|----------------------|---|
| | <p>Megjithatë Këshilli është i hapur për diskutime të tjera dhe ekipi i projektit do të prezantojë nevojën reale tek Këshilli sapo të kenë përfunduar llogaritjet.</p> |
| PËRFUNDIMET | <ul style="list-style-type: none"> - Palët e përfshira janë shumë bashkëpunuese - Ka akoma shumë sfida përpara, të cilat kërkojnë shumë analiza për të qenë të suksesshme - Bashkëpunimi me Bashkinë është shumë i mirë |
| BARAZIA GJINORE | <ul style="list-style-type: none"> - Pa përgjigje |
| PLANIFIKIMI (TJETËR) | <p>3. Siç u përmend më lart me aspektet e tjera</p> |
| ANEKSET | <ol style="list-style-type: none"> 4. Aneksi 1 – Foto nga forumi OJF-ve 5. Aneksi 1.1 – Lista e pjesëmarrësve në forumin e OJF-ve. 6. Aneksi 2 – Foto nga takimi në Kastriot 7. Aneksi 3 – Vizita në venddepozitim 8. Aneksi 4 – Pyetësor për perceptimin publik 9. Aneksi 5 – Kërkesë për Informacion për Administratorin 10. Aneksi 6 – Performanca aktuale e shërbimit 11. Aneksi 7 – Pyetësor për metodat më të mira për ndërgjegjësimin e publikut |

Aneksi 1 – Foto nga forumi OJF-ve



Aneks 1.1 – Lista e pjesëmarrësve në forumin e OJF-ve.



REPUBLIKAT SHQIPËRISE
BASHKIA DIBËR




REC
Shqipëri

Lista e pjesëmarrjes


Projekti "Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Diber"

Takim me OJFtë e rajonit / Peshkopi, 14 prill 2016

| No | Name of participant | Institution / Organization | Email | Telephone |
|----|---------------------|---|---------------------------|-------------|
| 1 | Roland Desja | Buqëria Bufqërië | rolanddesjajse@gmail.com | 0685055 272 |
| 2 | Shaqir Javira | Specialist: Shqiptarë Ekodita shqiptarë-ecodita.com | | 0672038194 |
| 3 | Shqipëria Hoxha | Fedatole e Pese Diberi | shqipëria.hoxhajavira.com | 0672038185 |
| 4 | HARIT SHAKIMI | Shaq. Kujdesi për Mjetet "hall-jekim"@hotmail.com | | 0685060883 |
| 5 | Berend Saraci | Bashkia Bulqizë | Berend.saraci@gmail.com | 0696263296 |
| 6 | PETRIT SIMAJ | AdIM Kukes | petrit@simaj.org.al | 0677036228 |



Developmental Programme
Cooperation Office
Ministry of Environment in Albania



HELVETAS
Swiss Agency for Development Cooperation
ALBANIA

| No | Name of participant | Institution / Organization | E-mail | Telephone |
|----|---------------------|--|---------------------------------|-------------|
| 7 | SONUS Fari | Forumit Zhvillimor Bashkia e Dibrës | sonus.fari@gmail.com | 06822729146 |
| 8 | Ilir Goleci | Kryeta St. Dajçin: OP | shqiptar.official.dibër@rec.com | 0682293558 |
| 9 | GAFURR DEDA | Shoq. Eksp. Pijngj Medisor | gafurdeda@gmail.com | 0683147177 |
| 10 | KUTJIM LLESHI | Shoqata Kujdesi për Mëdësinë | | 06822743840 |
| 11 | Donjçe Risa | Espresso - Ring Mëdësinë | donjce.risa@gmail.com | 068531269 |
| 12 | Bukurie Bopu | Qendra Agjencia-Livian | q.buriev@adand.com.al | 0685752930 |
| 13 | Felle Mrs Shelu | LHG 'KEMIA' | log.duni@gmail.com | 0692786311 |
| 14 | Ulrika Kopçhinu | Shoqata: 'Guaja' nene dhe edukatore | ulrikakopchinu@guajashqip.com | 0685793479 |
| 15 | Douvida Luci | REC Shqipëri | dluci@rec.org | 0682012575 |
| 16 | Eduart Cani | REC Shqipëri | ecani@rec.org | 042232928 |
| 17 | Ankita Tona | Bashkia e Dibrës | ankitetonagmail.com | 0682611943 |
| 18 | | | | |

Aneksi 2 – Foto nga takimi në Kastriot





Aneksi 3 – Vizitë në venddepozitim





Aneksi 4 – Pyetësi për perceptimin publik

Pyetësor për qytetarët

Cilësia e shërbimit të largimit të mbetjeve dhe pastrimit në Bashkinë Dibër 2016

Në kuadër të hartimit të Planit Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve dhe investimeve në infrastrukturën e re të largimit të mbetjeve, Bashkia Dibër, ju drejtohet qytetarëve për informacion mbi perceptimin që ata kanë mbi shërbimin e ofruar aktualisht nga Bashkia.

1. Data e intervistës: _____
2. Njësia Administrative (p.sh. Peshkopi, Melan, ...): _____
3. Moshë e të intervistuarit: _____ vjeç
4. Gjinia e të intervistuarit: Femër Mashkull

P Y E T J E T

1. A ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në njësinë, lagjen, rrugicën tuaj në mënyrë të kënaqshme?

po jo

2. A jeni të gatshëm të paguani për shërbimin e mbetjeve?

po jo

3. Sa jeni të gatshëm të paguani kundrejt një shërbimi cilësor (një tarifë e cila i përgjigjet koston së shërbimit)?

1000 – 1500 lekë/vit/familje

2000 lekë/vit/familje

2500 lekë/vit/familje

Aneksi 5 – Kërkesë për Informacion për Administratorin

Kërkesë për informacion drejtuar Administratorëve të njësive administrative të Bashkisë Dibër.

Të nderuar Administratorë, si dhe jeni në dijeni ka nisur puna për hartimin e Planit të Integruar për Menaxhimin e Mbetjeve në Bashkinë Dibër. Për këtë qëllim është e nevojshme kryerja e një analize të detjauar të gjendjes në njësinë tuaj administrative sipas pikave të mëposhtëme:

- 1. Përshkrim i përgjithshëm i njësisë administrative** (vendndodhja, gjeografia, topografia, numri i banesave dhe shpërndarja e tyre)
- 2. Analizë e popullsisë** (Numri i familjeve, popullsisë sipas gjendjes civile, tendeca e lëvizjes së popullsisë në rritje apo zbritje, ndarja gjinore, të dhëna të tjera mbi popullsinë si moshë, arsimit, etj.)
- 3. Analizë e bizneseve** (Numri i bizneseve, përqëndrimi kryesor, kategoritë e bizneseve)
- 4. Analizë e institucioneve të të gjitha llojeve** (numri, vendndodhja, numri i shkollave)
- 5. Përshkrim i gjendjes së rrugëve** (distanca nga qyteti i Peshkopisë, rrugët e brendshme, gjendja me asfalt ose jo)
- 6. Gjenerimi i mbetjeve** (një parashikim sa mbetje gjeneron një familje në ditë, sa një biznes)
- 7. Gjendja me shërbimin e mbetjeve** (sa pika grumbullimi dhe lloji i pikës kazan apo beton, mjetet e grumbullimit, modelet e grumbullimit, natyra e mbetjeve, depozitimet aktuale dhe gjendja e tyre)
- 8. Përshkrim i pikave të ndotjes** (sa pika me mbetje ka në njësi, cila është gjendja e tyre)
- 9. Përshkruani sjelljen e komunitetit ndaj mbetjeve** (perceptimi publik, kultura lokale, ndërgjegjësimi, dëshira për të paguar për shërbimin, a janë banorët të gatshëm të reduktojnë mbetjet duke kompostuar organiket)
- 10. Cilat janë pritshmëritë për investime** (cfarë teknologjie, nëse prisni të vendosen kazanë ku duhen vendosur patjetër, a mund të ketë nisma për ndarjen e mbetjeve)?
- 11. Cila mund të jetë motoja, solgani më i përshtashëm për fushatën e ndërgjegjësismit?**

Aneksi 6 – Performanca aktuale e shërbimit

Set of indicators on performance

| Indicators | | Classification coded in colours | | | Data accuracy |
|-------------------------------|----|---|---------------------|------|-----------------------|
| | | Low | Medium | High | Low Medium High |
| Quality of service | C1 | Service coverage areas | | | |
| | | <i>C1.1 Service coverage in urban and peri-urban areas</i> | 100% | | |
| | | <i>C1.2 Service coverage in remote areas</i> | 0% | | |
| | C2 | Cleanliness of the city | 90% | | |
| | C3 | Public perception: degree of public satisfaction with the service | NA (end of April) | | |
| Environmental sustainability | D1 | Reuse: degree of differentiated collection of waste in urban areas | 0% | | |
| | D2 | Protection of natural resources: degree of waste treated in engineered landfills or approved controlled disposal sites. | 0% | | |
| Econ. & finan. sustainability | E1 | Cost recovery: Tariff covers the cost. | NA (to be reviewed) | | |
| | E2 | How citizen contribute to financing the service : rate of the tariff collection | NA (to be reviewed) | | |
| | E3 | Transparency of the billing system | low | | |
| Cost of service | |Lek/tLek / inhab / y | | | |

Aneksi 7 – Pyetësoni për metodat më të mira për ndërgjegjësimin e publikut

Rezultate nga OJF-të

| Pyetësor mbi Metodatat dhe Mjetet që lidhen me ndërgjegjësimin e publikut | | |
|---|---------------|------|
| mbi mirëmenaxhimin e mbetjeve | | |
| piket 1-5 | totali | |
| Titulli i fushatës/ Slogan / Logo | 55 | 4.58 |
| Aktivitete me shkollat (si trajnime me mësuesit apo në ditë të caktuara në shkollë me fokus mbetjet mbi parimin e 4R) | 55 | 4.58 |
| Vendosja e koshave për riciklim në mjediset publike (koshat të ishin tërheqës dhe lehtësisht të dallueshëm në mjediset publike që të mund të tërheqin vëmendje) | 54 | 4.50 |
| Fushata Vullnetare Pastrimi | 51 | 4.25 |
| Organizimi i aktiviteteve promovuese (aktivitete artistike, teatër për fëmijë) etj | 51 | 4.25 |
| Broshurë me informacion ndërgjegjëses mbi mbetjet shtëpiake dhe trajtimin e tyre mbi bazën e parimit të 4R (Refuzo, Ripërdor, Riciklo, Rikupero) | 51 | 4.25 |
| Fushata derë më derë; | 51 | 4.25 |
| Postera | 50 | 4.17 |
| Promovimi i praktikave të kompostimit | 49 | 4.08 |
| Fushata e ndërgjegjësimin në Stacionet e TV dhe Radio | 48 | 4.00 |
| Paketë me materiale ndërgjegjësuese (KIT Promocional) për bashkinë në lidhje me ndërgjegjësimin për mbetjet | 47 | 3.92 |
| Publikime në gazetatat lokale | 45 | 3.75 |
| Telefoni i gjelbër apo Aplikacion mbi fotografimin e venddepozitimeve të parregullta të mbetjeve | 45 | 3.75 |
| Lista e produkteve të njohura që mund të riciklohen sipas situatës që paraqitet në bashki (Harta se ku?) | 43 | 3.58 |
| Faqe interneti | 42 | 3.50 |
| Udhëzues (guidë pazari) për konsum të përgjegjshëm | 42 | 3.50 |
| Personalitete të njohura që promovojnë mirëmenaxhimin e mbetjeve (Ambasadori i Vullnetit të Mirë) | 39 | 3.25 |
| Profil mbi llojin e mbetjeve që gjenerohen në bashki (çfarë, sa, si, ku, etj). | 37 | 3.08 |
| Marketingu & Promovimi i produkteve të prodhuara nga materiale të ricikluara | 31 | 2.58 |

| | |
|---|---|
|  <p>REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER Albania</p>    | <p>"Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë e Dibrës" Referenca e Projektit REC: A3745-A138</p> |
| | <p>Zhvillimi i modelit të shërbimit – vizita dhe takime të shumta</p> |
| <p>TITULLI:</p> | <p>Aktivitetet në zonë</p> |
| <p>DATA E NGJARJES:</p> | <p>08-10 Shkurt 2017</p> |
| <p>VENDI</p> | <p>Dibër</p> |
| <p>OBJEKTIVAT</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i takimeve konsultative me Njësitë Administrative të cilat janë pjesë e planit të zonave me shërbim - Vizita në zonë në Njësitë Administrative - Analiza e situatës aktuale në zonë për ofrimin e shërbimit në qytet. - Kontrolli i venddepozitimit. Operacioni ditor i kamionit dhe situata e kontenierëve. - Takime konsultative me autoritetet vendore. - Zhvillimi i planit të ndërgjegjësimit. |
| <p>PËRSHKRIMI:</p> | <p>Vizita u organizua si një monitorim intensiv në zona dhe takime me palët e interesuara në mënyrë që të prezantoheshin skenarët e projektit dhe të merrej maksimumi i të dhënave, informacioneve dhe reagimeve për sistemin më të realizueshëm në Dibër.</p>  <p>Më poshtë jepet një përmbledhje e aktiviteteve, të gjithë rezultatet e këtyre</p> |

konsultimeve do të prezantohen në plan.

1. Takim në Njësinë Administrative Maqellarë.



Duke marrë në konsideratë atë si polin e dytë të shërbimit për shërbimin e ri të Dibrës, u organizua një takim me administratorin vendor dhe kryetarët e fshatrave të Njësisë në ambjentet e NJA Maqellarë. Aktiviteti kishte si qëllim prezantimin e qasjes për zonën e dytë të propozuar për shërbimin e ri Maqellarë-Melan dhe për të marrë përshtypjet e tyre mbi qasjen më të mirë për fshatrat e Njësisë.

Kryetarëve të fshatrave iu prezantua një hartë dhe një analizë e detajuar për shërbimin.

Pas aktivitetit u zhvillua një vizitë në 4 fshatrat kryesore të Njësisë për të njohur dhe kuptuar më mirë lidhjen me rrugë, vendbanimet dhe situatën aktuale të grumbullimit të mbetjeve.

Si përfundim, kryetarët e fshatrave mbështetën plotësisht idenë e të qënit një zonë e dytë shërbimi duke u pajisur me një kamion dhe kontenierë të cilët do të vendosen në rrugët kryesore që lidhin fshatrat dhe në qendër të fshatrave. Ata u angazhuan për të flluar ndarjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin për skemën e propozuar për shërbimin, e cila do të bazohet në data të përcaktuara dhe vetëm për mbetjen e thatë.



2. Vizitë ne fshatrat e Maqellarës

Vizitat në zonë u organizuan në fshatrat Bllatë, Kërçisht, Kllopçisht, Pocest dhe në lidhjet me rrugën kryesore të Njësisë.





Duke i përmbledhur çështjet kryesore të identifikuara janë: lidhja me rrugë nuk është shumë e përshtatshme për të mbështetur qasjen më të mirë të rrugëtimit; secili fshat ka një vend që depoziton mbetje dhe mbetjet gjenden kudo; situata në fshatra nuk e mbështet grumbullimin e mbetjeve në brendësi të fshatrave, për këtë arsye do të duhet të përdoren skema alternative grumbullimi, si përshembull modeli i grumbullimit derë më derë.

3. Vizita në zonë në Njësitë Administrative Kala e Dodës – Sllovë – Fushë Çidhën – Arras – Kastriot – Muhurr – Tomin dhe Peshkopi

Vizita në zonë u organizua si një kombinim aktiviteteve konsultimesh me kryetarët e NJA dhe kryetarët e fshatrave, monitorim në zonë, kontroll të lidhjes së rrugëve, monitorim të vendbanimeve dhe përcaktim të qasjes më të mirë për të dizenuar zonat e shërbimit.

Vizita filloi nga Peshkopia drejt Kalasë së Dodës e cila është njësi më e largët e lidhur me rrugën kombëtare të Kukësit. Takimi i parë u organizua me kryetarin e NJA Kala e Dodës dhe kryetarin e fshatit më të madh dhe kryesor të quajtur Cereni.

Fotot e mëposhtme japin informacion për situatën në këtë pjesë të Bashkisë.



Foto 1. Takimi me administratorin vendor të Kalasë së Dodës



Foto 2: Qendra e Kalasë së Dodës (propozuar si zona kryesore e grumbullimit – vendosja e koshave këtu)



Foto 3: Lidhja me rrugë me Radomirën / Kala e Dodës, një rrugë prej 4 km e paasfaltuar por lidhje me një pjesë shumë të rëndësishme të Njësisë



Foto 4: NJA Sllovë – qendra e fshatit ku ndodhen zyrat e NJA. Në të majtë gjendet shkolla me 400 nxënës ku gjenerohen shumë mbetje dhe ku do të vendosen kontenierët për sistemin e ri.



Foto 5: Pamje peisazhi nga NJA Sllovë



Foto 6: Në afërsi të fshatit Bllice si pjesë e rrugëtimit për shërbimin e propozuar



Foto 7: Qendra e fshatit Bllice



Foto 8: NJA Fushë Çidhën, rrjeti rrugor i brendshëm



Foto 9: Lidhja e Fushë-Çidhën me NJA Arras, duke u zhvilluar një sistem i ri i lidhjes me rrugë



Foto 10: Lidhja e Fushë-Çidhënës me NJA Arras, duke u zhvilluar një sistem i ri i lidhjes me rrugë – por ka Akoma shumë punë për t'u bërë



Foto 11: Depozitim i mbetjeve në rrugën nga Fushë-Çidhna në NJA Kastriot - mbetje të depozituara rregullisht në anë të rrugës



Foto 12: Mbetje të depozituara në çdo rrjedhë ujore



Foto 13: Lidhja Muhurr - Arras. Një urë e vjetër hekuri lidh dy anët e lumit Drin



Foto 14: Shkolla në Muhur. Grumbullimi i mbetjeve jashtë shkollës por nuk ka të vendosur një sistem grumbullimi për mbetjet.

Në mënyrë të përmblodhur: situata është shumë dramatike dhe për shkak të rrjetit jo shumë të mirë rrugor dhe gjeografisë së zonës ka shumë pak mundësi të mundësohet një sistem i duhur për grumbullimin e mbetjeve për shumicën e Njësisve Administrative të Bashkisë. Zona është shumë e varfër dhe vërehet një sjellje e keqe e banorëve me mbetjet. Fokusi kryesor do të përqëndrohet në fshatrat përgjatë rrugëve kryesore dhe qendrave të tyre, më pas do të propozohet zhvillimi i një sistemi të brendshëm alternativ.

4. Monitorimi i dispozitave të shërbimit aktual në Peshkopi dhe Tomin

U krye monitorimi i sistemit në zonë, duke gjurmuar kamionin gjatë rutinës së grumbullimit. Qëllimi i monitorimit ishte të kuptohej situata e sistemit të grumbullimit, kohën e shpenzuar për grumbullim, llojin e mbetjeve, sjelljen e stafit dhe qytetarëve dhe grumbullimin e sa më shumë të dhënave për një propozim sa më të mirë për sistemin e ri të shërbimit.

U vëzhguan çështje të ndryshme si psh. prezenca e mbetjeve spitalore në kontenierë; u gjetën jashtë kontenierëve mbetje nga krasitjet; çështjet e trafikut; infrastruktura rrugore dhe dëmtimet në infrastrukturë.

Në total sistemi përbëhet nga 150 kontenierë 1.1 m³ në gjendje mesatare dhe një kamion teknologjik (kompaktor) 10 t në gjendje të amortizuar dhe një kamion të hapur i cili funksion në bazë të nevojave. Shërbimi mundësohet nga një kompani publike e cila ka 1 shofer, 4 punonjës (2 për fshirjen) dhe 1 shef (brigadier) të ekipit.

Mesatarisht kamioni shpenzon 5 minuta në secilën pikë grumbullimi (në disa raste mund të shkojë edhe 16 minuta) dhe duhen të paktën 40-50 kontenierë për të mbushur plotësisht kamionin. Shërbimi nuk funksion çdo ditë por një herë në dy ditë dhe nuk është kjo mënyra e duhur e funksionimit.



Foto 15: Kompaktori 10t



Foto 16: Mbetje spitalore në kontenierët publikë



Foto 17: Gjendja e kontenierëve. Sasi e madhe e mbetjeve nga krasitjet përreth kontenierëve.

5. Planifikimi i infrastrukturës dhe zonave të propozuara të shërbimit për sistemin e ri

Çdo ditë ekipi organizoi takime me autoritetet vendore, kryetarin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe ekipin teknik. U diskutua qasja për të gjithë Bashkinë dhe për qytetin. Ekipi propozoi përfundimisht skemën me dy zona kryesore dhe 2 nënzona në mënyrë që të mbulohet me shërbim Bashkia nga jugu në veri në

ato pjesë ku e lejon infrastruktura rrugore.


Në qytet, sistemi do të jetë i ri dhe do të merren në konsideratë qasjet e mëposhtme:

1. Bulevardi kryesor do të jetë një zonë e gjelbër (ndarje e mbetjeve, pika të veçanta për grumbullimin e mbetjeve);
2. Në lagjet kryesore do të vendosen nga dy kontenierë, një për mbetjen e thatë dhe një për organiken;
3. Në njërën prej lagjeve, ku kamioni nuk mund të hyjë dot dhe qytetarët nuk lejojnë vendosjen e kontenierëve, do të organizohet shërbimi i grumbullimit me thasë;
4. Do të vendoset një sistem i veçantë për grumbullimin e mbetjeve në shkolla;
5. Kamioni i ri për qytetin propzohet të jetë 7 ton që të ketë akses më të mirë dhe të lëvizë më lehtë në qytet.





Harta më poshtë prezanton zonat e propozuara të shërbimit të cilat janë organizuar si më poshtë: Zona 1 Peshkopi – Tomin; Zona 2 – Maqellarë dhe Melan; Nën – Zona 3 si pjesë e Zonës 2 Muhurr dhe Arras; Nën – Zona 4 si pjesë e Zonës 1 Kastriot, Sllovë, Fushë Çidhën dhe Kala e Dodës. Kjo skemë lë pa mbulim me shërbim NJA Lurë, Zall Dardhë, Zall Reç dhe Selishtë të cilat nuk janë të lidhura me rrugë të asfaltuara dhe janë shumë larg.



Harta 2 – Zonat e propozuara për shërbim (me jeshile fshatrat që kanë akses dhe me të kuqe ato që janë të pamundura për t'u arritur)

6. Zhvillimi i planit të ndërgjegjësimit

a. Takimi pune në hartimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbetjeve dhe investime në infrastrukturën e re dhe largimin e mbetjeve në Bashkinë e Dibrës

Takimi me këshilltaren e kryetarit të Bashkisë, Znj. Diana Stojku u zhvillua në ambjentet e Bashkisë së Dibrës. Gjatë takimit këshilltarja e Kryetarit të Bashkisë u informua nga Znj. Daniela Ruçi, eksperte për Edukimin Mjedisor dhe Ndërgjegjësimin në REC Shqipëri, për procesin e bashkëpunimit lidhur me zbatimin e projektit dhe REC mbështet Drejtorinë e Shërbimeve të Bashkisë në lidhje me përmirësimin e situatës së menaxhimit të mbetjeve.

Gjatë vizitës në pedonalen e re të qytetit e cila sapo është rikonstruktuar, u diskutua për një qasje të re dhe inovative për koshat e vendosur përgjatë kësaj zone. (Pedonalja e re e Peshkopisë pritet të ketë një gjatësi 1200 metër dhe do të pajiset me stola për banorët dhe më shumë hapësira të gjelbërta).

Fotot e kësaj zonë do të ndihmojnë ekipin e projektit të REC për të bërë një vlerësim më të mirë të situatës së re dhe vendosjes së kontenierëve në përputhje me Mesazhin e Fushatës së Ndërgjegjësimit.

Znj. Diana Stojku u angazhua që t'i komunikojë të gjithë informacionin Kryetarit të Bashkisë së Dibrës.

b. Takim me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale Arsimore të Dibrës (DAR), Z. M. Gjeci.

Takimi u organizua në ambjentet e drejtorisë. Qëllimi i takimit ishte njohja e tij me punën që po bën REC Shqipëri dhe mbështetjen e Bashkisë së Dibrës për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, një nga objektivat e takimit ishte diskutimi për aktivitetet ndërgjegjëse me shkollat dhe mësuesit të cilat duhet të organizohen brenda Fushatës së Ndërgjegjësimit dhe Informimit.

Znj. Daniela Ruçi, eksperte e edukimit mjedisor në REC Shqipëri prezantoi disa nga çështjet të cilat kërkojnë mbështetjen e DAR të Dibrës në aktivitetet e ndërgjegjësimit nëpër shkolla, veçanërisht ato që do të kryhen gjatë Shkurt-Prill 2017:


- Trajnimi i mësuesve në çështjet e mbetjeve dhe përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve brenda ambjenteve të shkollës;
- Organizimi i aktiviteteve jashtë shkollore ndërgjegjëse me mësuesit dhe nxënësit.

Në takim temat e diskutuara ishin edhe pyetësorët për nxënësit për mbetjet shtëpiake. Më shumë se 50 nxënës të shkollave fillore në Peshkopi do të rregjistrojnë të dhënat për mbetjet në shtëpi për 1 javë. Këto të dhëna janë të nevojshme për procesin e draftimit të planit të menaxhimit dhe për procesin e vlerësimit kosto-tarifë. Drejtori i DAR mbështeti procesin e nisur nga Bashkia dhe REC dhe u angazhua për të mbështetur të gjithë aktivitetet.


Në fund të takimit, u vendos që REC Shqipëri duhet të dërgojë një letër zyrtare komunikimi për DAR Dibër në lidhje me çdo aktivitet që do të organizohet duke mundësuar informacionin e nevojshëm për datën e aktivitetit, audiencën e synuar dhe llojin e aktivitetit. Ky proces komunikimi do të lehtësojë punën e institucioneve dhe pritet të ketë efekte pozitive në ndërgjegjësimin në shkolla për menaxhimin e mbetjeve, dhe ndjekjen e mesazheve të fushatës të

| | |
|----------------------|---|
| | <p>ndërgjegjësimin të familjeve dhe komunitetit në Dibër.</p> <p>c. Takimi me menaxheren e projektit të World Vision Center në Dibër, Znj. Majlinda Hoxha u mbajt në ambjentet e qendrës, e cila ndodhet në qendër të Peshkopisë.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte familjarizimi me organizatën World Vision Center, zonat e aktiviteteve të kësaj organizate që fokusohen në komunitet, gjithashtu edhe aktivitetet e ndërgjegjësimin të publikut që mund të kenë një ndikim të madh në komunitetin në Dibër.</p> <p>World Vision Center në Dibër, ka më shumë se 5 vite aktivitet, kryesisht në Peshkopi, NJA Maqellarë dhe Kastriot. Një nga drejtimet kryesore të punës së tyre ishte çështja “Qytetari Aktiv”. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, WV ka mbështetur aktivitetet e ndërgjegjësimin në shkolla dhe ka ndihmuar në çështjet sociale. Në disa nga këto aktivitete, shkollat janë mbështetur me kontenierët e mbetjeve dhe aktivitetet e fushatave të pastrimit të organizuara kryesisht gjatë ditëve mjedisore. Gjatë takimit është diskutuar mungesa e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë Bashkinë dhe diskutime të mëtejshme ishin në ndihmë të ndërgjegjësimin të ulët të komunitetit dhe ndikimit negativ të mbetjeve në shëndetin dhe natyrën, fakte që identifikohen lehtë nëpërmjet situatës së rrugëve, shkollave apo rrjedhjeve ujore që janë të mbushura me të gjitha llojet e mbetjeve.</p> <p>Takimi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve lokale dhe grupeve të komunitetit në aktivitetet e ndërgjegjësimin. Menaxherja e projektit të World Visioni u angazhua për të mbështetur Bashkinë dhe REC Shqipëri në Fushatën e Ndërgjegjësimin dhe Informimit dhe gjithashtu përfshirjen e vullnetarëve në disa nga aktiviteteve që REC Shqipëri ka planifikuar të organizojë muajt e ardhshëm.</p> |
| PËRFUNDIMET | <ul style="list-style-type: none"> - Situata e rrugëve dhe infrastrukturave të tjera është monitoruar plotësisht dhe është gati të zhvillohet propozimi; - Situata është shumë dramatike dhe do të duhet shumë kohë dhe përpjekje që të zgjidhet si duhet; - Njësitë Administrative mbështesin plotësisht sistemin e ri dhe do të kujdesen të ndërgjegjësojnë populllatën; - Administrata lokale pranoi qasjen; - Sjellja e qytetarëve nuk është e duhura dhe do të duhet shumë kohë dhe përpjekje për ndërgjegjësim. |
| BARAZIA GJINORE | |
| PLANIFIKIMI (TJETËR) | 4. Zhvillimi i projekt planit |
| ANEKSET | 12. Informacion i mëtejshëm mbi analizën |


Fshatrat me akses (të asfaltuar por Akoma të paarrtshëm nga mjetet)



Rrugëtimi për Zonën 1 (i optimizuar duke përdorur GIS Analyst)



Harta e Zonës 2 – Zona e Shërbimit



Lidhja e përditësuar e rrugëve pas monitorimit

